



Studim

Përmirësimi i Legjislacionit Shqiptar në Fushën e Barazisë Gjinore

Janar 2023

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Autoret: Prof.Dr. Aurela Anastasi, Prof.Dr. Arta Mandro-Balili, Dr. Elona Saliqaj, eksperte të Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare dhe Agustela Nini-Pavli, eksperte pranë Zyrës së UN Women në Shqipëri.

Studimi u hartua në kuadër të një projektit “Përmirësimi i legjislacionit shqiptar në fushën e barazisë gjinore”, të zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me mbështetjen e Zyrës së UN Women dhe Zyrës së Përfaqësuesit të OKB-së në Shqipëri.

Autoret falënderojnë në mënyrë të veçantë Znj. Aurela Bozo, Drejtore Ekzekutive e QNLQ, si dhe Znj. Estela Bulku, Drejtore e Programeve dhe Znj. Rachele Megna, Analiste Programi pranë Zyrës së UN Women në Shqipëri për mbështetjen e tyre në procesin e hartimit të studimit.

Analiza dhe opinionet e shprehura janë qëndrime të autoreve dhe nuk përfaqësojnë detyrimisht qëndrimin zyrtar të UN Women apo Zyrës së Përfaqësuesit të OKB-së në Shqipëri.

Pasqyra e Lëndës

Hyrje	3
Përmbledhje	4
Analiza e Kodit Penal në Lidhje me Krimet Seksuale	10
Analiza e Kodit të Familjes mbi Rregullimet Ligjore për Moshën e Martesës	20
Analiza e Kodit Penal lidhur me Veprat Penale të Dhunës në Botën e Punës	30
Analiza e Kodit Civil lidhur me Regjimin e Bashkëpronësisë në Familjen Bujqësore	36
Bibliografia	61

Hyrje

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ) ka realizuar një analizë të pajtueshmërisë të disa akteve ligjore në fushën e barazisë gjinore me legjislacionin ndërkombëtar. Aktet ligjore kanë të bëjë me krimet seksuale, martesën e hershme, ngacmimet seksuale në marrëdhëniet e punës dhe regjimi i bashkëpronësisë në familjen bujqësore.

Projekti mbështetet teknikisht dhe financiarisht nga zyrat e UN Women dhe Përfaqësuesit të OKB-së në Shqipëri dhe ka si qëllim përmirësimin e legjislacionit shqiptar në fushën e barazisë gjinore. Kjo nismë bazohet në Thirrjen për Veprim për të Drejtat e Njeriut të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të vitit 2020 si dhe Udhëzuesit të OKB-së për eliminimin e Ligjeve Diskriminuese ndaj Grave dhe Vajzave (2021).¹

Thirrja për Veprim përcakton një axhendë ambicioze për promovimin e të drejtave e njeriut, duke i konsideruar ato thelbësore për përballjen me shumicën e çështjeve më të ngutshme botërore dhe realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në këtë kuadër, realizimi i barazisë gjinore vlerësohet si një qëllim kyç, që mbështet çdo element të kësaj axhende. Nga ana tjetër, Udhëzuesi i OKB-së për Eliminimin e Ligjeve Diskriminuese ndaj Grave dhe Vajzave prezanton strategji konkrete për tu zbatuar nga Shtetet në drejtim të eliminimit të pabarazisë gjinore, duke u fokusuar në veçanti në identifikimin e ligjeve diskriminuese dhe marrjen e masave për ndryshimin e tyre. (bashkëlidhur Studimit në formë Aneksi).

Analiza në fjalë, është bazuar në këtë Udhëzim si dhe kontribuon për përmbushjen e disa angazhimeve në fushën e barazisë gjinore të ndërmarra në Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Planit të Veprimit të Shqipërisë (2021-2030) dhe konkretisht:

Masat nën Qëllimin Specifik III- *Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje* – që kanë të bëjnë me:

- Përmirësimin e legjislacionit për mbrojtje nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore;
- Përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me moshën minimale të lejuar për martesë, me qëllim ndalimin e praktikave të dëmshme siç është martesë e fëmijëve.

Masat nën Qëllimi Strategjik I - *Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet, duke synuar një rritje dhe qendrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në dixhitalizim* – që kanë të bëjnë me:

- Zbatimin e Konventës No.190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi “Eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës”
- Njohjen, zbatimin dhe monitorimin e kuadrit ligjor dhe i politikave që garantojnë gëzimin e të drejtës së pronësisë për gratë, të rejat dhe vajzat nga të gjithë grupet, përfshirë dhe pronësinë mbi tokën bujqësore”

Gjetjet e studimit, pasi të diskutohen në një takim konsultues me autoritetet publike dhe përfaqësues të shoqërisë civile, do të dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera përkatëse për tu marrë në konsideratë në projektet për ndryshimet e akteve ligjore respektive. Gjithashtu, QNLQ dhe

¹ <https://www.un.org/en/content/action-for-human-rights/index.shtml>

UN Women, në bashkëpunim me organizatat e tjera të shoqërisë civile në Shqipëri do të vazhdojnë punën advokuese me përfaqësues të qeverise, kuvendit, sistemit gjyqësor dhe aktorë të tjerë për ndërgjegjësim të mëtejshëm për përmirësimin e këtyre akteve dhe praktikës gjyqësore, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Përmbledhje

QNLQ dhe zyra e UN Women, identifikuan disa akte ligjore që përmbajnë dispozita, për të cilat një sërë raportesh të brendshme dhe ndërkombëtare kanë ngritur shqetësime në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore. Konkretisht, rishikimi ligjor kishte në fokus dispozitat e:

- Kodit Penal në lidhje me dhunën seksuale;
- Kodit të Familjes dhe Kodit Civil në lidhje me martesën e hershme;
- Kodit Penal në lidhje me ngacmimet seksuale në marrëdhëniet e punës;
- Kodit Civil në lidhje me regjimin e bashkëpronësisë në familjen bujqësore

Ekspertet e angazhuara për këtë analizë konkluduan se të gjitha aktet e mësipërme shfaqin një sërë problematikash në lidhje me standardet ndërkombëtare të barazisë gjinore dhe duhet të rishikohen nga autoritetet shqiptare.

Konkretisht:

I- **Kodi Penal në lidhje me krimet seksuale**

Dispozitat mbi krimet seksuale në Kodin Penal janë analizuar në përqasje me standardet e vendosura nga Konventa Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit), Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW-t) dhe legjislacioni të BE-së.

Nga analiza rezultoi se këto dispozita janë shumë të tejkaluara dhe kanë mangësi thelbësore që vijnë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Madje, është evidentuar se disa prej mangësive janë sjellë në vëmendje të Shtetit Shqiptar edhe nga raportet dhe konkluzionet e Grupit të Ekspertëve të Pavararur të Këshillit të Evropës (GREVIO), në vitin 2017 dhe Komitetit të Shteteve Palë të Konventës së Stambollit në vitin 2021. Disa mësimet e tjera burojnë nga praktika ndërkombëtare si dhe nga përvojat e vendeve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës dhe të BE-së.

Një ndër aspektet më të rëndësishme në të cilin ky studim u përqendrua, ka të bëjë me përkufizimin e marrëdhënieve seksuale me dhunë, për të cilin Konventa e Stambollit, në nenin 36, ka afirmuar si standard mungesën e pëlqimit nga e/i dhunuara/dhunuari dhe jo përdorimin e forcës, ose të dhunës. “Pëlqimi duhet të jepet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit të vlerësuar në kontekstin e rrethanave më të afërta”.

Ky përkufizim dhe standarde të tjera si jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Komitetit CEDAW në mënyrë të qartë nuk e vendosin theksin te përdorimi i forcës nga përdhunuesi ose kërcënimin për përdorim force. Gjithashtu, këto standarde nuk kërkojnë që viktimat të provojë rezistencë ndaj përdhunimit.

Ndërkohë, në Kodin Penal shqiptar, marrëdhënia seksuale me të rritura konsiderohet përdhunim vetëm kur plotësohet kushti i përdorimit të forcës ose dhunës nga njëra palë. Mungesa e pëlqimit kërkohet si kusht vetëm për përdhunimin midis bashkëshortëve ose bashkëjetuesve. Përdorimi i forcës është gjithashtu edhe elementi kryesor për veprën penale të dhunës seksuale ndaj të miturve/të miturave nga 14 deri 18 vjeç (neni 101) dhe në marrëdhëniet homoseksuale (neni 102/1). Në të gjitha këto raste, barra e provës i ngarkohet viktimës, e cila/i cili duhet të provojë përdorimin e dhunës ndaj saj/tij si dhe rezistencë.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme që të merren masat për të ndryshuar dispozitat e Kodit Penal, duke parashikuar një përkufizim të ri të marrëdhënieve seksuale me dhunë (përdhunimit), në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke u bazuar në “mungesën e pëlqimit vullnetar të shprehur në mënyrë të lirë” për secilin nga aktet seksuale të parashikuara nga neni 36 i Konventës së Stambollit.

Gjithashtu, nga analiza e përjasjes rezulton se ka nevojë që në Kodin tonë Penal të kryhen edhe ndryshime të tjera në lidhje me veprat penale të dhunës seksuale, të cilat kërkohen nga standardet ndërkombëtare dhe janë parashikuar në legjislacionet penale të mjaft shteteve anëtare të BE-së dhe Këshillit të Evropës, por në legjislacionin tonë mungojnë.

Konkretisht, për sa më sipër rekomandohet:

- Të ndryshojë përkufizimi i përdhunimit të grave të rritura në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe që nuk kërkon demonstrim e përdorimit të forcës apo rezistencës; (Ndryshimi i nenit 102 KP).
- Të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit me të mitur të moshës 14 - 18 vjeç në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe të mos kërkojë demonstrimin e përdorimit të forcës apo rezistencës. (neni 101 KP)
- Për vlerësimin e pëlqimit të plotë e të lirë të fëmijës, duhet t'i kushtohet rëndësi hendeikut të moshës ndërmjet dhunuesit dhe viktimës;
- Të rishikohet mosha minimale për dhënien e pëlqimit;
- Të detajohet dhe të plotësohet përkufizimi i marrëdhënieve seksuale me dhunë (përdhunimit), duke parashikuar edhe natyrën e veprimeve të dhunës seksuale si dhe objektet me të cilat mund të kryhet. Pra të detajohen sjelljet që përbëjnë përdhunim.
- Të parashikohet vepra penale sjellja seksuale pa pëlqimin e personit, sikurse e përshkruan Neni 36, pika 1, shkronjat *b* e Konventës: *përfshirja me një person pa pëlqimin e tij/saj në akte të tjera të një natyre seksuale (përveç penetrimit)*
- Të parashikohet si vepër penale nxitja që një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të një natyre seksuale pa pëlqimin e tij/saj.
- Të parashikohet si vepër penale sterilizimi i detyrueshëm/detyrimi për sterilizim.
- Të parashikohet si vepër penale gjymtimi gjenital.
- Sugjerojmë që të rishikohet neni 102.a i Kodit penal me qëllim që të shmangen parashikimet dhe gjuha diskriminuese për shkak të orientimit seksual dhe në përgjithësi të gjitha nenet që parashikojnë krimet seksuale, me qëllim shmangien e gjuhës diskriminuese.
- Rishikimin në tërësi të dispozitave për të gjetur cilësime të përshtatshme në gjuhën shqipe. Nuk na duket e përshtatshme që aktet e dhunës seksuale të quhen marrëdhënie seksuale me dhunë.
- Të rishikohen dënimet në mënyrë që të vendosen mbi bazën e parimit të proporcionalitetit.
- Të rishikohen të gjitha nenet që krijojnë një lidhje me dhunën seksuale me qëllim harmonizimin e tyre.
- Ndryshimet e propozuara të konsultohen me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë.

II- Kodi i Familjes dhe Kodi Civil në lidhje me martesën e hershme

Dispozitat e Kodit të Familjes dhe Kodit Civil janë analizuar në lidhje me pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare, përfshirë CEDAW, Konventën e OKB-së për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Konventën së Stambollit dhe legjislacionin e BE-së.

Në Kodin e Familjes (KF), moshja e lidhur me të drejtën për martesë është 18 vjeç dhe kjo është e unifikuar për të dy gjinitë. Por, parashikohen edhe përjashtime për martesë nën moshën ligjore (18 vjeç), të cilat mund të autorizohen vetëm nga gjykata (shih neni 7 KF).

Martesat në moshë të mitur ndikojnë negativisht në realizimin e një sërë të drejtash të kësaj grupmoshe siç është e drejta për arsimim dhe kualifikim, zhvillim, argëtime dhe kur këto martesë, në shumicën e rasteve, janë të brishta në aspektet që kanë të bëjnë me pëlqimin e lirë dhe si të tilla mund të kthehen në marrëdhënie të dëmshme e të rrezikshme që çojnë deri në shkelje të të drejtave të njeriut të fëmijës. Në sistemin shqiptar, Gjykata lipset të ndalet se sa rëndësi ka shkak i paraqitur ose pretenduar për të lejuar lidhjen e martesës nën moshë kundrejt shkeljes së detyrimit ligjor të moshës për martesë. Sipas rastit, gjykata, duhet të verifikojë nëse qëndrojnë ose jo shkaqet me rëndësi dhe sipas rastit mund të lejojë ose jo këtë martesë. Në këtë rast gjykata merr përsipër një rol me rëndësi.

Ndërkohë, nga analiza, vihet re mungesa e një dispozite që përcakton moshën minimale nën të cilën 'gjykata' nuk lejohet të japë këtë autorizim-leje si përjashtim nga moshja ligjore për t'u martuar. Gjithashtu, në praktikën gjyqësore, paraqiten probleme përfshirë ato lidhur me formën e vënies në lëvizje të gjykatës, legjitimitimin aktiv, verifikimin e pëlqimit të lirë, vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës, praninë e psikologut, provueshmërinë e 'shkaqeve me rëndësi', raportin mes 'shkaqeve me rëndësi' kundrejt pjekurisë fizike e psikologjike të të miturit dhe pëlqimin e prindërve. Mungesa e moshës minimale për martesën si dhe aspekte të tjera të praktikës gjyqësore janë evidentuar specifikisht edhe nga GREVIO si problematike për Shqipërinë në raportin e tij vlerësues në vitin 2017.

Si rrjedhojë, dispozita e Kodit të Familjes me moshën për martesë kanë nevojë të rishikohen në drejtim të:

- Saktësimi ligjor lidhur lejimin e martesës nën moshën. KF duhet të parashikojë një moshë minimum, nën të cilën nuk mund të lejohet lidhja e martesës as me vendim gjykate
- Saktësimeve ligjore lidhur me shkakun me rëndësi kundrejt interesit më të lartë të fëmijës dhe pjekurisë fizike e psikike
- Saktësimin e legjitimitimit aktiv në procedimet lidhur me martesën nën moshë
- Saktësimin e formës së kërimit në gjykatë për çështjet me objekt 'lejimi lidhje martese nën moshë'
- Vëmendje ligjore ndaj pëlqimit të lirë në rastin e lejimit të martesës nën moshë dhe vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës në vendimin e gjykatës
- Theksimit të rregullave të një procesi të rregullt dhe të së drejta për tu dëgjuar dhe informuar
- Përforcimi mbi rolin dhe pjesëmarrjen e psikologut dhe përfaqësuesit të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel lokal
- Ofrimit të ndihmës ligjore dhe psikologjike falas

Krahas këtyre, sugjerohen ndryshime të kritereve dhe afateve ekzistuese për kërkimin e pavlefshmërisë së martesës së detyruar, sepse kushtet në të cilat mund të kërkohet pavlefshmëria e martesës së detyruar

duken mjaft kufizuese. Po ashtu, sugjerohet të parashikohet bashkëjetesa si një bashkim fakti midis dy personave që jetojnë në çift dhe njëherazi të përcaktohet ndalesa për moshën nën 16 vjeç.

Rishikimi i Kodit të Familjes në lidhje me martesat e hershme u shoqërua edhe me një analizë të dispozitave të ndërlidhura të Kodit Civil. Analiza konkludoi se të dy Kodet nuk janë mirapërburë për shkak se Kodi Civil është më i vjetër në kohë dhe është miratuar gati 9 vjet përpara Kodit të Familjes, duke shkuar i përjashtuar me Kodin e vjetër të Familjes që lejonte martesën e vajzës nën moshën 16 vjeç, ndërsa të djalit 18 vjeç. Për këtë arsye, duhet të harmonizohen të dy Kodet në fuqi me njëri-tjetrin.

-III- Kodi Penal në lidhje me ngacmimin seksual në marrëdhëniet e punës

Dhuna, ngacmimi, përfshirë ngacmimi seksual janë dukuri të pranishme në mjedisin e marrëdhënieve të punës në Shqipëri. Krahas, Konventës së Stambollit, që rregullon format kryesore të dhunës ndaj grave, Shqipëria ka ratifikuar edhe Konventën No.190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) mbi Dhunën dhe Ngacmimin në Botën e Punës - të dy këto instrumente me rëndësi të cilat vendosin detyrime për përmirësime ligjore në fushën e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri.

Sipas konventës Nr.190 të ONP-së, me qëllim zbatimin e përjashtes gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të përgjegjshme për gjininë, Shqipëria duhet të adresojnë dhunën dhe ngacmimin në botën e punës si dhe sigurinë dhe shëndetin në punë në legjislacionin për barazisë dhe mos-diskriminimin, si dhe në dhe në të drejtën penale, sipas rastit. Gjithashtu, në bazë të Konventës së Stambollit, Neni 40 – Ngacmimi seksual, Palët duhet të marrin masat e *nevojshme legjislative* ose masa të tjera për të garantuar që çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, t'i nënshtrohet një sanksioni penal ose sanksioni tjetër ligjor.”

Kodi Penal shqiptar, megjithëse nuk adreson në mënyrë specifike dhunën dhe ngacmimin në fushën e marrëdhënieve të punës, ka miratuar dispozita për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, të drejtave dhe lirive të njeriut për çdo person duke konsideruar gjithashtu mbrojtjen nga dhuna dhe ngacmimi edhe në këto marrëdhënie. Por, disa prej këtyre dispozitave dhe konkretisht Neni 108/a: Ngacmimi seksual dhe Neni 121/a: Përndjekja duhet të plotësohen duke specifikuar edhe dhunën dhe ngacmimin në botën e punës si, duke nënvizuar veprimet brenda veprave penale të ngacmimit seksual dhe përndjekjes, që kryhen në vendin e punës ose në lidhje me punën si dhe pasojat që çojnë në çrregullime dhe sëmundje psikologjike, psikosomatike ose fizike ose me ulje të produktivitetit të punës së të dëmtuarit/të dëmtuarës si pasojë e ngacmimit.

Gjithashtu, është e rëndësishme të diskutohet nëse është e nevojshme që veprat të parashikojë rastet e abuzimit me autoritetin kur viktimat janë të vulnerabil për shkak të moshës, sëmundjes, paftësisë fizike ose mendore, shtatzënisë; ose viktimë e dhunës në familje.

VI-Kodi Civil në lidhje me regjimin e bashkëpronësisë në familjen bujqësore

Shqipëria paraqitet si rasti unik në rajon, ku konceptin e familjes bujqësore, pas viteve '90 të tranzicionit nga regjimi komunist, e trajtoi ndryshe nga vendet e tjera të Evropës Juglindore. Në Shqipëri tokat bujqësore, të cilat ishin të gjitha në pronësi shtet para viteve '90, iu ndanë paraprakisht fshatarëve të cilët i kishin në posedim, nëpërmjet ligjit të miratuar 7501, datë 19.07.1991 dhe më pas ato që do të mbeteshin do tu jepeshin ish pronarëve.

Dispozitat mbi bashkëpronësinë në familjen bujqësore, të përcaktuar në Kodin Civil në vitin 1994, si një lloj i veçantë i bashkëpronësisë, në praktikë kanë sjellë cenim të barazisë gjinore, duke favorizuar burrat e familjes. Këto dispozita nuk kanë pësuar asnjë ndryshim deri në ditët e sotme, ndërkohë që i ka dhënë mundësi ligjeve të ndryshme, por edhe praktikës gjyqësore për të interpretuar në mënyra të ndryshme identifikimin e bashkëpronarëve në familjen bujqësore.

Kjo çështje është ngritur edhe në Vëzhgimet Përfundimtare të Komitetit CEDAW drejtuar Shqipërisë në vitin 2016, ku theksohej“.....Përsa i përket martesës dhe marrëdhënieve familjare, vetëm një përqindje e vogël e grave në Shqipëri (8%) kanë në pronësi tokë..... Edhe praktika e ALUIZNI-t, sipas të cilës ndërtimet informale regjistohen në emër të të ashtuquajturit “kryetari i familjes”, konsiderohet diskriminuese ndaj grave...”.

Në gjithë këto vite të zbatimit të Kodit Civil dhe të akteve ligjore e nënligjore mbi disponimin e pasurisë së familjes bujqësore, evidentohen tre praktika të ndryshme në lidhje me identifikimin e bashkëpronarëve në familjen bujqësore, në rastet e tjetërsimit të pasurisë:

1. Praktika që konsideron si bashkëpronarë vetëm anëtarët e familjes bujqësore që kanë qenë në certifikatën familjare të kryefamiljarit në vitin 1991 (përkatësisht 01 Gusht 1991 ose 01 Tetor 1992).
2. Praktika që konsideron si bashkëpronarë vetëm anëtarët e familjes bujqësore që janë aktualisht në certifikatën familjare të kryefamiljarit në çastin (datën) e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.
3. Praktika që konsideron si bashkëpronarë anëtarët e familjes bujqësore që kanë qenë në certifikatën familjare të kryefamiljarit në vitin 1991 dhe anëtarët e familjes bujqësore që janë aktualisht në certifikatën familjare të kryefamiljarit në çastin e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.

Si rrjedhim, pasiguria në gëzimin dhe disponimin e të drejtave të pasurisë së paluajtshme në familjen bujqësore ka qenë shumë e dukshme dhe është reflektuar edhe tek institucionet zbatuese të ligjit (noterët, gjyqtarët, juristët e kadastrës, avokatë, etj.).

Nga analiza e bërë në raport, konstatohet se në përgjithësi parimi i njohjes në mënyrë të barabartë të të drejtës së grave dhe burrave për të poseduar pasuri dhe lidhur kontrata pronësisë në bazë të Konventës CEDAW dhe standardeve të tjera ndërkombëtare nuk është zbatuar në të gjitha rastet për pasuritë dhe veçanërisht për familjen bujqësore. Ligjet që u miratuan për shitblerjen e tokës bujqësore, në vitin '95 dhe veçanërisht në vitin 1998, favorizuan më tepër kryefamiljarin (kryetarin e familjes, i cili rezulton të jetë burri, vjehri, vëllai i familjes), të cilit i njihen më shumë attribute në lidhje me pasurinë dhe përfaqësimin e familjes bujqësore.

Si e tillë, familja bujqësore kërkon një trajtim specifik në Kodin Civil e cila duhet të pasohet me rregullimin e saj në aktet ligjore dhe nënligjore, për të qartësuar bashkëpronarët e saj dhe për të mos cenuar në aspektin gjinor asnjë nga anëtarët që për shkak të martesës (veçanërisht gratë), mund të largohen nga certifikata e përbërjes familjare e origjinës dhe/ose mund të hyjnë në certifikatën familjare të familjes bujqësore (për shkak të martesës, ndarjes nga familja, largimit nga jeta, etj.). Kërkohej qartësi janë të nevojshme edhe sa i përket edhe anëtarëve të rinj të familjes bujqësore, për shkak të martesës, birësisimit, pranimit si anëtarë të rinj, etj. Gjithashtu kërkohej të specifikohet roli i tyre në bashkëpronësinë e familjes bujqësore.

Një problem tjetër është përputhshmërie ndërmjet certifikatës familjare të gjendjes civile me pwrbrwrjen reale të familjen bujqësore. E para mund të ndryshojë menjëherë vetëm me pëlqimin e kryefamiljarit, i cili kërkon shkëputjen nga anëtarët e tjerë të familjes. Por ky ndryshim, reflekton negativisht për anëtarët e tjerë në familjen bujqësore, sepse mund ti përjashtojë ata nga disponimi i pasurisë së paluajtshme.

Nisur nga problematikat e konstatuara në praktikë nga noterët dhe kadastra, si dhe nga ato të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë, evidentojmë se nëpërmjet ndryshimeve në Kodin Civil, do të qartësohet më mirë bashkëpronësia në familjen bujqësore për:

- rastet e hyrjes së anëtarëve të rinj në familjen bujqësore,
- rastet e largimit të anëtarëve të familjes bujqësore,
- në çfarë mase bëhet përfaqësimi i kryetarit në familjen bujqësore
- trashëgimia e familjes bujqësore.

Analiza e Kodit Penal në Lidhje me Krimet Seksuale

Përmbajtja:

1. Kodi Penal dhe standardet ndërkombëtare në lidhje me përkufizimin e dhunës seksuale
2. Kodi Penal dhe standardet ndërkombëtare në lidhje forma specifike të dhunës seksuale

Ky raport ka qëllim të kontribuojë në përmirësimin e dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, për të përmbushur kërkesat e parimit kushtetues të barazisë gjinore; konkretisht, të dispozitave mbi dhunën seksuale, për t'i përqasur ato me standardet ndërkombëtare të sanksionuara nga Konventat Ndërkombëtare, si dhe gjykatat ose organet e ndërkombëtare, si dhe nga e drejta e BE-së. Studimi fillimisht trajton çështjen e përkufizimit të dhunës seksuale mbi bazën e mungesës së shprehur të pëlqimit dhe me pas aspektet e tjera të krimeve seksuale.

Metodologjia: Analiza e përqasjes përmes studimit krahasimor të dispozitave të Kodit Penal me ato të konventave ndërkombëtare, të mënyrë të veçantë Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit) dhe Konventës së OKB-së për eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW-t), jurisprudencës ndërkombëtare dhe legjislacionit të BE-se. Raporti u diskutua në tryezën e konsultimit me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe të shoqërisë civile, të cilët mbështetën gjetjet dhe ndihmuan me sugjerimet e tyre. Sugjerimet e tyre janë përfshirë në këtë raport.

1. Kodi Penal dhe standardet ndërkombëtare në lidhje me përkufizimin e dhunës seksuale

1.1 Legjislacioni shqiptar

Krimet seksuale janë parashikuar në nenet 100-108/a të Kodit Penal, dhe përbëjnë 12 nene me figura të ndryshme të krimeve seksuale.

Në bazë të nenit 102 të Kodit Penal, Marrëdhënia seksuale me të rritura konsiderohet përdhunim, kur plotësohet kushti i përdorimit të forcës ose dhunës nga njëra palë. Mungesa e pëlqimit kërkohet si kusht vetëm për përdhunimin midis bashkëshortëve ose bashkëjetuesve. Përdorimi i forcës është gjithashtu edhe elementi kryesor për veprën penale të dhunës seksuale ndaj të miturve/të miturave nga 14 deri 18 vjeç (neni 101) dhe në marrëdhëniet homoseksuale (neni 102/1). Në të gjitha këto raste, barra e provës i ngarkohet viktimës, e cila duhet të provojë përdorimin e dhunës ndaj saj/tij si dhe rezistencë.

1.2 Konventa e Stambollit (KS).

Nga ana tjetër, Konventa e Stambollit, në të cilën Shqipëria është bërë Palë që në vitin 2014 dhe në bazë të Kushtetutës është pjesë e legjislacionit të brendshëm me fuqi mbilgjore ka afirmuar si standard ***për dënimin e ushtrimit të dhunës seksuale mungesën e pëlqimit nga i dhunuari dhe jo medoemos përdorimin e forcës, ose të dhunës.*** Në nenin 36 të Konventës theksohet qartë se elementi kryesor i

dhunës seksuale është mungesa e pëlqimit të dhënë nga viktimja dhe jo përdorimi i forcës ose dhunës që ka pësuar viktimja. Këto dy koncepte kanë një dallim thelbësor midis tyre dhe është mirë që të analizohen duke u diferencuar saktësisht se çfarë do të thotë kjo për procesin penal.

Konventa e Stambollit

Neni 36 – Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjelljeve të mëposhtme të qëllimshme:

- a) përfshirja në depërtim vaginal, anal ose oral të një natyre seksuale, në trupin e një personi tjetër **pa pëlqimin e tij/saj** me pjesë trupore ose objekte;
- b) përfshirja me një person pa pëlqimin e tij/saj në akte të tjera të detyruara të një natyre seksuale;
- c) nxitja që një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të një natyre seksuale **pa pëlqimin e tij/saj**

2 Pëlqimi duhet të jepet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit të vlerësuar në kontekstin e rrethanave më të afërta.

3 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që dispozitat e paragrafit 1 të zbatohen edhe për aktet e kryera kundër ish bashkëshortëve/partnerëve ose bashkëshortëve/partnerëve aktualë, të njohur nga ligji i brendshëm.

Ky përkufizim në mënyrë të qartë nuk e vë theksin te përdorimi i forcës nga përdhunuesi ose kërcënimi për përdorim force. Gjithashtu, ky përkufizim nuk kërkon që viktimja të provojë rezistencë ndaj përdhunimit.

Në zbatimin e kësaj dispozite, Palët e Konventës së Stambollit, përfshirë Shqipërinë, duhet të marrin masa që legjislacioni i tyre penal të bazohet në “mungesën e pëlqimit vullnetar të shprehur në mënyrë të lirë” për secilin nga aktet seksuale të parashikuara nga neni 36 i KS. Megjithatë, Konventa e lë në diskrecionin e Shteteve Palë të vendosin mbi formulimet specifike në legjislacion e brendshëm si dhe faktorët që konsiderohen si pengesë për dhënien e pëlqimit të lirë. Paragrafi 2 specifikon vetëm që pëlqimi duhet dhënë në bazë të vullnetit të lirë të personit dhe të vlerësohet sipas rrethanave përkatëse.²

Kjo është një çështje që është ngritur edhe nga Grupi i Pavarur i Ekspertëve të Konventës së Stambollit (GREVIO) në raportin e parë vlerësues ndaj Shqipërisë, të hartuar në vitin 2017, ku theksohet që përkufizimi i përdhunimit në Kodin Penal, bazuar në përdorimin e dhunës, nuk është në përputhje me Konventën e Stambollit. Sipas këtij përkufizimi, viktimja ka barrën e provës në përdorimin e forcës, por kur viktimja e ka të pamundur të shfaqë rezistencë, rasti i përdhunimit mund të mos raportohet ose të ndiqet penalisht. Gjithashtu, po sipas GREVIOs, në Shqipëri nuk ka të dhëna për një interpretim të gjerë të elementeve të forcës, duke krijuar kështu pengesa të konsiderueshme që viktimat të kenë akses në drejtësi.³ Për sa më sipër, GREVIO u kërkoi autoriteteve shqiptare:

- a. të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit të grave të rritura në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe që nuk kërkon demonstrim e përdorimit të forcës apo rezistencës;
- b. të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit me të mitur të moshës 14 - 18 vjeç në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe të mos kërkojë demonstrimin

² Këshilli i Evropës, Raport Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), 2011

³ Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), Raporti Bazë Vlerësues I Shqipërisë, 2017

- e përdorimit të forcës apo rezistencës. Për vlerësimin e pëlqimit të plotë e të lirë të fëmijës, duhet t'i kushtohet rëndësi hendekut të moshës ndërmjet dhunuesit dhe viktimës;
- c. të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit me të mitur të moshës 14 - 18 vjeç, në mënyrë që ai të mos varet nëse viktima ka arritur moshën e pjekurisë apo jo;
 - d. të kriminalizojnë sjelljen seksuale pa pëlqimin e personit që përshkruan Neni 36, pika 1, shkronjat *b* dhe *c* të Konventës;

Edhe Komiteti i Shteteve Palë të Konventës së Stambollit , në konkluzionet e vitit 2021, i rekomandoi Shqipërisë: “Ndryshimin e përkufizimit të përdhunimit dhe dhunës seksuale për ta përafuar atë me kërkesat e nenit 36 të Konventës”.

1.3. Komiteti CEDAW

Në mënyrë të ngjashme, Komiteti CEDAW i cili ka autoritetin të interpretojë dispozitat e Konventës së CEDAW-t, në Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 35 u kërkon Shteteve Palë të sigurojnë që përkufizimi i krimeve seksuale në legjislacionin e tyre të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë më mënyrë të lirë dhe jo në rrethana kërcënuese.⁴

1.4. Jurisprudenca Ndërkombëtare

Dispozita 36 e Konventës së Stambollit bazohet veçanërisht në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe konkretisht çështjes M.C. kundër Bullgarisë, ku Gjykata është shprehur: *“Një qasje e ngurtë e ndjekjes penale të krimeve seksuale, si ajo që kërkon provë për rezistencë fizike në të gjitha rrethanat, rrezikon të sjellë që disa forma të përdhunimit të mos ndiqen penalisht, duke rrezikuar kështu mbrojtjen efektive të autonomisë seksuale të individëve. Në përputhje me standardet dhe tendencat bashkëkohore në këtë fushë, detyrimet pozitive të shteteve anëtare sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës duhet të konsiderohen që kërkojnë penalizimin dhe ndjekjen penale efektive të çdo akti seksual jo-konsensual, duke përfshirë mungesën e rezistencës fizike nga viktima”* (§ 166). GEDNJ-ja gjithashtu, vë në dukje se: *“Pavarësisht nga formulimi specifik i zgjedhur nga legjislativi, në një numër vendesh ndjekja penale e akteve seksuale pa pëlqim në të gjitha rrethanat kërkohet në praktikë me anë të interpretimit të kushteve përkatëse statutores (“shtrëngim”, “dhunë”, “detyrim”, “kërcënim”, “mashtim”, “surprizë” apo të tjera) dhe nëpërmjet një vlerësimi të ndjeshëm ndaj kontekstit të provave”* (§ 161).⁵

Për këtë situatë është shprehur edhe Komiteti CEDAW në ankimin *Vertido k. Filipineve*, ku theksohet se *“nuk duhet të ketë asnjë supozim në ligj apo në praktikë që një grua jep pëlqimin e saj për shkak se ajo nuk i ka rezistuar fizikisht sjelljes së padëshiruar seksuale, pavarësisht nëse dhunuesi ka kërcënuar ose ka përdorur dhunë fizike”*. “Nëpërmjet shqyrtimit të raporteve të shteteve palë, Komiteti ka sqaruar herë pas here se përdhunimi përbën shkelje të së drejtës së grave për sigurinë personale dhe integritetin trupor dhe se elementi thelbësor i tij është mungesa e pëlqimit”. Në përfundim Komiteti kërkoi rishikimin e përkufizimit të përdhunimit në legjislacionin filipinas për të vendosur mungesën e pëlqimit në qendër të tij.⁶

1.5 Praktika e shteteve të tjera

Një sërë shtetesh Evropiane, përfshirë edhe në rajonin tonë, kanë marrë nisma ligjore për përkufizimin e marrëdhënies seksuale të bazuar në mungesën e pëlqimit, si përdhunim dhe penalizimin e saj nga ligji

⁴ Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, Rekomandimi I Përgjithshëm Nr.35, mbi Dhunën me Bazë Gjinore ndaj Grave, 2017

⁵ MC k. Bullgarisë, GJEDNJ, 2004, https://ëëë.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/resources/M.C.v.BULGARIA_en.asp

⁶ CEDAW Committee Communication No. 34/2011, R. P. B. v. the Philippines

penal. Të tilla janë: Austria, Belgjika, Kroacia, Qipro, Danimarka, Finlanda, Gjermania, Greqia, Islanda, Irlanda, Luxembourgu, Malta, Mali i Zi, Portugalia, Spanja, Sllovenia, Suedia dhe Britania e Madhe.⁷

Në bazë të një analizë te realizuar nga GREVIO, në përgjithësi ndryshimet legislative në këto vende konsistojnë në tre qasje kryesore⁸:

- *Qasja me dy nivele*. Kjo nënkupton mbajtjen e dispozitës së përdhunimit që kërkon përdorimin e forcës/kërcënimit/shtrëngimit dhe shtimin e një dispozite tjetër që bazohet tërësisht në pëlqimin.
- *E dyta është qasja "jo-nënkupton-jo"*. Kjo nuk kërkon përdorimin e forcës/kërcënimit/shtrëngimit, por kërkon që marrëdhëniet seksuale të kenë ndodhur "kundër vullnetit të një personi". Për procedimin penal kjo do të thotë se duhet vërtetuar me siguri se veprimi ka ndodhur "kundër vullnetit të personit".
- *Qasja e tretë është "vetëm-po-do të thotë-po"*. Kjo bazohet në pëlqimin, por në mënyrë të qartë e vendos përgjegjësinë mbi dhunuesin - i takon atij që të vërtetojë se akti ndodhi në bazë të vullnetit të lirë të viktimës në vend që viktima të provojë që ka dhënë pëlqimin ose mungesën e tij. Formulimi është i ndryshëm nga qasja "jo-nënkupton-jo" sepse kriminalizon marrëdhëniet ose çdo akt tjetër seksual me një person "i cili nuk merr pjesë vullnetarisht", në krahasim me "kundër vullnetit të një personi".

Sipas kësaj analize, në lidhje me qasjen e parë shtrohet çështja se dispozita e cila kërkon përdorimin e forcës shoqërohet me një dënim më të ashpër me burg në krahasim me atë ku kërkohet vetëm mungesa e pëlqimit. Kjo mund të sjellë një klasifikim të llojeve të ndryshme të veprave penale të përdhunimit, duke i ndarë në, vepra që meritojnë dënim më të ashpër se të tjerat. Kjo mund të shihet si promovimi i idesë së ekzistencës së veprës penale të "përdhunimit të vërtetë" kundrejt veprave të tjera penale. Një shembull i kësaj është legjislacioni austriak që përmban një vepër penale për përdhunimin, si dhe një tjetër për shkeljen e integritetit seksual. Për veprën penale kundër integritetit seksual, rreziku është që procedurat penale të kenë si element qendror shprehjen e vullnetit, duke i kushtuar vëmendje të tepërt sjelljes së viktimës, dhe duke rezultuar në ndëshkimin për shkeljen e integritetit seksual në vend të dënimit për përdhunim, pasi mungesa e pëlqimit nuk mund të vërtetohet qartë. Ligji austriak mund të shihet si një shembull i kësaj praktike.⁹

Përsa i përket qasjes së tretë, qëllimi është të sigurojë që procedura penale të fokusohet në sjelljen e autorit dhe jo në atë të viktimës. Suedia përdor këtë qasje dhe më tej prezantoi edhe "përdhunim nga pakujdesia", i cili do të lejonte dënimet për ata autorë që duhet të dinin (por nuk e dinin) se viktima nuk pranoi, pra nuk e kishte dhënë pëlqimin. Kjo do të thotë se nuk ka më vend për justifikime. Një mundësi tjetër është dallimi përmes rrethanave rënduese dhe lehtësuese. Kështu, mund të parashikohet në Kod një vepër e vetme penale "model me një krim", që ofron vetëm një përkufizim të përdhunimit i cili bazohet në mungesën e pëlqimit. Kur përdoret dhuna ose forca, mund të zbatohen rrethana rënduese. Vende që kanë një praktikë të ngjashme janë Malta, Belgjika dhe Danimarka.¹⁰

⁷ Amnesty International: Le të flasim për "PO": Ligjet e bazuara në pëlqim në Evropë", 2020,

<https://www.amnesty.org/en/latest/campaigns/2020/12/consent-based-rape-laws-in-europe/>; Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO):Analizë e Raporteve Bazë të Vlerësimit të GREVIOs, 2022 <https://rm.coe.int/prems-010522-gbr-grevio-mid-term-horizontal-revieë-rev-february-2022/1680a58499>

⁸ Prezantim nga Marceline Naudi, Presidente e Grupit të Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) of the Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO) në Takimin e Grupit të Ekspertëve të Raportuesit Special të OKB-së mbi Dhunën ndaj Grave; [Raport mbi përdhunimin si një dhunim I rëndë dhe sistematik I të drejtave të njeriut](#), 2020; Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO):Analizë e Raporteve Bazë të Vlerësimit të GREVIOs, 2022 <https://rm.coe.int/prems-010522-gbr-grevio-mid-term-horizontal-revieë-rev-february-2022/1680a58499>

⁹ Ibid.

¹⁰ Ibid

1.6 E drejta e Bashkimit Evropian

Drejtesia është një sektor që kryesisht, përfshihet në përgjegjësinë e secilit prej shteteve anëtare të BE-së. Në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, legjislacionin e BE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare, shtetet duhet të sigurojnë akses në drejtësi për të gjithë personat në juridiksionet e tyre.

Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2025 konfirmon se Komisioni Evropian është mjaft i angazhuar për të parandaluar dhe luftuar dhunën me bazë gjinore, për të mbështetur dhe mbrojtur viktimat dhe për t'i mbajtur autorët përgjegjës. Strategjia për Barazinë Gjinore parashikon një sërë masash ambicioze për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje.

Në legjislacionin e BE-së, çështjet gjinore në fushën e drejtësisë, mbulohet nga disa direktiva dhe rregullore, veçanërisht në fushat e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale dhe në çështjet e garancive procedurale penale, si dhe të mbrojtjes së viktimave (veçanërisht në lidhje me parandalimin e krimit dhe të drejtat e viktimave të krimit).¹¹ Shteti Shqiptar, me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, të cilat hynë në fuqi në vitin 2017, sanksionoi të drejtat e viktimave në procesin penal, në qasje me Direktivën 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 25 tetor 2012. Kjo Direktivë vendos standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit¹².

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – ‘Konventa e Stambollit’ – është pikë referimi për BE-në në këtë fushë. BE nënshkroi Konventën në vitin 2017, duke sinjalizuar synimin për t'u bërë palë në këtë marrëveshje më të avancuar të të drejtave të njeriut për mbrojtjen e grave nga dhuna. Përfundimi i anëtarësimit të BE-se në këtë Konventë është një prioritet kyç për Komisionin.¹³

Aktualisht, asnjë instrument ligjor specifik nuk trajton dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në nivel të BE-së. Megjithatë, më 8 mars 2022, Komisioni miratoi një propozim për një direktivë për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. **Propozimi, i cili ende nuk është miratuar nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian, ndër të tjera parashikon marrjen e masave për penalizimin e përdhunimit, bazuar në mungesën e pëlqimit** (pasi në disa Shtete Evropiane përdorimi i forcës ose kërcënimi mbeten ende kushtet kryesore).¹⁴ Ky është një moment kyç për përjasjen e dispozitave të Krimeve seksuale të Kodit Penal të RSh-së, me legjislacionin e BE-së, duke mbajtur parasysh edhe nevojat e përjasjes së legjislacionit në kuadrin e negociatave për anëtarësimin e në BE.

Konkluzion:

Dispozitat e Kodit Penal Shqiptar që parashikojnë krimet seksuale nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi përkufizimin e përdhunimit të grave të rritura dhe të të miturve të moshës 14-18 vjec. Gjithashtu, ka një ometim të detajeve që përbëjnë përdhunimin, ometim që mund të shpjerë në mosdënimin e krimeve dhe të autorëve të tyre.

Rekomandim:

¹¹ Komisioni Evropian, Fundi i Dhunës ndaj Grave: Çfarë po Bën Bashkimi Evropian, 2023, https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-based-violence/ending-gender-based-violence_en

¹² Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 25 tetor 2012. Një tjetër Direktivë, Direktiva e Këshillit të BE-së 2004/80/EC “Për kompensimin e viktimave të krimit”, rregullon aksesin ndërkufitar të viktimave të krimit ndaj kompensimit të dëmit në shtetet anëtare të këtij bashkimi.

¹³ Komisioni Evropian, Fundi i Dhunës ndaj Grave: Çfarë po Bën Bashkimi Evropian, 2023, https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-based-violence/ending-gender-based-violence_en

¹⁴ Komisioni Evropian, Propozimi për një Direktivë Parlamentit dhe Këshillit Evropian për Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 8 Mars 2022, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52022PC0105&from=EN>

Shqipëria, si shtet Palë në Konventën e Stambollit, Konventën CEDAW dhe nën detyrimin të zbatojë standardet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut duhet të nisë procedurat për rishikimin e Kodit Penal përsa i përket përfshirjes së elementit të pëlqimit në përkufizimin e marrëdhënieve seksuale me dhunë.

Në lidhje me përkufizimin, sugjerohet që përkufizimi i nenit 36 të Konventës së Stambollit të shërbejë si referencë kryesore, sigurisht brenda hapësirës që kjo Konventë u ka lënë shteteve të vendosin mbi formulimet specifike në legjislacionin e brendshëm si dhe lidhur faktorët që konsiderohen si pengesë për dhënien e pëlqimit të lirë. Gjithashtu, praktikat e vendeve të tjera që kanë bërë hapa pozitive në këtë drejtim duhen të merren në konsideratë. Konkretisht,

- të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit të grave të rritura në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe që nuk kërkon demonstrim e përdorimit të forcës apo rezistencës;
- të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit me të mitur të moshës 14 - 18 vjeç në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe të mos kërkojë demonstrim e përdorimit të forcës apo rezistencës. Për vlerësimin e pëlqimit të plotë e të lirë të fëmijës, duhet t'i kushtohet rëndësi hendeikut të moshës ndërmjet dhunuesit dhe viktimës;
- Të rishikohet mosha minimale për dhënien e pëlqimit;

2. Kodi Penal dhe standardet ndërkombëtare në lidhje forma specifike të dhunës seksuale

Krahas çështjes së elementit të pëlqimit përsa i përket përdhunimit të të rriturave (neni 102), të miturve të moshës 14-18 (neni 101) i gjithë Seksioni VI i Kodit Penal – Krime Seksuale – ka nevojë të rishikohet, me qëllim që të sigurohet pajtueshmëri e plotë me Konventën e Stambollit dhe praktikën ndërkombëtare. Nga kjo pikëpamje, ka një ometim të detajeve që përbëjnë përdhunimin, që mund të na shpjegojë në shkëlqim e të drejtave të viktimave ose të të pandehurve për këtë veprë penale. Po ashtu, disa forma të dhunës seksuale të njohura si të tilla nga standardet ndërkombëtare, nuk janë parashikuar në legjislacionin shqiptar.

2.1. Ometim i veprimeve që përbëjnë përdhunimin, sipas nenit 36 të Konventës së Stambollit

- *Neni 36 (1/a): përfshirja në depërtim vaginal, anal ose oral të një natyre seksuale, në trupin e një personi tjetër pa pëlqimin e tij/saj me pjesë trupore ose objekte;*

Në paragrafin 1.a të nenit 36, Konventa e Stambollit përcakton në mënyrë të detajuar aktet që përbëjnë dhunë seksuale/përdhunim, duke iu referuar penetrimit vaginal, anal ose oral në trupin e një personi tjetër, për të cilin ky i fundit nuk ka dhënë pëlqimin. Penetrimi mund të kryhet me organe trupore ose objekte. “Duke kërkuar që penetrimi të ketë natyrë seksuale, draftuesit e Konventës së Stambollit janë përpjekur të përcaktojnë kufizimet e kësaj dispozite dhe të shmangin problemet që mund të shfaqen në lidhje me interpretimin.”¹⁵

Ndërkohë, në Kodin Penal shqiptar, në nenin 102 - Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura - dhe në dispozitat e tjera për dhunën ndaj subjekteve të tjera mungon detajimi i akteve specifike që përbëjnë përdhunim. Pra, “marrëdhënia seksuale me dhunë” sipas legjislacionit shqiptar përfshin penetrimin, por pa e specifikuar të çfarë natyre, në përputhje me Konventën e Stambollit (Paragrafi 1/a i nenit 36);

- *Neni 36 (1/b): përfshirja me një person pa pëlqimin e tij/saj në akte të tjera të një natyre seksuale.*

¹⁵ Këshilli i Evropës, Raport Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), 2011, <https://rm.coe.int/1680a48903>

Ky paragraf ka të bëjë me të gjitha aktet e një natyre seksuale, që nuk përfshijnë penetrimin, pa pëlqimin e lirë të njëres nga palët.¹⁶ Kjo dispozitë mungon në legjislacionin shqiptar.

- *Neni 36 (1/c) e KSL nxitja që një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të një natyre seksuale pa pëlqimin e tij/saj.* Ky paragraf përfshin situata, në të cilat viktimat pa pëlqimin e tij/saj shtyhet ose detyrohet nga dhunuesi të kryejë ose përfshihet në akte të një natyre seksuale me një person tjetër (pra jo dhunuesin). Kjo pasi, në marrëdhënie abuzuese, viktimat shpesh detyrohen të përfshihen në akte seksuale me një person të zgjedhur nga dhunuesi.

Në Kodin Penal shqiptar mungon një vepër penale që të dënojë detyrimin/nxitjen nga dhunuesi për përfshirjen e viktimës në akte seksuale pa pëlqimin e tij/saj me persona të tjerë (Paragrafi 1/c, i nenit 36 të Konventës së Stambollit). Ne veçanti, ky aspekt është identifikuar si një mangësi nga GREVIO në raportin e parë vlerësues të Shqipërisë. Ndërkohë, një sërë legjislacionesh të vendeve të tjera evropiane e përfshijnë specifikisht këtë dispozitë si vepër penale në legjislacionin e tyre. Për këtë mund t'i drejtohemi Analizës së Raporteve Bazë të Vlerësimit të GREVIOs, 2022.¹⁷

2.2 Gjymtimi i organeve gjenitale femërore

Konventa e Stambollit, në nenin 38, parashikon si një nga format e dhunës ndaj grave, gjymtimin e organeve gjenitale femërore, që përkufizohet si:

- a. prerja, infibulimi ose kryerja e ndonjë gjymtimi tjetër për të tërë ose një pjesë të buzëve të mëdha, buzëve të vogla ose klitorit të gruas;
- b. shtrëngimi ose kërkesa ndaj një gruaje që t'i nënshtrohet ndonjë prej akteve të renditura në pikën a;
- c. provokimi, shtrëngimi ose kërkesa ndaj një vajze që t'i nënshtrohet ndonjë prej akteve të renditura në pikën a.

Kjo dispozitë mungon në Kodin Penal dhe është ngritur si një ndër problematikat në legjislacionin shqiptar nga GREVIO në raportin vlerësues të Shqipërisë. Në këtë raport, theksohet, se sjellja e përshkruar në nenin 38, pika a, e Konventës të Stambollit mund të ndiqet penalisht sipas nenit 88 të Kodit Penal, i cili rregullon çdo dëmtim të qëllimshëm që shkakton gjymtim ose ndonjë dëm tjetër të përhershëm ndaj shëndetit. Megjithatë nuk është e qartë nëse në praktikë gjykatat do të përdorin një vepër të tillë për të sanksionuar gjymtimin gjenital femëror. Gjithashtu, ky raport thekson se në Shqipëri, nuk ka dënime të regjistruara për ndonjë sjellje që cilësohet si gjymtim gjenital femëror, e cila është kryesisht e huaj për praktikën dhe traditën shqiptare. Kjo do të shpjegonte mungesën e njohurive dhe mirëkuptimit në lidhje me këtë formë të dhunës ndaj grave nga profesionistët në fjalë. Megjithatë, fluksi i azilkërkuesve dhe emigrantëve në vend nga vende ku kjo traditë e dëmshme praktikohet, është cituar nga aktorët e fushës si shkak i viktimave të kësaj forme dhune ndaj grave që hyjnë në Shqipëri, dhe si rrjedhim si një arsye për t'u përgatitur për të identifikuar dhe trajtuar siç duhet viktimat e gjymtimit gjenital femëror.¹⁸ Për më tepër, e gjithë përvoja e zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje dhe kundër diskriminimit gjinor, ka dëshmuar se parashikimet ligjore kanë qenë një shtysë e mirë për raportimin e ngjarjeve dhe fenomeneve të dhunës dhe për rrjedhojë për identifikimin dhe parandalimin e tyre. Një sërë vendesh evropiane si Italia,

¹⁶ Ibid.

¹⁷ Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO): Analizë e Raporteve Bazë të Vlerësimit të GREVIOs, 2022 <https://rm.coe.int/prems-010522-gbr-grevio-mid-term-horizontal-revieë-rev-february-2022/1680a58499>

¹⁸ Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), Raporti Bazë Vlerësues I Shqipërisë, 2017, <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>

Monako, Mali i Zi, Portugalia, Serbia dhe Spanja kanë përfshirë një vepër të dedikuar për gjymtimin në legjislacionin e tyre pas ratifikimit të Konventës së Stambollit.¹⁹

2.3 Detyrimi për Sterilizim

Neni 39 i Konventës së Stambollit parashikon ndërprerjen e detyruar të shtatzënisë dhe sterilizimin e detyruar si forma dhune ndaj grave. Neni 93 i Kodit Penal e penalizon abortin pa pëlqimin e gruas shtatzënë me sanksion gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Megjithatë, mungon një dispozitë që kriminalizon sterilizimin e detyruar.

Konventa e Stambollit nuk ka si qëllim të kriminalizojë çdo ndërhyrje mjekësore ose procedurë kirurgjikale që kryhet për shembull me qëllim të ndihmës së një gruaje duke i shpëtuar jetën e saj ose për të ndihmuar një grua që nuk ka aftësi për të dhënë pëlqimin. Përkundrazi, qëllimi i kësaj dispozite është të theksojë rëndësinë e respektimit të të drejtave riprodhuese të grave duke i lejuar gratë të vendosin lirisht për numrin dhe ndarjen e fëmijëve të tyre dhe duke siguruar aksesin e tyre në informacionin e duhur mbi riprodhimin natyror dhe planifikimin familjar.²⁰ Kjo çështje mund të jetë veçanërisht problematike për personat me aftësi të kufizuara, të cilët mund të detyrohen t'i nënshtrohen sterilizimit të detyrueshëm kundër vullnetit të tyre.

2.4 Marrëdhëniet seksuale me të mitur

Në Konventën e Stambollit, mungesa e pëlqimit është kushti kryesor për cilësimin një vepre penale si përdhunim, pavarësisht moshës së viktimës. Ndërkohë, në Kodin Penal shqiptar, përdorimi i dhunës kërkohet si kusht edhe për marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me të mitur të moshës 14-18 vjeç. Kjo është një nga shqetësimet e tjera serioze të ngritur nga GREVIO në raportin e parë vlerësues, ku Shqipërisë i kërkohet të:

- Ndryshojë përkufizimin e përdhunimit të fëmijëve të moshës 14 deri në 18 vjeç, në mënyrë që të bazohet në mungesën e pëlqimit të shprehur në mënyrë të lirë dhe të mos kërkojë provimin e përdorimit të forcës ose rezistencës. Për vlerësimin e dhënies së pëlqimit të fëmijës, një vëmendje të veçantë duhet ti kushtohet diferencës në moshë ndërmjet dhunuesit dhe viktimës.
- Ndryshimi i përkufizimit të përdhunimit të fëmijëve të moshës 14-18 vjeç që të mos bazohet në arritjen apo jo të pjekurisë seksuale të fëmijës.

Këto rekomandime janë përsëritur edhe nga Komiteti i Shteteve Palë në konkluzionet e vitit 2021 për Shqipërinë. Për sa më sipër, sugjerojmë që të përmbushen rekomandimet dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme në Kodin Penal sikurse ka rekomanduar GREVIO.

2.5 Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë.

Legjislacioni penal shqiptar parashikon një dispozitë të veçantë të marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur (neni 102/a). Sikurse kemi sugjeruar më sipër, përkufizimi i përdhunimit duhet të ndryshojë dhe të jetë i plotë duke përfshirë edhe natyrën e veprimeve të dhunës seksuale si dhe objektet me të cilat mund të kryhet. Pra të detajohen sjelljet që përbëjnë përdhunim. Në këtë aspekt, ai do të përfshijë në mënyrë të njëjtë të gjitha format dhunës seksuale ndaj të gjithë personave, pavarësisht orientimit seksual, duke u bazuar në mungesën e pëlqimit, në përputhje me Konventën e Stambollit. Prandaj, veçimi i marrëdhënieve homoseksuale si një vepër penale, na shpie edhe në një gjuhë

¹⁹ Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO): Analizë e Raporteve Bazë të Vlerësimit të GREVIOs, 2022 <https://rm.coe.int/prems-010522-gbr-grevio-mid-term-horizontal-revieë-rev-february-2022/1680a58499>

²⁰ Këshilli i Evropës, Raport Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), 2011, <https://rm.coe.int/1680a48903>

diskriminuese nga Kodi penal. Ky i fundit mund të dënojë format e dhunës seksuale duke marrë në konsideratë edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor, por nuk mund të veçojë këta të fundit duke përdorur terma diskriminues. Për më tepër, kjo dispozitë është veçanërisht problematike sepse parashikon masa dënimi më të lehta se marrëdhëniet seksuale më dhunë me të rritura.

2.6 Dënimet

Nisur nga analiza e kryer në pikën III.3, vërejmë se ka nevojë të rishikohen edhe dënimet e parashikuara në Kodin Penal ekzistues në veprat penale të kreut mbi krimet seksuale. Dënimet e ndryshme për kategori të njëjta të veprave penale që ndryshojnë vetëm nga subjektet e veprës penale mund të na shpjen në konkluzionin se ka diskriminime. Dënimet duhet të vendosen mbi bazën e parimit të proporcionalitetit.

3. Përmbledhje e konkluzioneve dhe rekomandimeve

Dispozitat mbi Krimet seksuale në Kodin Penal janë analizuar në përqasje me standardet e vendosura nga Konventa e Stambollit dhe Konventa CEDAW-t. Nga kjo analizë ka rezultuar se këto dispozita kanë disa mangësi dhe në disa raste vijnë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të barazisë gjinore. Disa mësimet e tjera burojnë nga përvojat ndërkombëtare si dhe nga përvojat e vendeve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës dhe të BE-së. Në këtë kuadër, është e rëndësishme që të merren masat për të ndryshuar dispozitat e Kodit Penal duke parashikuar një përkufizim të ri të marrëdhënieve seksuale me dhunë (përdhunimit), në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në ndryshim nga Kodi Penal në fuqi, në RSh, kërkohet që përkufizimi i dhunës seksuale që parashikon ushtrimin e forcës dhe të shtrëngimit, të ndryshojë në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe që nuk kërkon demonstrim e përdorimit të forcës apo rezistencës. Ky përkufizim duhet të plotësohet dhe të detajohet sipas standardeve të nenit 36 të Konventës së Stambollit. Gjithashtu, nga analiza e përqasjes rezulton se ka nevojë që në Kodin tonë Penal të parashikohen figura të reja të veprave penale të dhunës seksuale, të cilat edhe pse kërkohen në standardet ndërkombëtare dhe janë parashikuar në legjislacionet penale të mjaft shteteve anëtare të BE-së dhe KE-së, në legjislacionin tonë mungojnë. Parashikimi i tyre është i rëndësishëm për mbrojtjen e gruas nga forma të rënda të dhunës seksuale, si dhe nga gjymtimi e sterilizimi. Përpos tyre, kanë nevojë të rishikohen edhe dispozitat që sanksionojnë mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna seksuale, si dhe të mënjanohet gjuha diskriminuese ndaj personave për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit të tyre seksual.

Konkretisht, për sa më sipër, sugjerojmë:

- Të ndryshojë përkufizimi i përdhunimit të grave të rritura në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe që nuk kërkon demonstrim e përdorimit të forcës apo rezistencës; (Ndryshimi i nenit 102 KP).
- të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit me të mitur të moshës 14 - 18 vjeç në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe të mos kërkojë demonstrimin e përdorimit të forcës apo rezistencës. (neni 101 KP)
- Për vlerësimin e pëlqimit të plotë e të lirë të fëmijës, duhet t'i kushtohet rëndësi hendekut të moshës ndërmjet dhunuesit dhe viktimës;
- Të rishikohet mosha minimale për dhënien e pëlqimit;
- Të detajohet dhe të plotësohet përkufizimi i marrëdhënieve seksuale me dhunë (përdhunimit), duke parashikuar edhe natyrën e veprimeve të dhunës seksuale si dhe objektet me të cilat mund të kryhet. Pra të detajohen sjelljet që përbëjnë përdhunim.
- Të parashikohet vepra penale sjellja seksuale pa pëlqimin e personit, sikurse e përshkruan Neni 36, pika 1, shkronjat *b* e Konventës: *përfshirja me një person pa pëlqimin e tij/saj në akte të tjera të një natyre seksuale.*

- Të parashikohet si vepër penale nxitja që një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të një natyre seksuale pa pëlqimin e tij/saj.
- Të parashikohet si vepër penale sterilizimi i detyrueshëm/detyrimi për sterilizim.
- Të parashikohet si vepër penale gjymtimi gjenital.
- Sugjerohet që të rishikohet neni 102.a i Kodit penal me qëllim që të shmangen parashikimet dhe gjuha diskriminuese.
- Të rishikohen të gjitha nenet që parashikojnë krimet seksuale, me qëllim shmangien e gjuhës diskriminuese. Rekomandohet rishikimin në tërësi të dispozitave për të gjetur cilësime të përshtatshme në gjuhën shqipe. Nuk na duket e përshtatshme që aktet e dhunës seksuale të quhen marrëdhënie seksuale me dhunë.
-
- Të rishikohen dënimet në mënyrë që të vendosen mbi bazën e parimit të proporcionalitetit.
- Të rishikohen të gjitha nenet që krijojnë një lidhje me dhunën seksuale me qëllim harmonizimin e tyre.
- Ndryshimet e propozuara të konsultohen me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë.

Procesi: Këto ndryshime legislative duhet të paraprihen nga konsultime të gjera me organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe mund të sjellin zërin dhe eksperiencën e tyre. Sugjerohet që ndryshimet të konsultohen me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë. Një sugjerim tjetër lidhet me rishikimin në tërësi edhe të veprave të tjera penale që lidhen me dhunën seksuale.

Analiza e Kodit të Familjes mbi Rregullimet Ligjore për Moshën e Martesës

Përmbajtja:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë lidhur me të drejtën për martesë
2. Standardet ndërkombëtare lidhur me ‘martesën nën moshë’
3. Kodi i Familjes dhe mosha e martesës
4. Përmbledhëse e neneve të Kodit të Familjes që nevojitet të ndryshohen

Në Kodin e Familjes mosha e lidhur me të drejtën për martesë është 18 vjeç dhe kjo është e unifikuar për të dy gjinitë. Martesa nën moshën ligjore (18 vjeç) rregullohet me ligj dhe mund të autorizohet vetëm nga gjykata (shih neni 7 KF)²¹. Në KF, vihet re mungesa e një dispozite që përcakton moshën minimale nën të cilën ‘gjykata’ nuk lejohet të japë këtë autorizim-leje si përjashtim nga mosha ligjore për t’u martuar. Në praktikën gjyqësore, gjithashtu, nga monitorimi i vendimeve gjyqësore, rezulton se paraqiten probleme lidhur me formën e vënies në lëvizje të gjykatës, legjitimitimin aktiv, verifikimin e pëlqimit të lirë, vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës, praninë e psikologut, provueshmërinë e ‘shkaqeve me rëndësi’, raportin mes ‘shkaqeve me rëndësi’ kundrejt pjekurisë fizike e psikologjike të të miturit, pëlqimin e prindërve, etj.

Martesa me të mitur është një martesë e parakohshme nga mosha ligjore e vendosur për lidhjen e një martese juridikisht të vlefshme. Këto martesa, në shumicën e rasteve, janë të brishta në aspektet që kanë të bëjnë me pëlqimin e lirë dhe si të tilla mund të kthehen në marrëdhënie të dëmshme e të rrezikshme që çojnë deri në shkelje të të drejtave të njeriut dhe cenim të të drejtave dhe lirive të të miturit të përcaktuara në KDF. Nëse nga gjykata, nuk do të garantohet kryerja e një verifikimi të plotë të vullnetit të lirë të të miturit për të lidhur martesën nën moshë këto martesa rrezikojnë të jenë të ngjashme me ato me detyrim dhe goditen me pavlefshmëri ose penalisht.

Më poshtë analizohet legjislati shqiptar dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë dhe paraqiten disa rekomandime për ndryshime të nevojshme në Kodin e Familjes dhe Kodin Civil.

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë lidhur me të drejtën për martesë

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë nuk ka të përcaktuar një moshë për martesë. E drejta për t’u martuar dhe e drejta për të pasur familje është një e drejtë themelore e njeriut. Sipas Kushtetutës (neni 53/1) ‘kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje’ por, ‘lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj’ (neni 53/3).

Kushtetuta ndonëse nuk përcakton kushtet për lidhjen e martesës, nënvizon se ‘fëmijët (neni 54/1), martesa dhe familja (neni 53/2) gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti’.

2. Standardet ndërkombëtare lidhur me ‘martesën nën moshë’

²¹ Shih: “Martesë në Gjykatë? Të drejtat e fëmijëve, martesa nën moshë dhe roli i gjykatës”- [Raport mbi aspektet ligjore, sociale dhe praktikën gjyqësore të martesave nën moshë në Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier dhe Kavajë për periudhën 2011 – 2017](#). Tiranë, Qershor 2018. Arta Mandro-Balili dhe Bernard Zeneli.

Në kuadrin e Kombeve të Bashkuara: Konventa për të drejtat e fëmijëve (KDF) dhe Konventa CEDAW: Fenomeni i martesave të të miturve, është ndër çështjet e trajtuara më shpesh nga Komiteti i KDF dhe Komiteti CEDAW në vërejtjet përfundimtare në dialogun e tyre me shtetet palë të këtyre instrumenteve. Të dy komitetet përmes jurisprudencës së tyre lidhur me martesën e fëmijëve theksojnë tiparet plotësuese dhe reciprokisht përforcuese të të dy Konventave sa i përket moshës së martesës. Ndërsa KDF nuk ndalon posaçërisht martesën e fëmijëve²², por në mënyrë të qartë përcakton moshën madhore atë 18 vjeç, CEDAW neni 16 kategorikisht e konsideron martesën e fëmijëve të pavlefshme *ab initio*.

Sipas Konventës CEDAW: *Neni 16: '1. Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare. Në mënyrë të veçantë, do t'i sigurojnë grave mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave: ...b) Të drejtën e njëjtë për të zgjedhur lirisht bashkëshortin dhe për të lidhur martesë vetëm me pëlqimin e vet të lirë dhe të plotë;Fejesat dhe martesat e fëmijëve të mitur nuk kanë asnjë efekt juridik, prandaj do të merren të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë legjislacionin, me qëllim që të caktohet një moshë minimale për martesë dhe të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i martesës në një regjistër zyrtar'.*

Rekomandimi i Përgjithshëm i Përbashkët/Komenti i Përgjithshëm Nr. 31 i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave/Komenti i Përgjithshëm Nr. 18 i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës mbi praktikat e dëmshme²³ sqaron se “martesa e fëmijëve konsiderohet të jetë një formë e martesës së detyruar, duke qenë se njëra dhe/ose të dyja palët nuk kanë shprehur pëlqimin e plotë, të lirë dhe të informuar” (paragrafi. 20).

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave²⁴ është seriozisht i shqetësuar për praktikën e martesës së fëmijëve, veçanërisht në mesin e komuniteteve romë dhe egjiptiane, shpeshherë e autorizuar nga një vendim gjykatë si përjashtim nga moshë minimale për martesë prej 18 vitesh. Ai rekomandoi që Shqipëria të ndalojë rreptësisht martesën e fëmijëve dhe të kriminalizojë shkeljet e këtij ndalimi, duke lejuar vetëm përjashtime shumë të kufizuara dhe të përcaktuara qartë ku gjykatat mund të autorizojnë bashkime në martesë për personat nën 18 vjeç me pëlqimin e të dy partnerëve. Ai rekomandon gjithashtu që Shqipëria të rrisë ndërgjegjësimin e fëmijëve, prindërve, komunitetit dhe udhëheqësve fetarë dhe publikut të gjerë për ndikimin negativ të martesës së fëmijëve në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve, veçanërisht vajzave²⁵.

Në kuadrin e Këshillit të Evropës: Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” e njohur si Konventa e Stambollit (KS në vijim) dhe e ratifikuar nga Shqipëria, ka tri nene me rëndësi që nevojitet të mbahen në vëmendje kryesisht në rastet e lidhjes së martesës nën moshë.

- **Neni 37²⁶ i KS – Martesa e detyruar:** 1 Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e detyrimit të qëllimshëm të një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë. 2 Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin

²² Shih gjithashtu, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, neni 16 dhe 19.

²³ Shiko Rezolutën 156 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe Rekomandimin e Përgjithshëm të Përbashkët Nr. 31 të Komitetit CEDAW dhe komentin e përgjithshëm 18 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës.

²⁴ CEDAW/C/ALB/CO/4, paras. 41–42

²⁵ Shih: Human Rights Council Eöorking Group on the Universal Periodic Review Thirty-third session 6–17 May 2019.

²⁶ Neni 37 i Konventës së Stambollit kërkon kriminalizimin e dy lloj veprimesh: 1) detyrimi i një personi për të lidhur martesë; 2) joshja e një personi nga një vend i tretë me këtë qëllim (edhe nëse martesa nuk është lidhur). Element kryesor i martesës së detyruar është mungesa e pëlqimit të viktimit për shkak të përdorimit të forcës fizike ose psikologjike.

e tërheqjes së qëllimshme të një të rrituri ose fëmije për të shkuar në territorin e një Pale ose Shteti të ndryshëm nga ai ku ai ose ajo banon, me qëllim detyrimin e një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë.

Vini re: Kodi Penal në nenin 130 parashikon një vepër të posaçme që synon të dy format e martesës së detyruar duke kriminalizuar shtrëngimin e një personi për të lidhur martesë dhe kërkesa ndaj viktimës për të dalë jashtë territorit të Shqipërisë me qëllim detyrimin për të lidhur martesë. Ndërsa ky formulim është në përputhje me atë të Konventës, ndëshkimet me gjobë ose burgim deri në tre muaj janë shumë të ulëta. Për këtë vepër penale sugjerohet **të rriten sanksionet penale të zbatueshme.**

- **Neni 32 i KS – Pasojat civile të martesave të detyruara:** Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që martesat e detyruara të mund të jenë të pavlefshme, të anulohen ose zgjidhen pa barra të papërshtatshme financiare ose administrative të vendosura ndaj viktimës.

Vini re: sipas këtij neni të KS, goditja me pavlefshmëri të këtyre martesave i siguron viktimës një mbështetje të veçantë duke e shkarkuar nga cdo detyrim financiar ose administrativ.

- **Neni 59/4 i KS - Statusi i vendbanimit:** 4. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e martesës së detyruar të sjellë në një shtet tjetër, për qëllim martese dhe të cilët, si rezultat, kanë humbur statusin e tyre të vendbanimit në shtetin ku ata zakonisht banojnë, mund të rifitojnë këtë status.

Komiteti GREVIO lidh martesën nën moshë me rrezikun e martesës me detyrim. Në raportin për Shqipërinë GREVIO nënvizon se “Po t’i krahasojmë, formave të tjera të dhunës ndaj grave, si: martesës së detyruar, ngacmimit seksual dhe dhunës seksuale, u është kushtuar një vëmendje e kufizuar politike dhe legjislative”. Po aty nënvizohet se “Një fushë tjetër, ku të dhënat nga dhoma civile të gjykatave do të ndihmonin në parandalimin e dhunës ndaj grave, dhe veçanërisht në parandalimin e martesave të detyruara, janë edhe autorizimet nga gjykata për martesat e të miturve”. **GREVIO nxit autoritetet të lehtësojë kushtet kur një martesë e detyruar mund të shpallet e pavlefshme apo të anulohet, duke siguruar ndërkohë që viktimat të mos ketë asnjë barrë të panevojshme financiare apo administrative;** të rishikojnë legjislacionin në fuqi me qëllim vendosjen e masave mbrojtëse shtesë të përshtatshme, siç është kushti i moshës minimale që i mituri të jetë i aftë të kërkojë autorizim për t’u martuar. **Duke marrë parasysh rrezikun që kanoset nga martesat e të miturve për mundësinë e lidhjes së një martese të detyruar dhe formave të tjera të dhunës, si trafikimi²⁷ GREVIO nxit autoritetet të hartojnë udhëzime që përkufizojnë shqyrtimin gjyqësor të çdo kërkesë të të miturit, i cili kërkon autorizim për të lidhur martesë, si dhe nëpunësit gjyqësorë të trajnohen siç duhet; të sigurojnë që çdo shqyrtim i tillë të kryhet në bashkëpunim të ngushtë mes gjykatave dhe mekanizmave ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, siç janë njësitë e mbrojtjes së fëmijëve të krijuara në nivel vendor. Këto masa duhet të ndërmerren njëkohësisht me përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me këtë formë dhune dhe të angazhojnë profesionistët e caktuar në masa parandaluese²⁸.**

Në kuadrin e BE-së : Rregulla të qarta në lidhje me përjashtimet që lejojnë martesën për personat nën 18 vjeç janë konsideruar thelbësore për të siguruar mbrojtjen e vullnetit të lirë të fëmijës dhe për të luftuar

²⁷ Shiko paragrafin 108 të Raportit të gjashtë të GRETA-s, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2016: "Në raportet për Shqipërinë (...), GRETA rekomandon që autoritetet të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të parandaluar trafikimin e fëmijëve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve romë, përfshirjes së tyre në arsim dhe parandalimin e martesave të mitura, të hershme e të detyruara".

²⁸ Shiko paragrafin 42a të konkluzioneve përfundimtare të raportit të katërt periodik për Shqipërinë, Komiteti CEDAE, 2016.

martesën e detyruar, e cila kualifikohet si një formë e dhunës me bazë gjinore sipas të Drejtave të Viktimave (Direktiva 2012/29/BE).²⁹ Për më tepër, në funksion të situatës së migracionit në BE, kjo çështje është gjithnjë e më e rëndësishme për sa i përket njohjes së martesave të fëmijëve në vendet e treta, si dhe martesave të fëmijëve në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i vendbanimit ose zhvendosjes. Sipas nenit 8 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), BE synon të eliminojë pabarazitë dhe promovimi i barazisë ndërmjet grave dhe burra në të gjitha aktivitetet e saj. Deklarata nr. 19 për nenin 8 i TFBE-së i aneksuar në Aktin përfundimtar të Konferencës Ndërqeveritare që miratoi Traktatin e Lisbonës thekson se “në përpjekjet e tij të përgjithshme për të eliminuar pabarazitë midis grave dhe burrave, BE synon në politikat e saj të ndryshme për të luftuar të gjitha llojet e dhunës në familje”.

4. Kodi i Familjes dhe mosha e martesës

Ligji që rregullon lidhjen e martesës është Kodi i Familjes. KF parashikon një sërë kufizimesh ligjore të njohura si kushte e ndalesa lidhur me të drejtën për martesë. Një prej kushteve është arritja e moshës madhore [shih neni 7 i KF]. Të tjera ndalesa janë mungesa e pëlqimit të lirë [neni 8 KF], martesë ekzistuese nëse kërkohet të lidhet një martesë e re, sëmundje e rëndë psikike ose zhvillimi mendor i metë, i tillë që e bën të paaftë subjektin që kërkon të lidhë martesë të kuptojë qëllimin e martesës, etj [shih neni 7-14 të KF]. Të gjitha rastet, përfshi martesën e lidhur nën moshë ose martesën pa pëlqimin e lirë, bëjnë që martesë të lidhur të jetë e pavlefshme.

KF [2003] parashikon të njëjtat kushte dhe ndalesa martesore për të dy bashkëshortët e ardhshëm pavarësisht gjinisë. Nuk ka asnjë dispozitë diskriminuese lidhur me moshën e martesës. Sipas nenit 7 të KF: ‘Martesë mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesë, për shkakë me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe’.

Mosha është një kriter objektiv dhe si e tillë plotësisht ‘e matshme’/verifikueshme nga nëpunësi i gjendjes civile edhe nga gjykata në rast se kërkohet të lidhet martesë përpara moshës 18 vjeç. Kur një i mitur kërkon të lidhë martesë nën moshë, kjo situatë nuk është më një kompetencë e nëpunësit të gjendjes civile. Në këto raste përjashtimore roli i mbetet gjykatës. Gjykata, ndërsa është e ndërgjegjshme lidhur me moshën e mitur të kërkuesit, lipset të ndalet se sa rëndësi ka shkaku i paraqitur ose pretenduar për të lejuar lidhjen e martesës nën moshë kundrejt shkeljes së detyrimit ligjor të moshës për martesë. Sipas rastit, gjykata, duhet të verifikojë nëse qëndrojnë ose jo shkaqet me rëndësi dhe sipas rastit mund të lejojë ose jo këtë martesë. Në këtë rast gjykata merr përsipër një rol me rëndësi.

Martesat në moshë të mitur ndikojnë negativisht në realizimin e një sërë të drejtash të kësaj grupmoshe siç është e drejta për arsimim dhe kualifikim, zhvillim, argëtime, etj.

Në rastet e lejimit të martesës nën moshë, gjykatës, ‘i bie barra’ të kuptojë:

- Sa reale janë shkaqet me rëndësi të pretenduara për lidhjen e martesës nën moshë kundrejt rrezikut të cenimit të standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe shkeljes së parimit të moshës për martesë;
- Sa mundësi ka që përmes gjykatës të ligjërohet ende zakoni dhe traditat e martesave pa pëlqim të lirë, ose të martesave me ‘mblesëri a shkuesi’, ose të martesave me detyrim;
- A ekziston pëlqimi i lirë i të miturit;

²⁹ Shih gjithashtu botimin e FRA-së Addressing Forced Marriages in EU: dispozitat ligjore dhe praktikat premtuese. https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra-2014-forced-marriage-eu_en.pdf.pdf

- A e kupton i mituri se çfarë është martesë, çfarë efektsh ka në të drejtat e tij/saj, etj.

Në Shqipëri janë ende evidente raste të martesave me mblesëri ose ndërmjetësim dhe ndaj gjykata në raste të tilla duhet të ketë parasysh se çfarë rreziqesh shfaq kjo lloj martesë në parimin e 'pëlqimit të lirë'. Në disa zona të vendit, zakonet dhe traditat e së shkuarës ende kanë një ndikim edhe më të madh.

Sa më e vogël moshë, aq më e kufizuar autonomia për të vendosur dhe aq më i mundshëm imponimi apo detyrimi për martesë. Në rolin e vet gjykata kontrollon dhe mbron martesën si institut, por edhe të drejtat e fëmijës që kërkon të lidhë martesë nën moshë. Sipas Kushtetutës së RSH dhe dispozitave të KF, edhe martesë, edhe fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti. Gjykata që lejon martesën nën moshë ndërsa "ndërhyn" në realizimin e aktit të martesës, nuk mund të jetë aq sipërfaqësore sa të mos shohë përtej aktit. Garantimi i martesës si institut është detyrë e rëndësishme që ligji në këtë situatë i'a ka deleguar gjykatës, e cila jep lejen mbi bazën e një analize tërësore të shkaqeve me rëndësi ballafaqur këto me interesin më të lartë të të miturit dhe kuptimin e martesës.

Dispozita e KF e lidhur me moshën për martesë nevojitet të mbaje në vëmendje aspektet në vijim.³⁰

- **Saktësime ligjore lidhur me moshën për martesë**

Mënyra se si është formuluar dispozita tregon se nuk ka kufizime për gjykatën në lejimin lidhjes së martesës nën moshë nëse ka 'një shkak me rëndësi' të tillë që e bind atë të lejojë këtë martesë. Mbetet shqetësuese se ka raste në praktikë që kërkohet dhe lejohet lidhja e martesës edhe për të mitura nën moshën 16 vjeç. Vet dispozita nuk e përcakton të qartë se sa përpara kësaj moshe' mund të lejojë martesën gjykata. Nuk kemi statistika të sakta të rasteve sipas viteve, për të parë trendin. Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë nuk e përfshin një të dhënë të tillë.

Saktësim i moshës fundore mbetet një nevojë e domosdoshme e përmirësimeve të KF. Ky përcaktim jo vetëm është i domosdoshëm, por mund të jetë edhe si rregull 'tranzitor' për të hequr, në një kohë të dytë dhe të studiuar, mundësinë e lidhjes së martesës nën moshë.³¹ Siç vihet re, në gjykatë paraqiten kërkesa edhe për lidhjen e martesës së të miturave nën moshën 16 vjeç. Është e vërtetë që dispozitat e KF nuk parashikojnë një moshë minimum, nën të cilën nuk mund të lejohet lidhja e martesës as me vendim gjykate, por gjykata ka gjithë diskrecionin, dhe duhet të ushtrojë kujdes maksimal në raste të kërkesave të tilla dhe do të rekomandohej që kërkesa të tilla të gjenin një trajtim të veçantë edhe duke përfshirë autoritete lokale që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me qëllim ndërgjegjësimin dhe parandalimin e martesave në moshë të hershme.

- **Shkaku me rëndësi kundrejt interesit më të lartë të fëmijës dhe pjekurisë fizike e psikike**

Gjykata që investohet për lejimin e martesës nën moshë, e jep vendimin pas një analize tërësore të shkaqeve me rëndësi të pretenduara. Për shëmbull, arsimi jashtë shtetit mund të sigurohet edhe pa lidhur detyrimisht martesën me një person që jeton jashtë shtetit; raste të tilla duhet të monitorohen me kujdes sepse mund të jenë burim shfrytëzimi, trafikimi, punë e detyruar, etj.

Gjykata nevojitet të verifikojë rëndësinë e motivit/shkakut të pretenduar dhe që shoqëron kërkesën për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë. Motivi duhet trajtuar në raport me atë se çfarë i shtyn subjektet të kërkojnë lejen e gjykatës për lidhjen e martesës përpara kohe dhe jo sipas rregullave të martesës. Duhet

³⁰ Një pjesë e rekomandimeve janë marrë nga botimi i autores Arta Mandro Balili "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore. Roli i gjyqësorit shqiptar në eliminimin e tij". Botim i SHM dhe UNDP. Tiranë, Prill 2014. Fq 46-78.

³¹ Shih përvojën e disa shteteve: <https://lordslibrary.parliament.uk/marriage-and-civil-partnership-minimum-age-bill/>

të ketë arsye të mira për të lidhur këtë martesë. A po lidhet martesë nga turpi? Presioni? Nevoja ekonomike? Detyrimi? Etj.

Gjykata nevojitet të verifikojë bazueshmërinë e motivit. Është ky një motiv fiktiv apo real? Kjo realizohet përmes pyetjeve. Nëse është real sa i bazuar është për të bërë një kërkesë në shkelje të rregullit të përgjithshëm të moshës. Arsyet duhet të jepen qartë. Ato duhet të jenë konkrete e reale. Pas shkaqeve që justifikohen si të rëndësishme mund të qëndrojnë të tjera që mund të sjellin rrezik për të miturin/ën.

Gjykata nevojitet të verifikojë dhe pasqyrojë në vendim pjekurinë fiziko-psikike të personit nën moshën 18 vjeç që bën kërkesë për lidhje martesë nën moshë. Për këtë ajo mund të përpilojë një listë me pyetje edhe të thjeshta për të parë reagimin e të miturit. Pjekuria psikike përfshin qartësinë e kërkesit/es lidhur me rëndësinë e martesës në tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve. Pjekuria psikike duhet konstatuar prej veprimeve të subjekteve dhe jo thjesht prej deklarimeve të tyre. Gjykata në këtë vendimmarrje duhet të mbrojë të miturit dhe martesën. Duke qenë se nga martesë lindin të drejta, detyrime e përgjegjësi, gjykata duhet të vlerësojë se sa në harmoni është personi me pjekurinë e vet kundrejt këtyre të drejtave dhe detyrimeve që imponon martesë dhe të informojë të miturin.

- **Saktësimi i legjitimitetit aktiv në procedimet lidhur me martesën nën moshë**

Vetëm i mituri që kërkon të lidhë martesë nën moshë është ai që legjitimohet aktivisht në bërjen e kërkesës.

Mungesa e përcaktimeve të qarta në ligj ka çuar në disa raste në praktikën gjyqësore që të pranohën kërkesa për lidhjen e martesës në moshë nga persona madhorë të tillë si

- Pretendenti për bashkëshort i ardhshëm i të miturës;
- Prindërit e të miturës:

Vini re: Prindi, sipas KF, ka të drejtën e kundërshtimit të martesës. Atëherë kjo është një arsye më shumë që prindi të mos legjitimohet aktivisht të kërkojë leje për martesën e fëmijës me cilësinë e ushtruesit të përgjegjësishëm prindërorë. Por është e drejtë e gjykatës të dëgjojë prindërit dhe të kuptojë nëse është përpara detyrimit për martesë.

Çështjet e legjitimitetit aktiv të të miturit/ës që kërkon të lidhë martesë nën moshë janë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte nevojitet që të saktësohet e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën vetëm nga i/e mitura si pala e interesuar në kërkesë të lidhë martesë nën moshë. Duke qenë se martesë është një akt personal edhe përfaqësimi në gjykatë nuk do të ishte korrekt. Ashtu sikurse nuk ka lidhje martesë me përfaqësim përpara nëpunësit të gjendjes civile, e njëjta vlen për paraqitjen e kërkesës në gjykatë. Që të lejojë lidhjen e martesës nën moshë, gjykata duhet të vlerësojë të miturin/ën personalisht, pëlqimin e lirë dhe shkakun që për atë të mitur ka rëndësi. Gjykata nuk bën vlerësime në përgjithësi lidhur me ato që përbëjnë 'shkak me rëndësi' për lidhjen e martesës por i sheh ato në raport me të miturin/ën, pjekurinë e tij/saj fiziko-psikike, pëlqimin e lirë, gadishmërinë për të marrë përsipër përgjegjësitë e martesës, etj.

Pra, lidhja e martesës nën moshë investon gjykatën si një autoritet që bën vlerësimin rast pas rasti të shkakut si dhe të kushteve e ndalesave të tjera të parashikuara në KF lidhur me lidhjen e martesës për atë të mitur që ka paraqitur kërkesën. Praktika gjyqësore, një rast të shtrëngimit ose detyrimit për martesë³² dhe, që të përjashtohet çdo rrezik, si dhe të eliminohet cenimi i të drejtave të të miturit/ës,

³² shih Vendimi i GjRGGJ Kavajë, datë 19.12.2021 çështjen civile nr. 21036-00887-12-2021 (887) regj.them.

kërkohet që i/e mituri/a, lejimi i martesës të së cilit/ës po çmohet nga Gjykata, të paraqiten personalisht me cilësinë e kërkueses. Nuk duket korrekte që e mitura të thërritet me cilësinë e personit të tretë kur në fakt procesi, fillim e mbarim, është për të. Për këtë na vijnë në ndihmë edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile lidhur me pjesëmarrjen e personave të tretë në procesin civil për të kuptuar se e mitura nuk mund të ketë kurrsesi atë pozicion procedural.

Ndërkohë, gjykata, në këtë çështje, është shprehur për ekzistencën e pëlqimit të lirë nga ana e pretendentit për bashkëshort çka pa dyshim ka rëndësinë e vet, por që nuk mund të zëvendësojë në asnjë rast vlerësimin nga gjykata të të miturës. Pra, në vendimet gjyqësore nevojitet të shprehet qartazi kujdesi për të miturën. A po e kupton e mitura kërkesën që ka paraqitur dhe ndryshimet që sjell në jetën e vet? A po e kupton procesin?

- **Saktësimi i formës së kërimit në gjykatë për çështjet me objekt 'lejim lidhje martesë nën moshë'**

Gjykata vihet në lëvizje përmes mjetit procedural që është kërkesa sepse lejimi i lidhjes së martesës nën moshë, është proces që zhvillohet pa palë kundërshtare.

- **Pëlqimi i lirë**

Pëlqimi i lirë është kushti pa të cilin martesa nuk ka vlerë juridike. Ndaj, parim shumë i rëndësishëm që duhet të mbahet nën kontroll nga ana e gjykatës është autonomia e vullnetit të të miturit/ës që kërkon leje për lidhjen e martesës nën moshë. Për të vlerësuar këtë vullnet i mituri duhet të jetë prezent personalisht gjatë gjithë procesit.

- **E drejta për tu dëgjuar dhe informuar**

Gjykata duhet të garantojë të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe informuar, gjykata të mbajë në vëmendje se sa më e vogël mosha aq më lehtë manipulimi i të miturit në lidhjen e martesës pa pëlqimin e lirë.

I mituri mund të pyetet veçmas. Gjykata është e inkurajuar të marrë mendimin e të miturit në kushte ku nuk ka asnjë ndikim ndaj tij/saj. Pra i mituri nevojitet të merret në pyetje jo në prani të prindërve, kujdestarit ose bashkëshortit të ardhshëm dhe të të rriturve të tjerë; një listë pyetjesh e gatshme mund të lehtësojë gjykatën në komunikimin me të miturin për të kuptuar lirinë e vullnetit dhe aspekte të tjera.

- **Roli/ pjesëmarrja e psikologut dhe Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel lokal**

Vlerësimi psikologjik i të miturit është detyrim ligjor që buron nga neni 6 KF. Përgjithësisht praktika gjyqësore e ka neglizhuar këtë detyrim në rastet e kërkesave për martesë nën moshë.

Marrja e mendimit të psikologut lidhur me anën psikologjike, pëlqimin e lirë dhe situatën sociale është një detyrim ligjor dhe ndihmesë e madhe për gjykatën që të japë një vendim të drejtë dhe të gjykojë mbi rëndësinë e shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre si dhe pjekurinë fiziko psikike duke e bërë këtë verifikim edhe përmes psikologut. Gjykata edhe në gjykime të tilla duhet të respektojë parimin e nenit 6 të Kodit të Familjes dhe të KDF sipas të cilit: "Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën sociale". Një rol të veçantë ndihmës për gjykatën në vendimarrje të tilla mund të luajnë Njësitë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në nivel vendor si edhe punojësit social.

- **Roli i prindërve dhe shoqërimi i të miturit/ës në gjykatë nga të rritur të tjerë**

Prindi, sipas KF, ka të drejtën e kundërshtimit të martesës. Në këto kushte nuk mund të jetë ai që vepron në emër të të miturit dhe nuk mund të kërkojë leje për martesën e fëmijës me cilësinë e ushtruesit të përgjegjësishë prindërore.

Prindërit janë subjekte që duhet të pyeten nga gjykata për disa arsye përfshi këtu edhe detyrimin për martesë. Nuk kërkohet pëlqimi i tyre. Duke i'u referuar rekomandimit të përgjithshëm Nr. 31 të Komitetit CEDAW dhe komentit të përgjithshëm Nr. 18 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve për praktikën e dëmshme (2014), Komiteti CEDAW gjithashtu rekomandon që vendi ynë të ndalojë të gjitha praktikën e dëmshme, ku përfshihen martesat e fëmijëve, praktika e familjeve që zgjedhin bashkëshortin për vajzën e tyre, etj.

Ndonëse, legjislacioni shqiptar nuk e njeh pranimin ose pëlqimin e prindërve si detyrim për lidhjen e martesës nën moshë, duke qenë se prindërit kanë të drejtën e kundërshtimit të martesës, vlerësimi i mendimit të tyre nga ana e gjykatës duhet bërë kundrejt interesit të të miturit dhe për të parë sa ndikim kanë prindërit në cenimin e vullnetit të lirë.

Bashkëshorti i ardhshëm, pyetet nga gjykata gjithashtu për disa arsye përfshi këtu edhe detyrimin për martesë. Pëlqimi i tij/saj është e detyrueshëm në këtë proces. Bashkëshorti i ardhshëm nuk mund të legjitimohet aktivisht, në lejimin e lidhjes së martesës në moshë. Ky është subjekt që nevojitet domosdoshmërisht të thërritet në proces me cilësinë e personit të tretë.

- **Prania e mbrojtësit ligjor/ Avokatit**

Nuk është aplikuar dhe nuk është e qartë sa në dijeni janë të miturit për të përdorur aksesin në gjykatë përmes ndihmës ligjore falas. Sugjerojmë të jetë një detyrim ligjor dhe falas në rastet e lidhjes së martesës nën moshë me qëllim që të miturit të marrin informacionin e duhur.

- **Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës në vendimin e gjykatës**

Për gjykatën mbarojtja në vëmendje e interesit të të miturit duhet të jetë konsiderata kryesore dhe ky kujdes i veçantë nevojitet të pasqyrohet në mënyrë sa më të qartë përmes analizës konkrete sipas rastit, në përmbajtjen e vendimit.

Gjykata nevojitet, sipas Kushtetutës së RSH, të marrë pozicion mbrojtës dhe të mbajë në vëmendje se të miturat me gjendje të vështirë ekonomike janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të martesave fiktive apo premtimeve për martesë që përfundojnë në shfrytëzim për prostitucion, trafikim ose çdo lloj forme tjetër shfrytëzimi.

4. Përmbledhëse e neneve të Kodit të Familjes që nevojitet të ndryshohen

Është

Mosha e lidhjes së martesës: Neni 7

Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç.

Gjykata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe.

Sugjerohet: të rishikohen kjo dispozitë **me qëllim vendosjen e masave mbrojtëse shtesë të përshtatshme, siç është kushti i moshës minimale që i mituri të jetë i aftë të kërkojë autorizim për t'u martuar; ndihma ligjore dhe psikologjike falas.**

Një pyetje që mbetet për tu diskutuar: A do të lejojmë lidhjen e martesës mes dy të miturve?

Bëhet

Mosha e lidhjes së martesës: Neni 7

Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç.

Gjykata e vendit ku lidhet martesa, me kërkesë të të miturit që ka mbushur moshën 16 vjeç, në bashkëpunim të ngushtë me mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pasi vlerëson interesin më të lartë të të miturit, pëlqimin e lirë dhe mungesën e ndalesave për lidhjen e martesës, mund të lejojë, për shkaqe me rëndësi dhe në prani të psikologut, lidhjen e martesës.

I mituri që paraqet kërkesë për lidhjen e martesës nën moshë ka të drejtë për ndihmë ligjore dhe psikologjike, pa pagesë, të garantuar nga shteti, sipas legjislacionit përkatës.

Nevoja për ndryshime në Kodin Civil

Neni 6, paragrafi i dytë i Kodit Civil duhet të përqaset edhe me Kodin e Familjes të Republikës së Shqipërisë të miratuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, i cili në nenin 7 paragrafi i parë i tij parashikon se martesa mund të lidhet si rregull kur burri dhe gruajeja kanë mbushur moshën 18 vjeç. Mospërputhja ka ardhur për shkak se Kodi Civil është më i vjetër në kohë dhe është miratuar gati 9 vjet para Kodit të Familjes, duke shkuar i përqasur me Kodin e vjetër të Familjes që lejonte martesën e vajzës 16 vjeç, ndërsa të djalit 18 vjeç. Për këtë arsye, duhet të harmonizohen të dy Kodet në fuqi me njëri-tjetrin, si dhe kushtet e jetesës dhe të zhvillimit shoqëror ku të dyja gjinitë kanë në mënyrë të barabratë të njëjtat mundësi për zhvillim fizik e intelektual.

Është

Shkaqet e pavlefshmërisë: neni 33

Martesa që është lidhur pa pëlqimin e lirë dhe pa vese të të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre është e pavlefshme.

Neni 44

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës së lidhur pa pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre e kanë të dy bashkëshortët ose bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk ka qenë i lirë.

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës së lidhur me kanosje ose me lajthim e ka vetëm bashkëshorti që ka qenë i kanosur ose në lajthim.

E drejta e padisë parashkruhet, në qoftë se nga data që ka pushuar kanosja, që është zbuluar lajthimi ose bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë në rast të martesës pa pëlqim të lirë, kanë kaluar 6 muaj, por në çdo rast jo më tepër se 3 vjet nga lidhja e martesës.

E drejta e padisë, në rastet kur ka pasur një bashkëjetesë të vazhdueshme për 6 muaj që nga çasti që bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë ose nga çasti që ai ka marrë dijeni për lajthimin, parashkruhet me kalimin e këtij afati.

GREVIO thekson se kushtet në të cilat mund të kërkohet pavlefshmëria e martesës së detyruar duken mjaft kufizuese. Sugjerohen ndryshime të afateve sepse kushtet në të cilat mund të kërkohet pavlefshmëria e martesës së detyruar sepse këto duken mjaft kufizuese.

Bëhet

Shkaqet e pavlefshmërisë: neni 33

Martesa që është lidhur pa pëlqimin e lirë dhe pa vese të të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre është e pavlefshme.

Neni 44

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës së lidhur pa pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre e kanë të dy bashkëshortët ose bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk ka qenë i lirë.

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës së lidhur me kanosje ose me lajthim e ka vetëm bashkëshorti që ka qenë i kanosur ose në lajthim.

E drejta e padisë parashkruhet, në qoftë se nga data që ka pushuar kanosja, që është zbuluar lajthimi ose bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë në rast të martesës pa pëlqim të lirë, ka kaluar **1 vit muaj, por në çdo rast jo më tepër se 5 vjet** nga lidhja e martesës.

E drejta e padisë, në rastet kur ka pasur një bashkëjetesë të vazhdueshme për **1 vit** që nga çasti që bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë ose nga çasti që ai ka marrë dijeni për lajthimin, parashkruhet me kalimin e këtij afati.

Me rëndësi janë edhe dispozitat mbi bashkëjetesën të cilat nuk vendosin asnjë kufizim për moshën e bashkëjetuesve dhe nuk parashikojnë asnjë rregullim duke e lënë këtë formë të jetës familjare të parregulluar.

Është

Kuptimi i bashkëjetesës: Neni 163

Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie.

Neni 164

Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës.

Bëhet

Kuptimi i bashkëjetesës: Neni 163

Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis dy personave që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie.

Nuk mund të quhen bashkëjetues personat kur qoftë edhe njëri prej tyre ka një bashkëjetesë apo martesë tjetër; janë nën 16 vjeç ose kanë ndalesat për shkak të lidhjeve të gjakut të parashikuara si pengesa për martesë. Bashkëjetesa rregullohet me ligj të vecantë.

Neni 164

Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës. Kjo marrëveshje regjistrohet në një regjistër të vecantë.

Analiza e Kodit Penal lidhur me Veprat Penale të Dhunës në Botën e Punës

Përmbajtja

1. Kushtetuta e RSH lidhur me të drejtën për punë
2. Standardet ndërkombëtare lidhur me dhunën dhe ngacmimin në botën e punës
3. Legjislacioni shqiptar lidhur me dhunën dhe ngacmimin në punë
4. Përmbledhëse e neneve të Kodit Penal që nevojitet të ndryshohen

Raporte dhe studime të ndryshme tregojnë se dhuna, ngacmimi dhe ngacmimi seksual janë dukuri të pranishme në mjedisin e marrëdhënieve të punës në Shqipëri. Pasqyrimi i këtij fenomeni në legjislacionin shqiptar ka pasur rrjedhën dhe zhvillimin e vet.

Zhvillimet politike, ekonomike dhe sociale kanë pasur ndikimin e tyre në liritë themelore dhe të drejtat e njeriut në vend, dhe kjo për pasojë reflektohet edhe në ndryshimet në kornizën ligjore kombëtare. Në disa raste, ndryshimet ligjore erdhën si rezultat i detyrimeve të vendit për të harmonizuar legjislacionin e vet kombëtar me instrumentet ndërkombëtare ose me rekomandimet e paraqitura nga organizata ndërkombëtare për shkak të detyrimeve që rrjedhin nga konventat e ratifikuara³³. Këtu është gjithashtu e rëndësishme të pranojmë revolucionin ligjor që instrumentet global dhe rajonal kanë sjellë dhe vazhdojnë të sjellin në kornizën e brendshme ligjore. Instrumente rajonale si Konventa e KiE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje [Konventa e Stambollit]; KEDNJ; Karta Sociale Evropiane së bashku me Protokollin e saj (1961) dhe Karta Sociale Evropiane e Rishikuar, etj., kanë ofruar të gjitha një ndikim të konsiderueshëm pozitiv në përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar, duke e sjellë atë në përputhje me standardet progresive ndërkombëtare.

Në raste të tjera, ndryshimet ligjore ishin një produkt i drejtpërdrejtë i vështirësive që rezultojnë nga zbatimi praktik i një ligji të caktuar ose për të përmirësuar perspektivën praktike të natyrës deklarative të neneve të ligjit. Për më tepër, ndryshime të tilla legjislative kanë shoqëruar dhe plotësuar harmonizimin mes normave brenda legjislacionit.

1. Kushtetuta e RSH lidhur me të drejtën për punë

E drejta për punë është një e drejtë kushtetuese. Kodi i Punës (neni 1) bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kodi Penal (neni 1/a) bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare dhe traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.

Objektivat socialë të përfshira në nenin 59 të Kushtetutës përfshijnë punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë (a). Gjithashtu, neni 15 parashikon se: “1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në

³³ Shih Rekomandimet e [UN Treaty Bodies](#); [CEDAW Committee, [CCPR](#)], [Comments adopted by the CEACR](#): Albania on *Discrimination (Employment and Occupation) Convention, 1958 (No. 111) and Occupational Safety and Health Convention, 1981 (No. 155)*; GREVIO baseline report, [UPR](#).

themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”.

2. Standardet ndërkombëtare lidhur me dhunën dhe ngacmimin në botën e punës

Shqipëria zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të [neni 5 i Kushtetutës]. Një numër i konsiderueshëm i konventave ndërkombëtare që janë të rëndësishme në kontekstin e mbrojtjes në punë janë ratifikuar tashmë. Të tilla janë: Konventa 190 e ONP mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës; Konventa e ILO-s për shpërblim të barabartë (Nr. 100); Konventa e ILO-s për Diskriminimin (Punësimi dhe Profesionin) (Nr. 111); Konventa e ILO-s për promovimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, 2006 (Nr. 187); Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre; Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Sipas konventës 190 të ILO, me qëllim zbatimin e përjasjes gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të përgjegjshme për gjininë, e referuar në nenin 4, paragrafi 2 i Konventës, Shqipëria duhet të adresojnë dhunën dhe ngacmimin në botën e punës në punë dhe punësim, sigurinë dhe shëndetin në punë, ligjin për barazisë dhe mos-diskriminimin, dhe në të drejtën penale, sipas rastit.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje si një instrument detyrues përkufizon "dhunën ndaj grave" si shkelje të të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe do të nënkuptojë të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë në, ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike ose private.

Sipas Konventës së Stambollit, Neni 40 – Ngacmimi seksual: “Palët marrin masat e **nevojshme legjislative** ose masa të tjera për të garantuar që çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, t’i nënshtrohet një sanksioni penal ose sanksioni tjetër ligjor.”

Në Shtator 2015, Shqipëria miratoi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) që paraqesin pika të forta hyrëse, veçanërisht për përfshirjen sociale (SDG10), barazinë gjinore (SDG5), qeverisjen dhe sundimin e ligjit (SDG 16) dhe punësimin (SDG 8).

Ndërsa Shqipëria aspirojnë të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, arritja e standardeve të barazisë dhe mos-diskriminimit është një kusht për integrimin e mëtejshëm në BE. Është detyrë e një vendi si Shqipëria të harmonizojë legjislacionin e vet me atë të BE-së.

Legjislacionet penale të vendeve të tjera: Nga hulumtimet e bëra në kuadrin e këtij raporti³⁴ vihet re se kjo qasje nuk është e elaboruar në mënyrë të dukshme në legjislacionet e vendeve të tjera. Bien në sy dy

³⁴Falenderoj Znj. Agustela Nini për ndihmesën në këtë kërkim.

dispozitat e Kodit penal të Francës³⁵ (të përfshira në nenet 222-33 dhe 225-1-1); të Kodit penal të Rumanisë³⁶ (neni 203) dhe të Kodit penal të Sllovenisë³⁷ (neni 197) si më poshtë.

Article 222-33 of the French Criminal Code

Sexual harassment is the act of repeatedly subjecting a person to unwelcome verbal or physical conduct of a sexual nature when such conduct either compromises the victim's dignity through demeaning or humiliating words or actions, or creates an intimidating, hostile or offensive environment for the victim. Any form of intense pressure, even if not repeated, with the actual or perceived goal of obtaining sexual favours, whether for the offender or for a third party, is also considered sexual harassment.

Sexual harassment is punishable by two years of imprisonment and a fine of 30,000.

This penalty is increased to three years of imprisonment and a fine of 45,000 if the offence:

- **involves abuse of the authority vested in the offender by virtue of his or her position;**
- targets a victim under fifteen years of age;
- targets a particularly defenceless victim when such vulnerability, due to age, illness, physical or mental disability or pregnancy, is clearly visible or known to the offender;
- targets a particularly defenceless or dependant victim when such vulnerability, due to social or economic insecurity, is clearly visible or known to the offender;
- is committed by more than one person acting as perpetrators and/or accomplices.

Article 225-1-1 of the French Criminal Code

Any distinction made between individuals on the basis of having endured or refused acts of sexual harassment as described in article 222-33, or having reported such acts, including the cases of isolated acts with regard to the provisions set out in section I of said article, constitutes discrimination.

Romania: Criminal Code, Article 203 (In the new Criminal Code to be introduced Sexual Harassment will be defined under Article 223)

Harassing a person through threats or constraints in order to obtain sexual satisfaction by a person who abuses his/her authority or his/her influence given by his position in the workplace is an act of sexual harassment punishable by prison from 3 months to 2 years or fine

Slovenia: Criminal code, article 197.

(1) Whoever degrades or frightens another person at the workplace or in relation to work with sexual harassment, physical violence, ill-treatment or unequal treatment, shall be sentenced to imprisonment for not more than two years. (2) If the offence under the preceding paragraph results in psychological, psychosomatic or physical illness or reduction of work productivity of an employee, the perpetrator shall be sentenced to imprisonment for not more than three years.

³⁵ https://eige.europa.eu/sites/default/files/sciencespo_guidelines_on_dealing_with_sexual_harassment.pdf

³⁶ <https://eige.europa.eu/gender-based-violence/regulatory-and-legal-framework/legal-definitions-in-the-eu/romania-sexual-harassment>

³⁷ <https://eige.europa.eu/gender-based-violence/regulatory-and-legal-framework/legal-definitions-in-the-eu/slovenia-sexual-harassment>

3. Legjislacioni shqiptar lidhur me dhunën dhe ngacmimin në punë

Ligjet të cilat paraqesin lidhjen më të fortë me fushën e Konventën Nr. 190 të ILO-s, përfshijnë:

➤ **Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë**³⁸

Në veçanti nënvizojmë ndryshimet e vitit 2015, të cilat hynë në fuqi më 22 qershor 2016. Këto ndryshime ofrojnë më shumë mbrojtje për punonjësit [shih për shembull nenin 32 të KP i cili, përcakton, ndalon dhe adreson ngacmimet dhe ngacmimet seksuale si *quid pro quo* dhe si mjedis armiqësor]. Në lidhje me diskriminimin në marrëdhëniet e punës, ndryshimet e vitit 2015 përdorin tre parime të rëndësishme dhe të reja që punëdhënësit duhet të marrin parasysh gjatë marrëdhënies të punës. Përkatësisht këto janë: mosdiskriminimi; mbrojtja e të dhënave personale dhe sensitive; informimi dhe konsultimi. Ndalimi i diskriminimit renditet si një nga të drejtat dhe parimet themelore të KP, i cili të zbatohet në të gjitha fushat ku ushtrohet e drejta për punësim dhe profesion [neni 9 KP].

Në Kodin e punës një përkufizim i 'dhunës' në mjedisin e punës si i tillë është i munguar. Në disa ligje ka përkufizime përkatëse të asaj që mund të përbëjë dhunë (ligji 9669/2006 "për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar, në nenin 3 jep përkufizimin e dhunës) por këto jo domosdoshmërisht janë të lidhura me botën e punës.

➤ **Ligji Nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (LMD):**

Duke marrë parasysh objektivat, qëllimin dhe dispozitat për mbrojtjen dhe parandalimin, LMD mbulon me veçanti fusha të tilla si punësimi (neni 12-16), arsimin (neni 17-19) dhe furnizimin me mallra e shërbime, duke përfshirë strehimin dhe shëndetin siç gjenden në nenin 20. Në lidhje me punësimin, neni 12 mbulon rastet kur çdo dallim, kufizim ose përjashtim i bazuar në terrenet e mbrojtura janë të ndaluara në fushën e punësimit.

➤ **Ligji Nr. 9970 / 24.07.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri" (LBGJ):**

Qëllimi, fushëveprimi dhe dispozitat për mbrojtjen dhe parandalimin në LBGJ janë përshtatur si të tilla për të siguruar mbrojtje efektive kundër diskriminimit me bazë gjinore dhe çdo forme sjelljeje që nxit diskriminim. Për më tepër, përmes përcaktimit të masave për të siguruar mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, dispozitat e LBGJ synojnë eliminimin e diskriminimit me bazë gjinore në çfarëdo forme që mund të ndodhë. LBGJ gjithashtu adreson barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi në arsim, punësim dhe media. Marrëdhëniet e punës rregullohen posaçërisht në Pjesën IV, duke përfshirë Nenet 16 - 23.

LBGJ nuk zëvendëson Kodin e Punës, por e plotëson atë me natyrën e tij specifike si një ligj specifik për çështjet e diskriminimit gjinor në marrëdhëniet e punës.

➤ **Ligji Nr. 10 237 / 18.2.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" (LSSH), i ndryshuar me Ligjin 161/2014,**

Synon garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë në të gjithë sektorët e veprimtarisë, si publike ashtu edhe private, përmes parandalimit të rreziqeve në punë, eliminimin e faktorëve të riskut dhe aksidenteve, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e ekuilibruar në përputhje me ligjet dhe trajnimin e punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre. Shëndeti në punë përfshin të gjithë elementët fizikë dhe mendorë që ndikojnë në shëndetin e punëmarrësit dhe që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë dhe higjienën në punë. Shëndeti dhe siguria në punë mbulojnë të gjitha masat që duhet të merren për të siguruar kushtet më të mira për kryerjen e procesit të punës, mbrojtjen e jetës, integritetin shëndetësor dhe mbrojtjen fizike dhe mendore

³⁸ Ligji Nr. 7961/12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me: Ligjin Nr. 8085/ 13.3.1996; Ligji Nr.9125 /29.7.2003; Ligji Nr.10 053/ 29.12.2008; Ligji Nr.136/ 5.12.2015.

në procesin e punës. Ky ligj përcakton se Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Inspektorati Shtetëror i Shëndetësisë janë autoritetet shtetërore të ngarkuara me mbikëqyrjen e zbatimit të LSSH, duke u caktuar atyre përgjegjësi konkrete.

Kodi penal lidhur me dhunën dhe ngacmimin në botën e punës

Kodi Penal, megjithëse nuk adreson në mënyrë specifike dhunën dhe ngacmimin në fushën e marrëdhënieve të punës, ka miratuar dispozita për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, të drejtave dhe lirive të njeriut për çdo person duke konsideruar gjithashtu mbrojtjen nga dhuna dhe ngacmimi edhe në këto marrëdhënie.

Konkretisht, Kodi Penal ndëshkon veprimet kriminale kundër moralit dhe dinjitetit të tilla si fyerja, shpifja, përndjekja [neni 121 / a], përhapja e sekreteve personale [neni 122]; ndëshkimi i veprimeve kriminale kundër shëndetit të tilla si goditja [neni 90], etj.

Për më tepër Kodi Penal dënon krimet seksuale dhe kualifikon ngacmimin seksual si vepër penale³⁹, si dhe dënon dëmtimin fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik. Kodi Penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera të marra kundër autorëve. **Lidhur me ngacmimin seksual në Kodin Penal, disa nga nenet me rëndësi përfshijnë:**

- Neni 108/a: **Ngacmimi seksual** (*Shtuar neni 108/a me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013*): Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtëruës ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.
- Neni 121/a: **Përndjekja** (*Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012*): Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë.
- Neni 289 **Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë**: Shkaktimi i vdekjes ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit ardhur si pasojë e mosrespektimit të rregullave që kanë të bëjnë me punën, prodhimin, shërbimin, të përcaktuara në ligj, në aktet e Këshillit të Ministrave apo në rregulloret përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri prej personave të ngarkuar me respektimin e rregullave dhe marrjen e masave në zbatim të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet. Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

4. Përmbledhëse e neneve të Kodit Penal që nevojitet të ndryshohen

Lidhur me dhunën dhe ngacmimin në botën e punës të parashikuara në Kodin Penal, disa nga nenet me rëndësi për tu trajtuar janë:

³⁹ Other forms of violence such as sexual violence, stalking, forced marriage and sexual harassment, were either introduced or entirely remodeled with the amendments to the CCA made by Law No. 144/2013. See also, [Greivio baseline report](#) pg 12.

Është

Neni 108/a: **Ngacmimi seksual** (*Shtuar neni 108/a me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013*)

Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Bëhet

Neni 108/a: **Dhuna dhe ngacmimi seksual** (*Shtuar neni 108/a me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013*)

Kryerja e veprimeve të dhunshme ose sjelljeve të padëshiruara verbale ose fizike me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur këto veprime kryhen në vendin e punës ose në lidhje me punën dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Nëse nga vepra rezulton sëmundje psikologjike, psikosomatike ose fizike ose me ulje të produktivitetit të punës së punëtorit, dënohet me burgim deri në XXX vjet dhe me gjobë deri në

Të diskutohet nëse është e nevojshme që vepra të parashikojë rastet e punësimit të të miturve, abuzimin me autoritetin; kur viktimë është vulnerabël për shkak të moshës sëmundjes, paaftësisë fizike ose mendore ose shtatzënisë; ose viktimë e dhunës në familje

Analiza e Kodit Civil lidhur me Regjimin e Bashkëpronësisë në Familjen Bujqësore

PERMBAJTJA:

1. Karakteristikat e bashkëpronësisë mbi tokën Bujqësore në Shqipëri
2. Përmbledhja e dispozitave ligjore mbi tokën bujqësore në Shqipëri
3. Problemet praktike të evidentuar në kuadrin ligjor mbi tokën bujqësore në Shqipëri
4. Referimet e gjykatës në lidhje me trajtimin e tokës bujqësore
5. Propozimet për ndryshimin e kodit civil mbi tokën bujqësore.
6. Përmbledhje e kërkesës për ndryshimin e Kodit Civil mbi tokën bujqësore

1. Karakteristikat e bashkëpronësisë mbi tokën Bujqësore në Shqipëri

Në doktrinën juridike mënyrat e përfitimit të pronësisë janë dy: origjinale dhe të prejardhur.

a) Mënyra origjinale e përfitimit të pronësisë, janë:

-Pushtimi (ocupatio)

-Fitimi i pronësisë mbi sende pazot;

-Fitimi i pronësisë me ligj

-Fitimi i pronësisë me parashkrim fitues, etj.

b) Mënyra e prejardhur e përfitimit të pronësisë, janë:

-Dëshmi trashëgimie

- Tjetërsim i pasurisë (shitje, dhurim, shkëmbim, kalim i të drejtave reale, sipërmarrje, etj); si dhe

- Çdo mënyrë tjetër klasike e fitimit të pronësisë të parashikuar në kodin civil (neni 41/2 i Kushtetutës).

1.1 Ndryshimi i bashkëpronësisë në përgjithësi nga bashkëpronësia e familjes bujqësore.

Në kodin civil shqiptar njihen dy lloj bashkëpronësish, të cilat janë të ndarë në krerë më vete:

- **Bashkëpronësi në pjesë:** e krijuar nga shitblerja, dëshmia e trashëgimisë (ligjore/testamentare), pjesëtim, shkëmbim, dhurim, etj. (përgjithësisht nga fitimi i pronësisë në mënyrë të prejardhur). Në këtë lloj bashkëpronësie, ata janë bashkëpronarë në pjesë ideale të pasurisë, sipas fraksionit përkatës dhe në referim të rregullave përkatëse të kodit civil, pjesën e tyre takuese, mund ta tjetërsojnë, shkëmbejnë, dhurojnë, ta lënë kolateral në bankë, etj.
- **Bashkëpronësia në tërësi, e cila përfshin 3 lloje:**
 - a) Bashkëpronësia e detyrueshme (objektet e përbashkëta të ndërtesave)
 - b) Bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve
 - c) Bashkëpronësia ndërmjet anëtarëve të familjes bujqësore (është institucion i veçantë sipas kodit civil aktual).
- Në këtë lloj bashkëpronësie, ata janë bashkëpronarë në tërësi të pasurisë së paluajtshme edhe sikur pjesa takuese e pasurisë të jetë e prezumuar sipas fraksionit përkatës. Sa i përket bashkëpronësisë së detyrueshme (kryesisht objektet e përbashkëta të ndërtesave) ajo përfitohet së bashku me sendin kryesor dhe nuk mund të tjetërsohet veçmas në asnjë lloj mënyre.
- Në bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, për pasuritë e përfituar gjatë martesës në regjimin pasuror martesor në bashkësi ligjore, asnjë nga bashkëshortët nuk mund ta

tjetërsojë, shkëmbejë, dhurojë⁴⁰, etj., pjesën e tij të bashkëpronësisë apo të prezumuar në bashkëpronësi, për sa kohë vijon bashkësia ligjore⁴¹.

- Në bashkëpronësinë ndërmjet anëtarëve të familjes bujqësore, asnjë nga bashkëpronarët nuk mund ta tjetërsojë, shkëmbejë, dhurojë, etj., pjesën e tij të bashkëpronësisë, pa u bërë më parë pjesëtimi i tyre⁴² sipas rregullave përkatëse të kodit civil⁴³.
- Pjesëtimi do të ndjekë rregullat përkatëse të legjislacionit në fuqi, i cili është i ndryshëm për bashkëpronësinë e bashkëshortëve dhe për anëtarët e familjes bujqësore.
- Bashkëpronësia mbi tokën bujqësore që i përket familjes bujqësore, është një lloj i veçantë i bashkëpronësisë. Karakteristikë e saj është se kjo pasuri është regjistruar në regjistrat publikë të pasurisë së paluajtshme vetëm në emrin e kryefamiljarit me përshkrimin F (i cili konsiderohet kryetar i familjes⁴⁴ bujqësore)⁴⁵. Përfitimi i saj është bërë në mënyrë origjinale, përkatësisht me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” (sipas gjendjes familjare të datës 01.08.1991 për ato ndërmarrje bujqësore që konsideroheshin kooperativë bujqësore dhe sipas gjendjes familjare të datës 01.10.1992 për ato ndërmarrje bujqësore që konsideroheshin “fermë”). Për sasinë e ndarjes së pasurisë u mor në konsideratë numri i anëtarëve të certifikatës familjare të kryefamiljarit si dhe sasia e pasurisë së paluajtshme që ndodhej në zona të caktuara. Psh. në zonat fushore ka pasur më shumë sipërfaqe për frymë se sa në zonat malore.

Fillimisht, toka bujqësore iu dha familjes bujqësore (kryefamiljarit) nëpërmjet aktit të marrjes së tokës në pronësi. Ndarja u bë në bazë të frymëve (të numrit të anëtarëve që kishte në përbërjen familjare kryetari i familjes), referuar certifikatës familjare të kryefamiljarit. Në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, ndalohej shprehimisht shitblerja e tokës bujqësore. Në vitin 1995, me ligjin nr. 8053 datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore” u lejua për herë të parë e drejta e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme tokë bujqësore, pra rrjedhimisht edhe e drejta e pronësisë, e disponimit të saj. Kryetari të Familjes bujqësore iu dha aq tokë sa ishte edhe numri i anëtarëve të familjes, të regjistruar në gjendjen civile të tij, pra në përbërjen familjare në datën që u mor si pikë referimi për ndarjen e tokës (përkatësisht 01.08.1991 ose 01.10.1991). Psh. në një kooperativë bujqësore në fshatin X, kishte tokë bujqësore dhe kishte mundësi për tu ndarë nga 2000 m² tokë bujqësore për frymë. Nëse në datën 01.08.1991, kryefamiljari kishte në përbërjen e tij edhe 4 anëtarë të tjerë (pavarësisht moshës së tyre), atij do ti jepej gjithsej 10.000 m² tokë bujqësore në përdorim (përkatësisht nga 2000 m² secilit anëtar).

Anëtarësia në familjen bujqësore sipas kodit tonë civil është dinamike, nuk është statike.

- Bashkëpronësia fitohet sipas mënyrave të përcaktuara në Kodin Civil dhe mënyrave të tjera, të përcaktuara me ligj të veçantë. Pjesët e pronarëve janë të barabarta derisa nuk vërtetohet e kundërta⁴⁶.

⁴⁰ Për pasuritë ndërmjet bashkëshortëve që kanë regjim pasuror martesor në bashkësi ligjore, lejohet vetëm dhurimi ndërmjet tyre; referuar Vendimit Unifikues të Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 03.02.2006.

⁴¹ Neni 97 Kodit të Familjes Ndalimi i pjesëtimit: “Pjesëtimi i pasurisë nuk mund të bëhet gjatë vazhdimit të bashkësisë, edhe në rast të një marrëveshjeje të bashkëshortëve”.

⁴² Referim: neni 226 I Kodit Civil “Anëtari i familjes bujqësore nuk mund të tjetërsojë asnjë pjesë të pasurisë së familjes bujqësore, gjersa nuk është bërë pjesëtimi i saj”.

⁴³ Sipas rregullave përkatëse të nenit 207 të Kodit Civil.

⁴⁴ Kryetari i familjes bujqësore është vendosur vetëm për shkak të faktit se në datën që është marrë në referim (01.08.1991 ose në 01.10.1991, ai ka qenë kryetari i përbërjes familjare regjistruar në gjendjen civile.

⁴⁵ Ndërkohë me ligjin 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, regjistrimet fillestare janë duke vijuar regjistrimin e të gjithë anëtarëve të cilët kanë qenë në përbërjen familjare të kryefamiljarit në datën 01.08.1991 ose në 01.10.1991 si dhe të gjithë anëtarët që janë aktualisht në përbërjen familjare të kryefamiljarit.

⁴⁶ Neni 199 I Kodit Civil.

- Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronareve caktohen në përpjesëtim me pjesët përkatëse dhe pjesëtimi i pasurisë realizohet në bazë të Kodit Civil në fuqi dhe me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronareve⁴⁷.

Nëse i referohemi historikut, trajtimi i familjes bujqësore e ka zanafillën që tek ligji nr. 108, datë 29.08.1945 "Për Reformën Agrare". Në bazë të këtij ligji, shpronësoheshin të gjithë çifligjet e shtetit, pronat bujqësore private dhe të enteve private dhe fetare, tokat e instaluarve nga reforma agrare e regjimit të zogut, pendët e punës dhe veglat bujqësore që ndodheshin në posedim të fshatarëve që shpronësoheshin. Në nenin 1 të ligjit 108/1945 parashikohej se: "Me shpalljen e këtij ligji shpronësohen detyrimisht dhe u ndahen fshatarëve, nënshtetas shqiptar që nuk kanë toka të tyre ose që nuk ju mjafton toka". Fshatari me anë të tapisë, bëhej pronar i tokës që përmbante akti administrativ/titulli/Autorizimi i lëshuar nga Zyra e Reformës Agrare. Ky autorizim kishte për qëllim përdorimin e pronës vetëm për nevoja të prodhimit dhe fshatari ishte i ndaluar të tjetërsonte pronën apo të kryente veprime të tjera në kuadër të ushtrimit të tagrave të pronësisë. Kalimi i pronësisë nëpërmjet tapisë nuk ishte një marrëdhënie juridiko civile ndërmjet shtetit dhe individëve. Në rast se prona punohej bashkërisht prej shumë personave që bashkëjetonin, zotërimi i tokës u përkiste bashkërisht të gjithëve në pjesë të barabarta dhe titulli i zotërimit u jepej të gjithë pjesëtarëve. Quhej familje bujqësore ajo që përbëhej nga të gjithë personat që vinin nga një trung dhe që bashkëjetonin dhe bashkëpunonin. Në qoftë se kishte pjesëtar të tjerë që lidheshin në gjini ose me krushqi, ose të martuar ose të veja me fëmijë meshkuj shtoheshin hektarë për çdo pjesëtar të kësaj kategorie (kurorë)⁴⁸.

Sa i përket koncepteve: "*Tokë bujqësore*", bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", përfshihet: **toka bujqësore të zëna me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo që ndodhen, në fshatra, në qytete e në qendra të tjera të banuara, pavarësisht nga madhësia e tyre.** Kuptimin e tokës bujqësore e gjejmë edhe në ligje të tjera të posaçme. Në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993, në nenin 3 gjejmë cilësimin: "***Me tokë bujqësore do të kuptohet toka që ndodhej jashtë vijave kufizuese të qendrave të banuara në momentin e shpronësimit, por që në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, është tjetërsuar në truall***"⁴⁹.

Me vazhdimin e reformës, vijonte edhe plotësimi i kuadrit ligjor. Me akte ligjore u përcaktuan subjektet përfituese të ligjit nr. 7501/1991, "Për tokën" kriteret dhe kufizimet, për ndarjen e tokës bujqësore.

Subjektet përfituese ishin:

1. Familjet anëtare të kooperativave bujqësore, që punonin e jetonin në fshat (normë të plotë);
2. Familjet që banonin në fshat dhe punonin në ndërmarrjet bujqësore (normë të plotë).
3. Individët që përkohësisht nuk ndodheshin në fshat, si fëmijë, nxënës, studentë, ata që kryenin shërbimin ushtarak, pensionistë, anëtare të cilët kishin një kontratë pune të përkohshme dhe emigrantët (kjo kategori trajtohej me normë të plotë).
4. Familjet e përndjekura nga regjimi komunist që banonin në fshat dhe ishin ende të pa sistemuar me punë në qytet apo zona të banuara (edhe kjo kategori përfitonte tokën në pronësi dhe me normë të plotë)

⁴⁷ Neni 199/3 e Kodit Civil.

⁴⁸ Shiko për më tepër <https://altri.al/wp-content/uploads/2018/05/ANALIZA-LIGJORE-21.11.2012.pdf>, fq. 20, 21

⁴⁹ Kuptimi i tokës bujqësore gjendet edhe në ligjin nr.8337, datë 30.4.1998 "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave; në ligjin 9244, date 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", I ndryshuar; etj.

5. Individët që kishin një kontratë pune të përhershme në qytet. Kjo kategori trajtohej sa gjysma e kategorisë së individëve që përfitonin tokë me normë të plotë, por në asnjë rast nuk duhet të kalonte një dynym. Me pas, me rishpërndarjen e tokave të pandara, kësaj kategorie iu mundësua plotësimi me tokë (normë e plotë).
6. Individët që ishin të punësuar në shërbimet publike në fshat, si mësues, mjeke, infermier, rrobaqepës etj. (kjo kategori do ta përfitonte tokën vetëm në përdorim). Kategorisë së fundit toka iu dha vetëm në përdorim, ndërsa sasia e sipërfaqes që do t'i shpërndahej përcaktohej me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Përmbledhja e dispozitave ligjore mbi tokën bujqësore në Shqipëri

Përveç Kodit Civil, ligjet e tjera që kanë vepruar dhe veprojnë mbi tokën bujqësore, janë:

2.1 Akte juridike të posaçme mbi bazën e të cilave janë krijuar të drejta pronësie;

- Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”;
- Ligji nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”;
- Ligji Nr.7652, datë 23.12.1992 “ Për privatizimin e banesave shtetërore”;
- Ligji 8053 dt 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore “, neni 1 dhe neni 4.
- Ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”;
- Ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;
- Ligjit 9948 datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë të tokës bujqësore”.
- Ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë” në Republikën e Shqipërisë.
- Vendimi nr. 161, datë 08.04.1993 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjes bujqësore”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 29.8.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”;
- VKM Nr. 1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve të sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”;
- Vendimi nr. 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre.
- Vendimi nr. 230, datë 22.7.1991 “Për krijimin e komisioneve të tokave”
- Vendimi nr. 255, datë 2.8.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”,
- Udhëzimi nr.2, datë 2.8.1991 “Për funksionimin e komisioneve të tokës të rretheve e të fshatrave”.

2.2 Baza ligjore e ndarjes dhe trajtimit të tokës bujqësore.

- Neni 5 i **ligjit nr. 7501**, dt.19.07.1991 “Për tokën” përcakton se: **familjet anëtare të kooperativës bujqësore**, pas ndarjes së tokës kanë të drejtë të shkëputen dhe të dalin subjekt me vete, duke marrë në pronësi tokën bujqësore që u takon nga tërësia e subjektit ku bëjnë pjesë. Sasia dhe vendi ku do të jepet toka, përcaktohet nga komisioni i tokës.

Mbi bazën e këtij ligji dolën edhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe konkretisht:

- **Vendimi nr. 230, datë 22.7.1991 “Për krijimin e komisioneve të tokave”** sipas së cilit sanksionohet se, “Komisioni i tokës në fshat ka këto detyra: 1. Bën verifikimin e numrit dhe përbërjen e familjeve të anëtarëve të kooperativave bujqësore, si dhe të familjeve të tjera që banojnë në fshat, mbi bazën e gjendjes civile dhe përcakton sipërfaqen që i takon çdo familjeje. 2. Bën ndarjen e tokës dhe korigjimet e nevojshme për mosmarrëveshjet e lindura... 3. Përcakton madhësinë e tokës bujqësore dhe vendin ku do t’i jepet toka familjeve... Ndarja e tokës bëhet mbi bazën e numrit të frymëve të çdo familjeje, brenda kooperativës ku ajo bën pjesë.”

Gjithashtu vendimi **nr. 255, datë 2.8.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”**, ka vendosur kriteret e ndarjes së tokës sipas së cilit “**Toka ndahet sipas gjendjes aktuale të sipërfaqes që ka kooperativa bujqësore dhe numrit të frymëve dhe në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1.8.1991”**.

- **Udhëzimi nr.2**, datë 2.8.1991 “Për funksionimin e komisioneve të tokës të rretheve e të fshatrave”.

Pjesa III. *Radha e punës së komisionit për ndarjen e tokës dhe dokumentacioni përkatës.* 1. Komisioni i Tokës pajiset nga zyra e kadastrës me planimetrinë kadastrale dhe librin e ngastrave. 2. Komisioni i tokës në fshat bën njohjen e terrenit duke e krahasuar atë me planimetrinë kadastrale. Pasi shkel në të gjitha tokat e fshatit, komisioni nxjerr këto të dhëna: -sipërfaqen e tokës bujqësore për çdo zë kadastral, ndarë në ara, pemëtore, vreshta e ullishte. – kufizon në planimetri sipërfaqet e këtyre tokave që janë nën ujë. 3. Komitetet ekzekutive të rretheve dhe zyrat e gjendjes civile përkatëse u japin komisioneve të tokës në fshat listën me emrat e kryefamiljarëve dhe numrin e frymëve për secilën familje me gjendjen e datës 1 gusht 1991.

4. Komisioni i tokës në fshat në bazë të të dhënave për tokën dhe përbërjes familjare, cakton sipërfaqen e tokës në m² për frymë dhe sipërfaqen e tokës për çdo familje, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. ...”

- **Vendimi nr. 452**, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”

Pika 1 “Ndërmarrjet bujqësore ose njësitë e tyre që janë krijuar kryesisht nga toka e ish –kooperativave bujqësore, të shpërndahen.

Pika 2 “Toka e këtyre ndërmarrjeve bujqësore ose njësive të tyre që do të shpërndahen e që kanë qënë pronë e ish-kooperativave bujqësore t’u jepet në pronësi familjeve të ndërmarrjeve bujqësore. Në Ndarjen e tokës do të zbatohen kriteret e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 02.08.1991”Për Kriteret e ndarjes, së tokës bujqësore, me ndryshimet”, Për ndërmarrjet qw kanë qënë kooperativa bujqësore të formuara nga qytetarë, të cilat do të përcaktohen nga Agjencia qëndrore e ristrukturimit dhe e privatizimit të ndërmarrjeve bujqësore, toka do të jepet në përdorim ku do të përfitojnë edhe punonjësit e këtyre ndërmarrjeve me banim në qytet dhe anëtarët themelues të kooperativës ose ndërmarrjes bujqësore që banojnë në territorin e ndërmarrjes”.

- Vendimi nr. 161, datë 08.04.1993** “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjes bujqësore”.

“Në VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore” bëhen këto ndryshime e shtesa: 1. Paragrafi i dytë i pikës 2 ndryshohet si vijon: “Në ndërmarrjet bujqësore, të krijuara nga ish-kooperativat bujqësore me toka bujqësore të qytetarëve të një qyteti të caktuar, si dhe në ndërmarrjet bujqësore. Të krijuara drejtpërdrejtë me toka bujqësore të qytetarëve po të një qyteti të caktuar, toka u jepet në përdorim punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore dhe anëtarëve të trungut të familjes që kanë dorëzuar tokë bujqësore për formimin e ish-kooperativës a të ndërmarrjes bujqësore dhe që banojnë në të njëjtin qytet, por jo më shumë se sipërfaqja e tokës që kanë dorëzuar”.

- **Ligji nr. 8053 dt. 21.12.1995 “ Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore “**

Neni 1 dhe neni 4 i tij

Kur familja dëshiron ta tjetërsojë pronësinë mbi tokën bujqësore, livadhet e kullotat, i paraqet regjistruarit dokumentet e shënuara më poshtë.

- a) Një kërkesë për regjistrimin e aktit noterial të shit-blerjes së tokës bujqësore, livadheve e kullotave të familjes, e cila duhet të jetë e firmosur nga kryetari i familjes, emri i të cilit është regjistruar si pronar i kësaj toke në kartelën përkatëse të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.*
- b) Një prokurë të posaçme të noterizuar, në të cilën pjesëtarët e familjes bujqësore qënë, momentin e tjetërsimit gëzoj- në zotësi për të vepruar dhe që kanë qënë anëtarë të familjes në momentin e marrjes në pronësi të kësaj toke, prej kësaj të fundit, vërtetojnë se kryetarin e familjes e caktojnë përfaqësues ligjor për efekt të tjetërsimit të tokës bujqësore, livadheve e kullotave të familjes nëpërmjet shitjes.*
- c) Shitja e mundshme e tokës bujqësore, livadheve e kullotave duhet të lajmërohet në mënyrë të tillë që anëtarët e familjes, të cilët nuk banojnë me kryetarin, të kenë mundësi të shprehin mendimin e tyre në lidhje me tjetërsimin. Nëse anëtar i sipër- treguar nuk përgjigjet brenda 15 ditësh nga ditë kur i është bërë lajmërimi, ai/ajo do të trajtohet sikur ka dijeni për blerjen.*

Neni 6 i tij

Kur familja, personi, dëshiron të shesë tokën bujqësore, livadhin ose kullotën, detyrohet të bëjë publikimin e ofertës në fshat, duke respektuar radhën e përparësisë së të tretëve, me përjashtim të rasteve të nenit 5 të këtij ligji si më poshtë:

1. Të paralindurve dhe të paslindurve madhorë në vijë të drejtë, vëllezërve dhe motrave.
2. Kufizuesve të parcelës - objekt shitblerjeje.
3. Ish-pronarit.
4. Banorëve të tjerë të fshatit.
5. Cilitdo shtetas shqiptar.

Brenda së njëjtës shkallë përparësie i jepet prioritet afërsisë gjeografike të parcelës që shitet me parcelat e kandidatëve të vlerës.

- **Ligji 8337, datë 30.4.1998 për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave.**

Neni 5 i tij

“Familja bujqësore që i kalon pronësinë e saj mbi tokën bujqësore, pyjore, livadhet, kullotat çdo shtetasi, personi fizik dhe juridik vendas në përputhje me kërkesat ligjore për kalimin e pasurisë së paluajtshme, paraqet në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dokumentet vijuese:

a) Certifikatën e vërtetimit të pronësisë të zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, shoqëruar me aktin noterial për kalimin e pronësisë dhe hartën treguese të vendndodhjes së pronës.

b) Aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga certifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes.

c) Skicën topografike të pasurisë që do të jetë objekt i kalimit të pronësisë.

ç) Prokurën noteriale të përfaqësimit, kur kalimi i pronësisë nuk kryhet nga gjithë anëtarët e familjes bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme.

- **Ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”, në Republikën e Shqipërisë.**

Neni 6, i tij.

1. Dispozitat e këtij kreu kanë për qëllim konsolidimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi tokën bujqësore, nëpërmjet: a) regjistrimit të titujve të pronësisë, që burojnë nga të gjitha aktet ligjore e nënligjore për pronësinë mbi tokën bujqësore, që kanë sjellë efekte përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji; b) përfundimit të proceseve të pajisjes me tituj pronësie të përdoruesve të tokave të ish-kooperativave dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët kanë paraqitur kërkesë për këtë qëllim deri në gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Proceset e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kryhen në funksion të zhvillimit strategjik dhe të qëndrueshëm të sektorit bujqësor.

Neni 7 i tij.

1. Akti i marrjes së tokës në pronësi, i përfituar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, i paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, nuk i nënshtrohet verifikimit të vlefshmërisë nga ASHK-ja. Ai regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme nëse plotësohen njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) përfituesi i AMTP-së ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore ose, edhe nëse nuk ka qenë i legjitimuar, ka përfituar tokën, për të cilën i është hequr pronësia atij apo trashëgimlënësit gjatë krijimit të ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore; b) përfituesi i AMTP-së ka marrë tokë në territorin e vetëm një ish-kooperative ose ish-ndërmarrjeje bujqësore; c) toka për të cilën është lëshuar AMTP-ja nuk ka qenë “truall”, “vepër e infrastrukturës publike”, “rërë bregdetare”, “plazh” ose “sipërfaqe ujore”, në kohën e lëshimit të aktit. 2. Për AMTP-të që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij neni, kur kanë mangësi në elementet e formës, mungesa e këtyre elementeve nuk pengon regjistrimin, me kusht që nga dokumentacioni i procesit të ndarjes së tokës bujqësore, që ASHK-ja administron, sipas pikës 6, të nenit 68, të këtij ligji, ose që paraqet subjekti si provë, vërtetohet se subjektit i është dhënë tokë në pronësi.

Neni 12 i tij.

1. Përfitojnë kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore, subjektet që plotësojnë, njëkohësisht, këto kushte: a) janë përfitues të tokës në pronësi ose përdorim, sipas akteve nënligjore që kanë rregulluar marrëdhëniet juridike të ndarjes apo dhënies në përdorim të tokës bujqësore të vitit 1991 e në vazhdim. Subjekte përfituese janë edhe: i) punonjësit e ish-ndërmarrjes bujqësore më 1.8.1991, gjendja civile e të cilëve u është transferuar në fshatin ku gjendet toka objekt i kalimit në pronësi, pas datës 1.8.1991; ii) personat që nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore, por kanë qenë banorë të fshatit ku gjendet toka bujqësore, objekt i kalimit të pronësisë, sipas regjistrit të gjendjes civile më 1.8.1991; iii) personat që u është hequr e drejta e pronësisë me krijimin e ish-kooperativave bujqësore apo ish-ndërmarrjeve bujqësore ose trashëgimtarët e tyre; b) nuk kanë përfituar tokë bujqësore në territorin e ndonjë ish-kooperative apo ish-ndërmarrjeje bujqësore tjetër; c) deri në 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë paraqitur kërkesë pranë njërive të vetëqeverisjes vendore për t'u pajisur me AMTP për tokat e ish-kooperativave bujqësore apo ish-ndërmarrjeve bujqësore, pavarësisht nëse janë pajisur ose jo me aktin e marrjes së tokës në përdorim; ç) janë përdorues faktikë të tokës bujqësore. 2. Toka që kalohet në

pronësi, pa shpërblim, duhet të përmbushë, njëkohësisht, këto kushte: a) t'i përkasë një prej zërave të tokës bujqësore; b) të mos jetë pronë private e të tretëve; Faqe 684 c) të mos jetë objekt i formave të kompensimit fizik, sipas legjislacionit në fuqi për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave; ç) të mos jetë zënë nga ndërtime pa leje të të tretëve apo të vetë subjektit kërkues; d) të mos jetë objekt i investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë; Nëse ndalimet e listuar në këtë pikë janë të pranishme për një pjesë të sipërfaqes së tokës, kalimi i pronësisë, pa shpërblim, zbatohet vetëm për pjesën e mbetur.

- **Ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”**

Ky ligj prezantohet nga legjislatori si një reflektim ndaj problemeve të natyrës institucionale, procedurale dhe materiale të evidentuara gjatë procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme⁵⁰. Gjatë fazës së procedurave parlamentare për miratimin e tij, nene të caktuara të Projektligjit “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” iu nënshtruan edhe një vlerësimi nga ana e Komisionit të Venecias. Gjatë misionit fakt-mbledhës të këtij Komisioni u evidentuan premiset mbi bazën e të cilave propozohej ky ligj. Konkretisht, u evidentua mungesa e hartave të besueshme kadastrale, fakti se ka pasur arkiva të djegura, të humbura ose të pa administruara siç duhet, kufij të papërcaktuar të ngastrave të tokës, mungesa formale, materiale apo hartografike në Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi (“AMTP”) të miratuara gjatë viteve, mbivendosje të drejtash mes 2 ose më shumë subjekteve ose mbivendosje me pronat e paluajtshme të shtetit, AMTP të lëshuara për sipërfaqe shumë të vogla ose për toka të pafrytshme (ranore ose shkëmbore), ekzistenca e ndërtimeve 200-300 vjeçare me mungesë të theksuar dokumentacioni ligjor mbi pronësinë, apo të dhënat teknike e hartografike⁵¹

Me VKM Nr. 1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve të sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese” është përcaktuar lista shteruese e subjekteve që legjitimohet të kërkojnë regjistrimin e AMTP-ve. Konkretisht, në nenin 6.1 të këtij vendimi përcaktohet se, “Subjekti përfitues i AMTP-së legjitimohej për të përfituar tokë sipas akteve ligjore dhe nënligjore të kohës për tokën bujqësore. Në kuptim të kësaj pike, legjitimohet përfituesi i AMTP-së, nëse: a) ka qenë anëtar i ish-kooperativës bujqësore dhe banor në datën 1.8.1991, i fshatit ku gjendej ish-kooperativa bujqësore; b) në datën 1.8.1991 ka qenë banor i fshatit, ku gjendej ish-kooperativa bujqësore, pavarësisht se nuk ka qenë anëtar i saj; c) ka qenë anëtar themelues i ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore dhe banonte në territorin e tyre në datën 1.10.1992; ç) në datën 1.8.1991 ka qenë punonjës i ndërmarrjes bujqësore; d) ka përfituar nga e drejta sipas neneve 5 dhe 6, të ligjit nr.7514, atë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” dhe që ishin subjekt të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”; dh) është zhvendosur nga qendra e tij e banimit për në territoret e ish-ndërmarrjes bujqësore me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas të cilit janë edhe përfitues të tokës bujqësore në pronësi; e) është ose janë trashëgimtarë ligjorë të personit, toka e të cilit është marrë gjatë reformës agrare për krijimin e ish-kooperativave bujqësore dhe të ish-ndërmarrjeve bujqësore, pavarësisht vendbanimit të tyre në kohën e lëshimit të AMTP-së, referuar të dhënave që rezultojnë nga dokumentacioni kadastral i strukturës së administrimit dhe menaxhimit të tokës (DAMT/ZAMT) dhe, konkretisht, dokumentet në të cilat evidentohen pronësitë private apo shtetërore para hyrjes në fuqi të ligjit nr.108, datë 29.8.1945, “Për reformën agrare”, siç janë listë pronësitë, regjistrat apo çdo arkiv tjetër nga ku rezultojnë të dhëna të tilla. Në rast se ky dokumentacion nuk ekziston, konsiderohet se personi legjitimohet si përfitues sipas kësaj shkronje, nëse disponon aktin

⁵⁰ Shiko për më tepër: <https://rm.coe.int/komentar-press/1680a490ea>, fq. 8

⁵¹ Opinion i Komisionit të Demokracisë nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr. 962/2019, CDL-AD(2019)023 mbi Projektin e Ligjit për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë, i miratuar në Sesionin Plenar të 120-të më 11-12 Tetor 2019, para. 72. Shih për më tepër: www.venice.coe.int/webforms/documents/?default.asp?documentId=3333

e marrjes së tokës në pronësi. Në asnjë rast, ASHK-ja nuk shqyrton vlefshmërinë e dokumentacionit që shërben për legjitimim, sipas kësaj shkronje⁵².

3. Problemet praktike të evidentuar në kuadrin ligjor mbi tokën bujqësore në Shqipëri

Shqipëria rezultoi të jetë vendi me më pak tokë bujqësore për frymë në Evropë. Reforma në Shqipëri pas viteve '90 preku të gjithë sektorët e vendit, por reforma rrënjësore u zhvillua në fushën e pronave veçanërisht në tokën bujqësore, e cila zë rreth 24.2 % të territorit të Republikës së Shqipërisë⁵³. Ligji 7501/1991 përcaktoi një ndarje të re të pronësisë.

Kuadri ligjor referuar ligjeve të posaçme për fitimin e pronësisë të tokës bujqësore rezulton e paplotë me dispozita ligjore, të cilat janë jo në koherencë me njëra-tjetrën dhe i pamjaftueshëm për t'i dhënë zgjidhje disa prej problematikave reale. Ankesat dhe paqartësitë e titujve të pronësisë paraqiten më tepër për toka përgjatë vijës bregdetare, se sa në pjesën tjetër të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Praktikat administrative dhe gjyqësore paraqiten ende të pa-unifikuara.

Në disa raste organet në vendimet gjyqësore arrijnë në përfundime të ndryshme për situata të njëjta dhe mungon një mjet efektiv ankimimi si në rastet e vonësës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë edhe në rastet kur vendimet gjyqësore janë të pazbatueshme.

Shqipëria paraqitet një rast unik, krahasuar më vendet e tjera ish-socialiste, pasi tokat bujqësore nuk iu rikthyen ish-pronarëve, por iu dhanë pa kundër shpërblim familjeve fshatare, fillimisht në përdorim e më pas në pronësi. Në të gjitha vendet e Evropës Lindore toka iu kthye më parë ish-pronarëve e më pas u trajtuan/përfituan edhe disa kategori të tjera. Vendi ynë përveçse, e krijoi më pas në kohë ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve, por në të përcaktoi se ish pronarët nuk mund të merrnin fizikisht toka bujqësore në rast se ajo u ishte ndarë fshatarëve me ligjin 7501.

Kjo praktikë e ndjekur, vetëm në vendin tonë, ka sjellë më pas edhe pasaktësi ndërmjet atyre që e posedojnë aktin e marrjes së tokës në pronësi dhe atij që i takon sipas trashëgimisë (ish pronarëve). Kjo diferencë kaq e theksuar evidentohet veçanërisht në veri të vendit, përkatësisht në zonën e malësisë së madhe. Ligji 7501 në disa zona të Shqipërisë (kryesisht në veri, Malësi e Madhe), nuk u zbatua nga ana e fshatarëve, por në një masë të madhe ata e kanë ndarë atë sipas sipërfaqeve që u takonte ish pronarëve. Kjo ka sjellë faktin se atje konfliktet ndërmjet anëtarëve janë pothuajse zero, sepse ndarja është bërë sipas vullnetit të banorëve, por kanë mbetur të paregjistruar në ASHK, për shkak se nuk është zbatuar reformës e '91 dhe ndarja është në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara për ndarjen e tyre. Kjo problematikë vijon prej pothuajse 30 vitesh⁵⁴.

Kodi ynë civil, bashkëpronësinë mbi tokën bujqësore e përmbledh në 9 dispozita ligjore. **Familja bujqësore është një institut që gjen rregullim në kodin civil nëpërmjet neneve 222-230 në Kodin Civil.**

Është e nevojshme të ndalemi në përcaktimin që bën Kodi Civil për të rregulluar marrëdhëniet brenda një familjeje bujqësore, duke parashikuar një rreth më të gjerë përfituesish sesa ai i parashikuar nga vetë ligji nr. 7501/1991.

→ Këtu i referohemi përcaktimit të bërë në nenin 223 të Kodit Civil, ku shprehimisht theksohet se familja bujqësore përbëhet nga persona që lidhen ndërmjet tyre për shkak gjinie, martesë, birësimi ose pranimit si anëtar i saj.

⁵² Shiko: <https://rm.coe.int/komentar-press/1680a490ea>, fq. 50

⁵³ Strategjia Rurale për Shqipërinë-Mbështetje për rritje Ekonomike dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, viti 2002, f. 122. Shiko: <http://siteresources.earthbank.org/.../AlbaniaRuralStrategyAlbania.pdf>.

⁵⁴ Shiko për më tepër: https://ëë.qag-al.org/publikime/ceshtjet_gjinore_pronesise.pdf.

Ka një mos-koherencë ndërmjet ligjit nr. 7501/1991 "Për tokën" dhe ato të Kodit Civil (neni 222) kapitulli për bashkëpronësinë, pasi rrethi i personave bashkëpronarë mbi tokën bujqësore nuk është i përcaktueshëm sipas kriterëve të ligjit 7501/1991 "Për tokën".

- Kuptimi i bashkëpronësisë gjendet në nenin 199 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nën përcaktimin: "Ka bashkëpronësi kur një ose disa sende dhe te drejta të tjera reale përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave". Por ky kod jep edhe kuptimin e familjes bujqësore, në nenin 222, shprehimisht: "**Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore**".

Por një pyetje që lind është: Në referim të nenit 222, kjo pronësi e cila përcaktohet në tërësi të anëtarëve të saj, nënkupton se është në pjesë të barabarta? Nëse marrim për ilustrim një rast praktik, Anëtarë të FB rezultojnë të jenë 5 anëtarë, ata do të kenë nga 1/5 pjesë takuese? Nëse i referohemi nenit 222 K.C, përcakton si anëtarë të FB, ata të cilët **nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara** kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore. Lind pyetja: Si faktohet puna? Nënkupton punë fizike apo edhe ndihmë ekonomike? Sjellim në vëmendje që në 90 % të rasteve praktike, anëtarët e familjes bujqësore jetojnë dhe punojnë jashtë Republikës së Shqipërisë. Në rast të transaksioni të kësaj pasurie që i përket familjes bujqësore, a duhet ti hyjmë hetimit se sa ka qenë kontributi i secilit? Si duhet ta bëjnë këtë konstatim, me vetë-deklarim?

Çfarë kuptohet me frazën: ose të drejtave të tjera të fituara"? A përfshihen këtu martesë, lindja, birësimi apo i referohet trashëgimisë, etj.? A janë të drejta të tjera të fituara pranimit i një anëtari të ri? Neni 223: "Familja bujqësore përbëhet nga personat që lidhen ndërmjet tyre për shkak gjinie, martesë, birësimi ose **pranimit si anëtar i saj**".

Raste praktike/problematika në trajtimin dhe identifikimin e familjes bujqësore

- Nëse familja bujqësore në vitin 1991 ka qenë me 4 anëtare, përkatësisht A (kryetari i familjes dhe kryetar i FB, B, C, D). C është martuar, D është martuar dhe ka edhe dy fëmijë. A do të konsiderohen edhe ata anëtarë të familjes bujqësore, meqenëse dispozita (neni 222 K.C) përcakton përfitim të pronësisë nëpërmjet të drejtave të tjera?
- Nëse po, sa u takon? Pra bashkëshortja e C do të marrë në pjesë të barabartë apo do të marrë vetëm 1/2 pjesë të bashkëshortit të saj? Po bashkëshortja dhe fëmijët e D sa pjesë do të marrin?
- Nëse Bashkëshortja e C ose e D do të jetë përfituese e kësaj familje bujqësore, por ndërkohë në 91 ka qenë përfituese e familjes bujqësore të origjinës së saj (babain kryefamiljar) do të përfitojë nga të dy familjet bujqësore tokë bujqësore?
- Po nëse bashkëshortja e D nuk ka përfituar nga familja e origjinës sepse ka jetuar në qytet, a do të duhet të përfitojë nga kjo familje bujqësore? Sa pjesë?
- Po në rast se divorcohet C ose D, a ka të drejtë bashkëshortja e tij të kërkojë pjesë nga familja bujqësore, nga pjesa e bashkëshortit të saj, kur ajo nuk ka qenë anëtare e familjes bujqësore në 91 por i është bashkuar kësaj familje në vitin 1995 dhe ka jetuar deri në 2005?

Kush do të konsiderohen anëtarë të familjes bujqësore? Vetëm anëtarët e 1991 (apo 1992) apo edhe anëtarë të tjerë që i janë shtuar familjes? Kush do ta përcaktojë familjen bujqësore, certifikata e gjendjes civile? Pra familja bujqësore barazohet me familjen civile?

Nëse bëjmë një paralelizëm me nenin 222 të Kodit civil dhe nenit 5 të Ligjit për shitblerjen e tokës bujqësore 1998, a na i jep përgjigjen që kërkojmë?

Neni 222 K.C. “Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore”.

Neni 5 i ligjit 98: “Familja bujqësore që i kalon pronësinë e saj mbi tokën bujqësore, pyjore, livadhet, kullotat çdo shtetasi, personi fizik dhe juridik vendas në përputhje me kërkesat ligjore për kalimin e pasurisë së paluajtshme, paraqet në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dokumentet vijuese: a) Certifikatën e vërtetimit të pronësisë të zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, shoqëruar me aktin noterial për kalimin e pronësisë dhe hartën treguese të vendndodhjes së pronës. **b) Aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga certifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes.** c) Skicën topografike të pasurisë që do të jetë objekt i kalimit të pronësisë. ç) Prokurën noteriale të përfaqësimit, kur kalimi i pronësisë nuk kryhet nga gjithë anëtarët e familjes bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme.

Në lidhje me sa më sipër, ASHK ka mbajtur një qëndrim, duke unifikuar praktikën në drejtoritë vendore të saj, në të cilën kërkon që për regjistrimin e tjetërsimit të tokës bujqësore të merret certifikata familjare e kryefamiljarit e datës në të cilën kryhet transaksioni dhe të nënshkruajnë anëtarët e familjes që kryefamiljari ka në certifikatë. Kjo sjell një problematikë tjetër praktike: Ndarja e kryetarit të familjes nga anëtarët e tjerë mund të bëhet me një kërkesë të thjeshtë dhe menjëherë nga gjendja civile. Pra kryetari i familjes bujqësore mund të rezultojë vetëm me bashkëshorten e tij aktualisht dhe të gjitha anëtarët e tjerë mund të përjashtohen nga bashkëpronësia.

Ne referim të nenit 223, i cili bën një sqarim më të hollësishëm të personave që përbëjnë familjen bujqësore, ku përfshihen persona për shkak gjinie, martesë, birësi **ose pranimit si anëtar i saj**, lind pyetja: si bëhet pranimi si anëtar i saj? A kërkon pranimi një akt noterial, a konsiderohet shitblerje, dhurim, kompensim? Në legjislacionin tonë ne i kemi të përcaktuar mënyrat klasike të përfitimit të pronësisë në kodin civil. Kjo dispozitë, në praktikë ka mbetur e pazbatuar sepse nuk ka asnjë akt nënligjor që të sqarojë mënyrën se si pranohet anëtar i ri i familjes bujqësore.

Pyetje: Sa duhet të jetë kontributi i një anëtari të familjes bujqësore, në rast se ai kërkon të bëhet anëtar i saj? A duhet të ketë lidhje gjaku, lidhje juridike apo mund të jetë kushdo? Përderisa njihet martesë, a mund të njohet edhe bashkëjetesa? Si duhet ta verifikojë noteri një rast të tillë dhe ku duhet të regjistrohet ai, kur në fakt ligji për shitblerjen e tokës bujqësore, na referon tek certifikata familjare e kryefamiljarit?

Ligji për shitblerjen e tokës bujqësore, përveç certifikatës familjare, kërkon edhe deklaratën e anëtarëve të familjes, **si dhe një vërtetim nga pushteti lokal** se kush janë anëtarë të familjes bujqësore. A do të duhej të ishte detyrë e pushtetit lokal që të verifikojë dhe të përcaktojë se kush janë anëtarë të familjes bujqësore? Apo është detyrë e noterit të verifikojë bashkëpronarët e pasurisë?

Aktualisht në praktikë, familja bujqësore është duke vepruar si e tillë apo e ka humbur konceptin e saj për të cilin u krijua dhe tashmë ka mbetur thjesht një bashkëpronësi?

Në këtë rast i referohemi praktikës, ku në pjesën më të madhe toka bujqësore është kthyer në truall dhe ka ndryshuar destinacioni i saj.

Toka u nda në referim të ligjit 7501, nëpërmjet dokumentit të aktit të marrjes së tokës në pronësi. Në të është përcaktuar vetëm toka dhe lloji kadastral. Nëpërmjet një akti tjetër që është lista e trojeve, u ndanë edhe trojet dhe ndërtesa ekzistuese në fshat. Por në momentin e regjistrimit të tyre në ish ZVRPP apo në ASHK sot, u regjistruan në një të vetëm truall, arë dhe ndërtesë dhe në pronësi të familjes bujqësore. Ky është një gabim në regjistrimin e bërë nga ish ZVRPP. Në këtë rast, në praktikë është kërkuar korrigjimi i akteve të pronësisë, duke kërkuar që trualli dhe ndërtesa të regjistrohen veçmas me certifikatë pronësie

dhe të jetë në pronësi të kryetarit të familjes (dhe bashkëshortes së tij), për shkak të përfitimit gjatë martesës. Ndërsa toka bujqësore të jetë me certifikatë veçmas në emër të kryetarit të familjes bujqësore.

1. Një dilemë tjetër, e cila ka konfuzuar juristët dhe veçanërisht noterët që u duhet ta zbatojnë në praktikë, është përcaktimi i nenit 5 të ligjit 1998, pika b e saj, ku përcakton se për tjetërsimin e një pasurie që i përket familjes bujqësore, duhen edhe: **b) Aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga certifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes...**
 - Frazja në **çastin e kalimit të pronësisë**, çfarë nënkupton? Çastin e kalimit të pronësisë në datën e kryerjes së transaksionit apo çastin e kalimit të pronësisë me ligjin 7501?
 - Po ti referohemi formulimit që ka bërë kolegji civil i gjykatës së lartë në 4/2012 referon me termin "... pjesëve përfituese për frymë **në momentin e kalimit të pronësisë nga shteti tek anëtarët e familjes bujqësore sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi.....**", duket sikur këtë frazë të kalimit të pronësisë e lidh me vitin 1991.
2. Kodi civil dhe ligji referohen tek përfaqësimi i familjes bujqësore nga kryetari i familjes bujqësore. Në këtë rast, ky është administrim i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm?
 - A mund të shesë, të negociojë për shitje kryetari i familjes bujqësore? Psh. Kontratë shitje, kontratë sipërmarrje, kontratë paraprake shitje, deklarata paradhënie me qëllim shitje?
 - Po realizimi i kontratës së qirasë, huapërdorjes, kontratë servituti, kontratë uzufrukti, kontratë enfiteoze?
3. Kodi dhe më pas ligjet në fuqi, në mënyrë indirekte i japin më shumë fuqi përfaqësimi kryetarit të familjes bujqësore. Këtu lind pyetja: Si u zgjodh kryetari i familjes bujqësore? Me vullnet të anëtarëve apo vetëm nga përcaktimi që ai konsiderohej kryetar i familjes sipas gjendjes civile? A mund të ndërrohet kryetari i familjes bujqësore, kur ai është gjallë, me kërkesë të të gjithë anëtarëve?
4. Në rast të ndërrimit të jetës së kryefamiljarit, a shpërbëhet familja bujqësore apo vijon të jetë e njëjta? A kërkohet zgjedhja e një kryetari të ri familje apo shpërbëhet familja bujqësore?
5. Në rast të ndërrimit të jetës së një anëtarit të F.B (i cili mund të jetë anëtar i 1991) a regjistrohet dëshmia e trashëgimisë në ASHK dhe si del certifikata e pronësisë? Si ndodh në praktikën noteriale?
6. Në rast se ndërron jetë një anëtar i familjes bujqësore që i është shtuar familjes bujqësore, psh në vitin 1994 deri në vitin 2006, dëshmia e trashëgimisë a duhet të regjistrohet edhe në pasuritë e FB?
7. Nëse njëri nga anëtarët e FB kërkon të shkëputet nga FB (në fakt ai shkëputet nga gjendja civile, por meqë FB është barazuar me anëtarët e gjendjes civile, e marrim të tillë shembullin) dhe kërkon pjesën e tij takuese në vlerë monetare, si do të bëhet kompensimi, kur nuk lejohet shitja e asnjë pjese pa u bërë më parë pjesëtimi? Referim dhe analizë neni 226, 227, 228/2 I kodit civil.

8. Neni 226 ndalon shitjen e pasurisë dhe tjetërsimin e saj për sa kohë nuk është bërë pjesëtimi.

Rast praktik:

Janë anëtarë të FB, në 3 pasuri lloji tokë arë, të cilat janë përcaktuar në 3 certifikata pronësie. Anëtarët e FB kërkojnë që njërin prej tyre ta shesin tek një i tretë. A lejohet?

9. Pyetje: Për tu konsideruar si anëtarë të Familjes bujqësore, a kërkohet që anëtarët e saj të jenë vazhdimisht në familjen bujqësore, për të punuar për të kontribuar me mjete pune apo me vlera

monetare? Pra duhet të jenë edhe fizikisht? Po nëse kanë vite që janë larguar nga Shqipëria? Referim vendim i gjykatës së kolegjeve të bashkuara të gjykatës së lartë 4/2012.

- Pyetje: në rast pjesëtimi të pasurisë së paluajtshme do të bëhet në pjesë të barabartë sipas frymëve apo në varësi të kontributit që kanë dhënë? Si përcaktohet kontributi? A do të marrim të mirëqenë vlerat monetare që mund ti jenë dhënë kryefamiljarit nga anëtarët? Po nëse këto vlera monetare nuk janë përcaktuar destinimi i tyre?

10. A mund të realizohet shitja ose dhurimi i një anëtari të familjes bujqësore tek anëtarët e tjerë, tek njëri prej tyre apo tek të gjithë?

11. Po shkëmbimi i një familje bujqësore me një tjetër a mund të realizohet?

12. Në kërkimin e pjesëve të secilit anëtar, ne i referohemi nenit 227 të Kodit civil, i cili përcakton në pikën c të saj edhe kontributin e bërë nga një anëtar. Si duhet matur kontributi? Nëse kontributi është në punë vullnetare duhet deklarim? Pranimi i një anëtari të ri mund të bëhet me deklarim? Referim vendim i kolegjeve tq bashkuara tq gjykatës sq lartq 4/2012, fq. 243.

13. Neni 228/3 kërkon që pjesa që u mbetet të mos jetë nën minimumin e njësive minimale të kultivimit. Si duhet kuptuar kjo?

14. Në rastet e tjetërsimit të pasurisë së tokës bujqësore, nëse në certifikatën aktuale familjare të kryefamiljarit ka edhe persona minore, nga noteri kërkohet marrja e një autorizimi për lejimin e tjetërsimit të pasurisë në emër të të miturit. Në rastet praktike, gjykata mban dy qëndrime të ndryshme: ose i pranon si anëtarë të familjes bujqësore, ose i ka refuzuar me arsyetimin se këta të mitur nuk janë anëtarë të familjes bujqësore⁵⁵.

15. Në rast të kërimit të certifikatës familjare të datës 1991, konstatojmë se nuk ka qenë kryefamiljar i familjes bujqësore sepse jetonte në qytet por ndërkohë është pronar i saj me certifikatë pronësie dhe me titullin FB, si duhet të veprojë noteri?

16. Si ka ecur praktika gjyqësore në lidhje me pavlefshmërinë e kontratave të shitjes për shkak se nuk janë marrë si palë shitës anëtarët e 1991, ose anëtarët aktualë?

Referim të vendimeve gjyqësore: Vendim kolegji civil i gjykatës së lartë nr. 22, datë 22.01.2015. Pavlefshmëri absolute e kontratës së shitjes e realizuar në Nëntor 1994, sepse: nuk ka marrë të gjithë anëtarët e 1991, por ka nënshkruar vetëm kryefamiljari, shitja është realizuar në kundërshtim me ligjin, sepse nuk lejohej shitblerja deri në vitin 1991, nuk është marrë autorizim nga gjykata për shitjen e pasurisë kur kishte anëtarë të 1991 të cilët ishin të mitur.

Vendim i Kolegjit civil të gjykatës së lartë nr. 30, datë 12.04.2018, ka konstatuar të pavlefshme kontratën e shitjes së tokës bujqësore sepse nuk ka marrë anëtarët e 1991.

Rast praktik familja bujqësore

Kontratë dhurimi Brenda familjes bujqësore

Shtetasi A, B, C, D kanë qenë anëtarë të familjes bujqësore ne 1 Gusht te 91

Aktualisht ne certifikatë familjare është shtetasi A,B, D (si dhe gruaja dhe dy fëmijët e D)

A, B, dhe C duan që pjesën e tyre takuese t'ia dhurojnë D.

Kush duhet të nënshkruajë në kontratë?

Cilët janë pjesët takuese që dhurojnë?

Kush duhet të merret si pale dhuruese?

A do të vijojë të mbetet bashkëpronësi pas dhurimit apo do të jete kryetar i FB?

⁵⁵ Nga një kërkim individual në gjykatën e rrethit gjyqësor, në muajin Mars 2022, kam konkluduar se në çështjet familjare janë 4 gjyqtarë dhe 2 prej tyre e lëshojnë autorizimin për shitje të pasurisë së paluajtshme tokë bujqësore dhe dy të tjerë nuk e lëshojnë. Pra, edhe juristet magjistratë janë të ndarë në mendime 50% me 50%. Gjithashtu, në trajnimin e detyrueshëm vazhdues për noterë në të cilën kam qenë bashke trajnuese, në 450 Noterë, në pyetësorët që plotësuan, 90% e tyre u përgjigjën që duhet të merren në konsideratë anëtarët e familjes në vitin 1991. Sa i përket procedurës që ndjekin aktualisht, të kushëtëzuar edhe nga regjistrimi I ASHK, ishin të ndarë 50% me 50%.

Rast praktik

1. A mundet që natarët e familjes bujqësore ta tjetërsojnë një pasuri të paluajtshme, pa u bërë më parë pjesëtimi i saj?
 - Është një pasuri e paluajtshme, lloji tokë bujqësore me sipërfaqe 2400 m². Të gjithë anëtarët janë dakord të kryejnë transaksionin të të gjithë pjesës së tyre takuese në emër të njërit bashkëpronar. A mund të bëhet një veprim juridik i tillë?
 - A mund të bëjnë dhurim të pasurisë së paluajtshme njëri nga anëtarët kundrejt të tjerëve?
2. Pasurinë e paluajtshme, lloji tokë bujqësore të përfitur me 7501, anëtarët e familjes bujqësore duan t'ia shesin një personi jashtë familjes bujqësore, i cili është bashkëshorti i një anëtareje të familjes bujqësore. Si do të nënshkruajë ajo? A do të bëhet bashkëpronare për pjesën e bashkëshortit? A do të nënshkruajë si palë shitëse, apo meqë ajo do të përfitojë nga pasuria e bashkëshortit, nuk mund të nënshkruajë?
3. Bëhet pjesëtimi i pasurisë së paluajtshme- tokë bujqësore dhe secili bashkëshort ka përcaktuar veçmas pjesën e pasurisë që do të përfitojë, duke nënshkruar kontratën e pjesëtimit vullnetar. Në rast transaksioni të pasurisë së tij, a do të nënshkruajë dhe bashkëshortja?

Rast praktik - familja bujqësore

Kontratë dhurimi Brenda familjes bujqësore

Shtetasi A, B, C, D kanë qenë anëtarë të familjes bujqësore ne 1 Gusht të '91

Aktualisht në certifikatën familjare është shtetasi A,B, D (si dhe gruaja dhe dy fëmijët e D)

A, B, dhe C duan që pjesën e tyre takuese t'ia dhurojnë D.

Kush duhet të nënshkruajë në kontratë?

Cilët janë pjesët takuese që dhurojnë?

Kush duhet të merret si palë dhuruese?

A do të vijojë të mbetet bashkëpronësi pas dhurimit apo do të jetë kryetar i FB?

- Instituti i trashëgimisë për tokat bujqësore
- Neni 25 i ligjit nr. 7501/1991, theksohet: "Toka bujqësore që merret në pronësi sipas këtij ligji, trajtohet në bazë të dispozitave ligjore për trashëgiminë që do të miratohet".
- Neni 359 K.C: Pjesa e anëtarit që vdes në pasurinë e familjes bujqësore u kalon trashëgimtarëve të tij, pavarësisht nga anëtarësia ose jo e tyre një ekonominë bujqësore. Kur vdes anëtari i fundit i ekonomisë bujqësore, pasuria u kalon trashëgimtarëve të tij sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

-Çfarë do të ndodhë në praktikë? A konsiderohet e shuar FB me ndërrimin e jetës së kryefamiljarit? A e regjistron ASHK dëshmitë e trashëgimisë në rast ndërrimi të jetës së anëtarit të FB?

-Nëse familja bujqësore në vitin 1991 ka qenë me 4 anëtare, përkatësisht:

-A (kryetari i familjes dhe kryetar i FB) B, C, D.

-C është martuar,

-D është martuar dhe ka edhe dy fëmijë.

-A do të konsiderohen edhe ata anëtarë të familjes bujqësore, meqenëse dispozita (neni 222 K.C) përcakton përfitim të pronësisë nëpërmjet të drejtave të tjera?

- Nëse po, sa u takon?

-Pra **bashkëshortja e C** do të marrë në pjesë të barabartë apo do të marrë vetëm 1/2 pjesë të bashkëshortit të saj?

- Po bashkëshortja dhe **fëmijët e D** sa pjesë do të marrin?

Problematika të tjera në praktikë kanë të bëjnë me:

- Nëse bashkëshortja e C ose e D do të jetë përfituese e kësaj familje bujqësore, por ndërkohë në '91 ka qenë përfituese e familjes bujqësore të origjinës së saj (babain kryefamiljar) do të përfitojë nga të dy familjet bujqësore tokë?
- Po nëse bashkëshortja e D nuk ka përfituar nga familja e origjinës, sepse ka jetuar në qytet, a do të duhet të përfitojë nga kjo familje bujqësore? Sa pjesë?
- Po në rast se divorcohet C ose D, a ka të drejtë bashkëshortja e tij të kërkojë pjesë nga familja bujqësore, nga pjesa e bashkëshortit të saj, kur ajo nuk ka qenë anëtare e familjes bujqësore në '91, por i është bashkuar kësaj familje në vitin 1995 dhe ka jetuar deri në 2005?

● **PJESËTIMI & TJETËRSIMI I PASURISË NË FAMILJEN BUJQËSORE**

-A mund të bëhet tjetërsimi i pjesës takuese të anëtarit të FB kundrejt të tjerëve?

- Psh. Janë 5 anëtarë të FB dhe njëri prej tyre kërkon të dhurojë, të shesë, ose të heqë dorë nga pjesa e tij takuese në favor të anëtarëve të tjerë?

- Cilat janë ndalesat ligjore të këtij transaksioni?

-Cilat janë pasojat juridike?

- Anëtarët e familjes bujqësore **nuk mund të bëjnë asnjë tjetërsim, derisa pasuria është në bashkëpronësi dhe nuk është bërë pjesëtimi i saj**. Çdokush nga anëtarët e familjes bujqësore **ka të drejtë të kërkojë pjesën e vet takuese nga pasuria e përbashkët**.

- Ndarja e pjesës takuese sipas përcaktimeve në nenin 227 të Kodit Civil, realizohet duke u bazuar në: pasurinë e familjes, numrin e anëtarëve të familjes dhe së fundi kontributin e anëtarit në vënien apo shtimin e pasurisë në familjen bujqësore". *Do të ishte me vend nëse në Kodin Civil, në nenin 227, do të parashikohej si detyrim, plotësimi i kushtit Anëtarët e familjes bujqësore në rast pjesëtimi përfitojnë aq sipërfaqe sa kanë përfituar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës, për frymë, e në vijim të përfitohen të mirat sipas nenit 227 të Kodit Civil (të shpërndahet pjesa e shtuar e pasurisë bujqësore).*

Aktualisht, pjesëtimi i pasurisë realizohet në bazë të Kodit Civil në fuqi, me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronareve.

- Për të realizuar tjetërsimin e një pasurie, kërkesa për certifikatë familjare me gjendjen aktuale bie ndesh edhe me përcaktimin në dispozitat e Kodit Civil, **konkretisht në nenin 226, gjejmë përcaktimin: "Anëtari familjes bujqësore nuk mund të tjetërsojë asnjë pjesë të pasurisë së familjes bujqësore, gjersa nuk është bërë pjesëtimi i saj"**.
- Në mënyrë indirekte arrijmë në përfundimin se dhurimi mund të kryhet pasi të jetë bërë ndarja e pasurisë, pra pjesëtimi i pjesës takuese të dhuruesit. Në këtë dispozitë njihet e drejta e pronësisë mbi tokën bujqësore çdo subjekti përfitues sipas normës për frymë, ndërsa në procedurat e tjetërsimit i mohohet kjo e drejtë.

Edhe më tepër përforcohet kjo analizë e interpretimit të dispozitave në kontradiktë mes njëra-tjetrës, nëse do t'i referoheshim VKM-se nr. 253, datë 6.3.2013 "Për procedurat e marrjes së akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi.....", në shkronjën "a", të pikës 18, përcaktohet se AMTP-të nuk do të plotësohen sipas gjendjes civile aktuale, por sipas gjendjes civile të datës 1 Gusht të vitit 1991, me ndryshimet deri më 1 tetor të vitit 1992.

Në këtë mënyrë, kjo shkronjë përcakton se pronarë të tokës bujqësore do të jenë vetëm shtetasit sipas regjistrimit të gjendjes civile të vitit 1991 dhe jo sipas regjistrimit të gjendjes civile aktuale. Kjo situatë lë vend për debat e diskutim.

Nga ana tjetër për regjistrimin fillestar të tokës bujqësore sipas ligjit 20/20, juristët duhet të marrin të dyja certifikatat dhe të regjistrojnë në kartelë të gjithë bashkëpronarët. Por në praktikë hezitohet. Ende nuk është bërë mundësi i plotësimit të saj.

- Nëse njëri nga anëtarët e FB kërkon të shkëputet nga FB (në fakt ai shkëputet nga gjendja civile, por meqë FB është barazuar me anëtarët në gjendjen civile, e marrin të tillë shembullin) dhe kërkon pjesën e tij takuese në vlerë monetare, si do të bëhet kompensimi, kur nuk lejohet shitja e asnjë pjese pa u bërë më parë pjesëtimi? Referim dhe analizë neni 226, 227, 228/2 i Kodit Civil.
- Neni 226 ndalon shitjen e pasurisë dhe tjetërsimin e saj për sa kohë nuk është bërë pjesëtimi.
- Për tu konsideruar si anëtarë të FB, a kërkohet që anëtarët e saj të jenë vazhdimisht në familjen bujqësore, për të punuar për të kontribuar me mjete pune apo me vlera monetare?
- Pra duhet të jenë edhe fizikisht të jetojë në FB? Po nëse kanë vite që janë larguar nga Shqipëria? Referim vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 22/2015.
- **Në vijim të analizës së ligjit nr. 8337/1998 konstatojmë ndryshime që kanë të bëjnë me institutin e parablerjes.**
- Plotësimin dhe qartësinë në procedura e bën për më tej Kodi Civil. Është detyrim i çdo bashkëpronari që, para se të shesë pjesën e vet, të njoftojë më parë bashkëpronarët e tjerë dhe, nëse ata nuk pranojnë ta blejnë pjesën e tij. → Atëherë ai mund t'ia shesë pjesën kujtdo që nuk është bashkëpronar. Kjo e drejtë gjen zbatim vetëm në rastet e familjes bujqësore dhe bashkëpronarëve. Tjetërsimi i pasurive të paluajtshme, në këtë rast, tokës bujqësore, u nënshtrohet gjithmonë rregullave specifike.
- Në lidhje me shitjen e një toke bujqësore nga një anëtar i familjes bujqësore, që më parë ka ndarë pjesën e vetë takuese (sipas përcaktimeve në dispozitat e Kodit Civil) 105, procedura do të jetë jo e njëjtë me rastin kur gjithë familja bujqësore ia kalon pronësinë mbi tokën bujqësore një shtetasi, personi fizik apo juridik, vendas.
- Personat fizike dhe juridike të huaj, gëzojnë të drejtën e marrjes me qira deri 99 vjet, bazuar në dispozitat e Kodit Civil në fuqi. Te huajt mund të blejnë tokë bujqësore, vetëm nëse ata kanë investuar në këtë tokë me vlerën e investimit sa trefishi i vlerës së tokës, bazuar kjo në ligjin nr. 7764/1993. "Për investimet e huaja" si dhe ligjin "Për shitblerjen e trojeve personave fizikë ose juridikë të huaj.

4. Referimet e gjykatës në lidhje me trajtimin e tokës bujqësore

4.1 Vendim Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nr. 22, datë 22.01.2015.

Si ka ecur praktika gjyqësore në lidhje me pavlefshmërinë e kontratave të shitjes për shkak se nuk janë marrë si palë shitës anëtarët e 1991, ose anëtarët aktualë?

- Pavlefshmëri absolute e kontratës së shitjes e realizuar në Nëntor 1994, sepse: nuk ka marrë të gjithë anëtarët e 1991, por ka nënshkruar vetëm kryefamiljari, shitja është realizuar në

kundërshtim me ligjin, sepse nuk lejohej shitblerja deri në vitin 1991, nuk është marrë autorizim nga gjykata për shitjen e pasurisë kur kishte anëtarë të 1991 të cilët ishin të mitur.

Vendim i Kolegjit civil të gjykatës së lartë nr. 30, datë 12.04.2018, ka konstatuar të pavlefshme kontratën e shitjes së tokës bujqësore sepse nuk ka marrë anëtarët e 1991.

4.2 Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 30, datë 12.04.2018

Objekt padie: “Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të veprimit juridik të kontratës së shitblerjes, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe çregjistrimin e pronësisë tokë bujqësore.

Baza ligjore: Nenet 32, 36, 41, 42, 153 e vijues të K.Pr.Civile, neni 92/a, 106, 107, 686 të K.Civil

Gjykata e Rrethit Gjqësor Durrës ka vendosur: pranimin e kërkesë-padisë, konstatimin absolutisht të pavlefshëm të veprimit juridik dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjqësor Durrës.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit i padituri J.S ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë i cili kërkon ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë duke pretenduar se: - Gjykatat nuk i kanë respektuar dispozitat e parashikuara nga neni 222 deri në nenin 230 të Kodit të Familjes;

-Pasuria objekt gjykimi është objekt i nenit 222 i K. Civil dhe në vështrim të këtij neni J.S. mendon se kontrata e shitblerjes është e rregullt.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vëren:

-Paditësi Xh.E ka pasur fëmijë me tre gra të ndryshme nga martesat me to, dhe në bazë të ligjit nr. 7501 “Për Tokën” ato kanë përfituar tokë.

-Paditësi Xh.E fillimisht ka lidhur një kontratë qiraje me një afat 30 vjeçar me të paditurin J.S. -Paditësit pretendojnë se ata nuk janë paraqitur para noterit dhe nënshkrimet nuk janë firmosur prej tyre.

-I padituri ka pretenduar se në marrëdhëniet në familjen bujqësore, nuk është e nevojshme pjesëmarrja e të gjithë bashkëpronarëve, mjafton kryetari i familjes i cili është Xh.E të paraqitet në marrëdhënie me të tretët.

Në këto rrethana paditësit i janë drejtuar Gjykatës për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të kontratës së shitblerjes.

-Gjykata e Rrethit Gjqësor Durrës ka pranuar kërkesë-padinë dhe Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimit e gjykatës së rrethit me arsyetimin: se tre nga shitësit në këtë kontratë shitjeje kanë qenë nën moshën 18 vjeçare në momentin e lidhjes së kontratës duke mos pasur zotësi të plotë juridike për të vepruar, tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të fëmijëve të mitur mund të kryhen vetëm kur kërkon interesi i të miturit dhe me autorizim të gjykatës. Në këtë rast kemi bashkëpronësi në tërësi dhe anëtarët e familjes bujqësore nuk mund të tjetërsojnë asnjë pjesë të familjes bujqësore gjersa nuk është bërë pjesëtimi

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala e paditur J.S.

→ Tre nga shitësit në këtë kontratë në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes kanë qenë nën moshën 18 vjeç duke mos pasur zotësi të plotë juridike për të vepruar. Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të fëmijëve mund të kryhet vetëm kur kërkohet interesi i të miturit. Në gjendjen familjare rezulton edhe pjesëtari B.K anëtar i familjes XH.E(K) por nuk ka qenë palë kontraktore në këtë shitje, duke u tjetërsuar pronësia pa shprehur vullnetin e tij. **Për këto arsye Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 485/a të K.Pr.Civile, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës.**

4.3 Vendim i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese nr. 100, datë 28.07.2021

Kërkuese: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

Baza ligjore: Nenet 134, pika 1, shkronja "dh" dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000); ligji nr. 8337, datë 10.04.1998 "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" (ligji nr. 8337/1998); ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" (ligji nr. 7501/1991).

Objekt padie:

Shfuqizimi i ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 07.11.1994 "Për mënyrën e plotësimit të kartelës së pasurisë së paluajtshme" si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme "Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pretendimet: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë në vendimin e saj për pezullimin e çështjes dhe inicimin e kontrollit incidental, ka parashtruar: -Cenohet parimi i barazisë dhe i mos-diskriminimit, pasi prona e ish-pronarit, sipas ligjit nr. 7501/1991 dhe prona e pronarit të bërë rishtas me ligjin nr. 8337/1998 nuk mbrohen në mënyrë të barbartë. Ish-pronarit nuk i krijohen mundësi për përfitimin e pronës, kurse pronari i ri përfiton gjithçka.

- Cenohet neni 17 i Kushtetutës, pasi nga përmbajtja e ligjit nr. 8337/1998 nuk identifikohet argument i lidhur me interesin publik për të përligjur mohimin e të drejtave pasurore të ish-pronarit, edhe të së drejtës subjektive për të kompensuar vlerën e barasvlershme të së drejtës së humbur për shkak të ligjit.

- Neni 5, shkronja "b" dhe neni 6, i ligjit nr. 8337/1998 bien ndesh me nenin 41 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- VKM-ja nr. 519/1994 dhe udhëzimi metodik nr. 76/1999. - Zbatimi i gabuar i ligjit nr. 8337/1998.
- Nga praktikat e ZQRPP-së dhe të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) është zbatuar gabim koncepti "oborre kooperativiste" dhe "familje bujqësore".
- Kolegji vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk legjitimohet për inicimin e kontrollit incidental të normës.
- → PËR KËTO ARSYE, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, 31/a dhe 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, VENDOSI: Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare

4.4 Vendim Kolegji Civil Gjykata e Lartë nr. 3224, datë 21.12.2016

Objekt padie: Pavlefshmëria e tjetërsimit të pasurisë Nr 54/17 ZK2704, të fituar me kontratë shitblerje Nr. 4xxx Rep. dhe Nr 1xxx Kol, datë 07.12.1999. - Konstatimin si veprim absolutisht i pavlefshëm i kontratës së shitblerjes me kusht Nr. 7xx Rep.. dhe Nr. 3xx Kol datë 17.05.1997 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

Baza ligjore: Neni 92/a,208 i K.Civil, Vendimi Nr 255 dt.02.08.1991 i K.Ministrave "Për Kriteret e ndarjes së Tokës Bujqësore".

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur "Pranimin e padisë: -Konstatimi i pavlefshmërisë (absolute) të kontratës së shitblerjes dt. 07.12.1999 si dhe të kontratës të shitblerjes me kusht dt. 17.05.1997 të lidhura midis shitësit B.Gj dhe blerësit K.D në lidhje me tjetërsimin e një sipërfaqe toke prej 1000 m² të

ndodhur në fshatin M.të Tiranës si dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke u bërë njëkohësisht edhe veprimet përkatëse në hipotekë për pasqyrimin e gjendjes juridike të kësaj prone që ajo ka pasur para tjetërsimit të pavlefshëm si më lart.

Pushimin e gjykimit për pjesën tjetër të padisë që lidhet me "sigurimin e padisë" (me heqje dorë nga ky gjykim prej palës paditëse).

Vendim Kolegji Civil Gjykata e Lartë nr. 3224, datë 21.12.2016

Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: "Lënien në fuqi të Vendimit datë 14.11.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."

Gjykata e Lartë, datë 21.05.2013, ka vendosur: "Prishjen e vendimit, datë 08.09.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit datë 14.11.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me tjetër trup gjykues."

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë me që i përket paditëses IGj. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute së veprimit juridik kontratë shitblerje me kusht.

- Konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të veprimit juridik Kontratë shitje.
- Pavlefshmërinë e tjetërsimit të pasurisë.

-Detyrimin e paditëses Igj dhe të paditurës MGj të paguajnë në favor të të paditurit KD, në mënyrë propocionale x lekë shumë e kontratës së shitblerjes me datë 07.12.1999 përpara Noteres XY Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur KD.

Ky Kolegj i vlerëson të gabuar përfundimin e gjykatave të faktit lidhur me pavlefshmërinë e veprimeve juridike kontratë shitblerje me kusht datë 17.05.1997 dhe kontratës së shitjes datë 07.12.1999, për shkakun se pasuria ka qenë e familjes bujqësore dhe nuk rezulton që ajo të jetë pjesëtar ndërmjet bashkëpronarëve, që të mund ta dispononin lirisht sipas pjesëve të tyre takuese.

Gjykata e faktit, nuk kanë pasur parasysh të vlerësonin të drejtën e pronësisë së paditëses si pjesëtare e familjes bujqësore në momentin e tjetërsimit të kësaj pasurie, nëse ajo bënte pjesë në atë familje apo ishte e larguar, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, pikërisht nenit 223 të tij.

Nga aktet e administruara në gjykim dhe të nënshtruara debatit gjyqësor, rezulton e provuar se, e paditura IGj është martuar me datë **19.07.1994**, ndërkohe që i ndjeri BGj i ka kryer veprimet juridike për sipërfaqen e tokës bujqësore 1000 m², me kontratën për premtim shitjeje, me datë **17.05.1997** dhe më pas me kontratën e shitjes, me datë **07.12.1999**.

Kolegji vlerëson se, edhe nëse paditësja do të ishte anëtare e familjes bujqësore, gjykatat e faktit, nuk kanë pasur parasysh se, nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se, sipërfaqja e tokës bujqësore prej 1'000 m², është e ndarë, nga e gjithë pasuria prej 15.500 m² nga i ndjeri BGj, në kohën e gjallesës së tij dhe vetëm pas veçimit (pjesëtimit) që i është bërë pasurisë së familjes bujqësore, rrethana faktike të provuara në gjykim, në bazë të Nenit 226 të Kodit Civil, nuk kishte pengesë ligjore për tjetërsimin e kësaj sipërfaqeje nga i ndjeri BGj, si anëtar dhe kryetar i familjes bujqësore.

PËR KËTO ARSYE Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 485/d të K.Pr.Civile.VENDOSI→ Ndryshimin e vendimit datë 16.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit datë 22.01.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e kërkesë padisë.

4.5 Vendim nr. 22/2015 i Kolegjit Ciil të Gjykatës së Lartë

Objekti i padisë: Lirim dhe dorëzim sendi të sipërfaqes 1000 m² në pronësi të shtetasit E.D. Lirim dhe dorëzim i sipërfaqes 1000 m² në pronësi të A.H.

Baza ligjore: Neni 153 K.Civil, neni 32 K.Pr.C, neni 296 K.Civil

Objekt i kundërpadisë: Detyrimin e paditësave të kundërpaditur t'i njohin pronarë në truallin 4000 m² të ndodhur në Kashar të cilin e posedojnë në mënyrë të ligjshme sipas kontratës së shitblerjes.

Baza ligjore e kundërpadisë: Neni 160 K.Pr.C, 164,302, 1163 K.Civil

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e të paditurvë kundërpaditës për lirim dhe dorëzim sendi dhe rrëzimin e kundërpadisë si të pabazuar në ligj e në prova.

Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova. Pranimin e kundër padisë, njohjen pronar të kundërpaditës I.B dhe M.B

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit kanë paraqitur rekurs paditësit e kundërpaditur A.H dhe E.D ku kërkojnë prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit për shkak se: Gjykata e Apelit ka dhënë vendim haptaz të padrejtë sepse i jep vlefshmëri kontratës së shitjes duke qenë një akt absolutisht i pavlefshëm dhe i konstatuar si tillë nga gjykata e rrethit, kundërpadia dhe objekti i saj bien ndesh me neni 750 të K.C, sepse kontrata nuk ka shfaqje të ligjshme vullneti, e cila përcaktohet me formë juridike (para noterit) dhe parimit se para se ta shesësh duhet të jesh pronar i sendit dhe duke qenë se toka nuk ishte në pronësi të shitësve në kohën kur është berë kontrata.

Kjo kontratë bie ndesh me Kodin Civil, sepse toka bujqësore e pandarë apo pjesëtuar kërkon shprehjen e vullnetit të të gjithë anëtarëve. Për sa i përket parashkrimit Gjykata e Apelit shprehet se të paditurit kundërpaditës mund të bëhen pronar me parashkrim fitues por është jo e saktë sepse parashkrimi fitues është **3 vjet dhe kontrata në fjalë është e vitit 1994.**

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë Vlerëson se: Vendimi i Gjykatës së Apelit është rrjedhojë e mosrespektimit të ligjit material dhe për këtë shkak duhet të priset dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të lihet në fuqi. Kolegji Civil ndalet në rëndësinë e formës së veprimit juridik të tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme e cila duhet të bëhet me akt noterial për efekt vlefshmërie. Ndryshe nga sa ka argumentuar Gjykata e Apelit përveç mungesës së formës, veprimi juridik për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme, tokë bujqësore edhe në përmbajtjen e ligjit të tij, ka qenë një veprim juridik i ndaluar nga ligji i kohës.

Për këto arsye Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në bazë të nenit 485/b të Kodit të Procedurës Civile → vendos prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4.6 Kërkim i lëshimit të autorizimit për fëmijët e mitur

Gjykatat e Rrethit Gjyqësor kanë mbajtur **qëndrime të ndryshme** në lidhje me pranimin ose rrëzimin e kërkesave për lëshim autorizimi të fëmijëve të mitur, të cilët janë lindur pasi 01.08.1991 (ose 01.10.1992). Në një pesë të tyre e kanë pranuar faktin, që fëmija është anëtar i familjes bujqësore duke lëshuar autorizim në referim të nenit 222 dhe 223 i K.C., ku kanë përcaktuar se fëmija i mitur është anëtar i familjes bujqësore dhe për rrjedhojë bashkëpronar i kësaj familje. Në referim të nenin 234 të K.F. ka lëshuar autorizim për shitjen e pasurisë së paluajtshme.

Gjyqtarë të tjerë me të njëjtën bazë ligjore kanë argumentuar se fëmija i mitur nuk ka bashkëpronësi në pasurinë tokë-arë, për shkak se në bazë të ligjit 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, VKM nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore” pika 2, ku thuhet se toka bujqësore ndahej përpjesëtimisht për çdo familje, sipas numrit të frymëve të gjendjes civile të datës 01 Gusht ’91.

Gjykata argumenton më pas se: sipas nenit 234 të K.F., dhe nenin 199 dhe 222 i K.C., nuk provohet që e mitura të ketë ndonjë pronësi të fituar në mënyrë të prejardhur apo të drejtpërdrejtë (si psh. nëpërmjet dokumentit unik, akti i marrjes së tokës në pronësi në referim të ligjit 7501 “Për Tokën”. Përderisa e mitura nuk ka pronësi sipas parashikimeve ligjore nuk ka se çfarë autorizimi për tjetërsim pasurie të lëshojë Gjykata.

Vlen parimi anti sipas të cilit: “asnjëri nuk mund tu transferojë të tjerëve më shumë të drejta se sa ka ai vetë”

Gjykata çmon se edhe sikur të pranojmë që e mitura është anëtare e familjes bujqësore nuk provohet prej palës kërkuese, sipas nenit 12 të KPrC., që ajo nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara me ligj të ketë kontribuar me krijimin apo mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Gjithashtu kolaudohet se anëtari i familjes bujqësore është anëtar madhor dhe nuk mund të tjetërsojë asnjë pjesë të pasurisë së familjes bujqësore gjersa **nuk është bërë pjesëtimi i saj, një dallim ky i parashikuar në nenin 226 i Kodit Civil**, prandaj edhe për këtë shak aksesit i dhënies së autorizimit për tjetërsim pasurie nga kjo gjykatë për palën kërkuese nuk mund të jepet.

Vendime të tjera referuese:

- a) Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendimi Nr. 14, datë 22.05.2006;
- b) Vendimi Nr. 9, datë 26.02.2007;
- c) Vendimi Nr. 36, datë 15.10.2007;
- d) Vendimi Nr. 17 datë 23.04.2010;
- e) Vendimi Nr. 10, datë 26.02.2015;
- f) Vendimi Nr. 60, datë 16.09.2016;
- g) Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 1, datë 26.11.2010

5. PROPOZIME PËR NDRYSHIMIN E KODIT CIVIL (KREU FAMILJA BUJQËSORE)

BASHKËPRONËSIA MIDIS ANËTARËVE TË FAMILJES BUJQËSORE

Neni 222 ishte

Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Neni 222 bëhet

Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, u përket në tërësi anëtarëve të saj, të regjistruar në regjistrat publikë, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin dhe vijojnë të kotribojnë në mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Neni 223 ishte

Familja bujqësore përbëhet nga personat që lidhen ndërmjet tyre për shkak gjinie, martesë, birësimi ose pranimi si anëtar i saj.

Neni 223 behet

Familja bujqësore përbëhet nga personat që lidhen ndërmjet tyre për shkak gjinie, martesë, birësimi ose pranimi si anëtar i saj.

Pranimi i një anëtari të ri, bëhet me vullnetin e të gjithë anëtarëve të shprehur nëpërmjet një deklarate noteriale dhe të depozituar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme.

Neni 224 ishte

Familja bujqësore përfaqësohet në marrëdhëniet pasurore me të tretët nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj.

Neni 224 behet

Familja bujqësore përfaqësohet në marrëdhëniet pasurore me të tretët nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj dhe regjistrohet në regjistrat publikë.

Neni 225 ishte

Në pasurinë e familjes bujqësore nuk përfshihen sendet e përdorimit thjesht vetjak të anëtarëve, si dhe sendet që anëtari ka fituar me të ardhurat e tij vetjake, me dhurim ose me trashëgim.

Neni 225 bëhet

Në pasurinë e familjes bujqësore nuk përfshihen sendet e luajtshme të përdorimit thjesht vetjak të anëtarëve, si dhe sendet e luajtshme që anëtari ka fituar me të ardhurat e tij vetjake, me dhurim ose me trashëgim.

Ose

Neni 225 behet

Në pasurinë e familjes bujqësore, përfshihen edhe sende të luajtshme, por nuk përfshihen sendet e përdorimit thjesht vetjak të anëtarëve, si dhe sendet që anëtari ka fituar me të ardhurat e tij vetjake, me dhurim ose me trashëgim

Neni 226 ishte

Anëtari i familjes bujqësore nuk mund të tjetërsojë asnjë pjesë të pasurisë së familjes bujqësore, gjersa nuk është bërë pjesëtimi i saj.

Neni 226 bëhet

Anëtari i familjes bujqësore nuk mund të tjetërsojë veçmas asnjë pjesë të pasurisë së familjes bujqësore, gjersa nuk është bërë pjesëtimi i saj, sipas rregullave përkatëse të këtij kodi.

Duhet të shtohet një dispozitë

Neni 226/1

Tjetërsimi i pasurisë së familjes bujqësore nga të gjithë anëtarët, kundrejt një të treti, e shuan familjen bujqësore, përveç kur në akt është parashikuar ndryshe.

Ndërrimi i jetës së kryefamiljarit nuk e shuan familjen bujqësore.

Neni 227 ishte

Çdo anëtar i familjes bujqësore mund të kërkojë pjesën e vet në pasurinë e familjes bujqësore.

Ajo përcaktohet duke marrë parasysh sidomos:

a) pasurinë që i përket tërë familjes;

b) numrin e anëtarëve të familjes;

c) kontributin e tij në vënien ose shtimin e pasurisë së familjes duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Neni 227 behet

Çdo anëtar i familjes bujqësore, përpara largimit nga familja bujqësore, mund të kërkojë të kompensohet në vlerë monetare në pjesën e tij takuese në pasurinë e familjes bujqësore.

Ajo përcaktohet duke marrë parasysh sidomos:

a) pasurinë që i përket tërë familjes;

b) numrin e anëtarëve të familjes;

c) kontributin e tij në vënien ose shtimin e pasurisë së familjes duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Duhet të shtohet një dispozitë

Neni 227/1 të shtohet

Të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, mund të vendosin të largojnë një anëtar të familjes, në rast se ai nuk ka dhënë asnjë kontribut në familjen bujqësore që nga krijimi i saj.

Neni 228

Pjesëtimi i pasurisë së familjes bujqësore, bëhet sipas rregullave të caktuara në nenin 207 të këtij Kodi. Kur kërkohet pjesa nga anëtarë të veçantë të saj, ajo vlerësohet dhe i jepet në para. Kur pjesëtimi kërkohet nga disa pjesëtarë të familjes bujqësore, me qëllim që të krijohet një familje tjetër bujqësore, pjesa mund të jepet në natyrë, me kusht që toka bujqësore që u mbetet familjeve të ndara, të mos jetë nën minimumin e njësisë minimale të kultivimit. Me njësi minimale të kultivimit kuptohet toka bujqësore, që është e nevojshme për mbajtjen e një ekonomie bujqësore, sipas kushteve natyrore të krahinës apo zonës përkatëse.

Neni 228 behet

Pjesëtimi i pasurisë së familjes bujqësore, bëhet sipas rregullave të caktuara në nenin 207 të këtij Kodi. Kur kërkohet pjesa nga anëtarë të veçantë të saj, ajo vlerësohet dhe i jepet në para. Kur pjesëtimi kërkohet nga disa pjesëtarë të familjes bujqësore, me qëllim që të krijohet një familje tjetër bujqësore, pjesa mund të jepet në natyrë, me kusht që toka bujqësore që u mbetet familjeve të ndara, të mos jetë nën minimumin e njësisë minimale të kultivimit. Me njësi minimale të kultivimit kuptohet toka bujqësore, që është e nevojshme për mbajtjen e një ekonomie bujqësore, sipas kushteve natyrore të krahinës apo zonës përkatëse.

Familja bujqësore e re e krijuar, i nënshtrohet të njëjtave rregulla të përcaktuar në këtë kod për familjen bujqësore.

Neni 229 ishte

Familja bujqësore përgjigjet për veprimet e paligjshme të kryera nga anëtarët e saj, gjatë ushtrimit të detyrave që rrjedhin nga veprimtaria ekonomike e vetë familjes bujqësore.

Neni 229 bëhet

Familja bujqësore përgjigjet për veprimet e paligjshme të kryera nga anëtarët e saj, gjatë ushtrimit të detyrave që rrjedhin nga veprimtaria ekonomike e vetë familjes bujqësore. Të tretët iu kundërdrejtohen kryetarit të familjes bujqësore, i cili është përfaqësues i familjes.

Ose

Neni 229 bëhet

Secili nga anëtarët e familja bujqësore përgjigjet personalisht për veprimet e paligjshme të kryera nga ai, gjatë ushtrimit të detyrave që rrjedhin nga veprimtaria ekonomike e vetë familjes bujqësore.

Neni 230 ishte

Familja bujqësore nuk përgjigjet për detyrimet ekonomike vetjake të anëtarëve, duke përfshirë edhe kryetarin e saj. Kreditorët kanë të drejtë të paguhen nga pjesa që i takon anëtarit debitor në të ardhurat e familjes bujqësore dhe nga pjesa që i takon atij në pasurinë e familjes bujqësore.

Neni 230 behet

Familja bujqësore nuk përgjigjet për detyrimet ekonomike vetjake të anëtarëve, duke përfshirë edhe kryetarin e saj, detyrime të cilat nuk janë të lidhur me familjen bujqësore. Kreditorët kanë të drejtë të paguhen nga pjesa që i takon anëtarit debitor në të ardhurat e familjes bujqësore dhe nga pjesa që i takon atij në pasurinë e familjes bujqësore.

Neni 359 ishte

Pjesa e anëtarit që vdes në pasurinë e familjes bujqësore u kalon trashëgimtarëve të tij, pavarësisht nga anëtarësia ose jo e tyre në ekonominë bujqësore. Kur vdes anëtari i fundit i ekonomisë bujqësore, pasuria u kalon trashëgimtarëve të tij sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

Neni 359 bëhet

Pjesa e anëtarit që vdes në pasurinë e familjes bujqësore u kalon trashëgimtarëve të tij, pavarësisht nga anëtarësia ose jo e tyre në ekonominë bujqësore. Trashëgimtarët, u nënshtrohen të njëjtave rregulla që ka anëtarësia në familjen bujqësore.

Kur vdes anëtari i fundit i ekonomisë bujqësore, familja bujqësore shuhet dhe trashëgimtarët, konsiderohen bashkëpronarë në pjesë takuese, përveç kur me vullnetin e të gjithë bashkëpronarëve e përcaktojnë ndryshe.

6. Përmbledhje e kërkesës për ndryshimin e kodit civil mbi tokën bujqësore

Shqipëria paraqitet si rasti unik në rajon, ku trajtimin e konceptit të familjes bujqësore e bëri ndryshe nga vendet e tjera. Në krahasim me të gjitha vendet e Evropës Juglindore, të cilat, ashtu si vendi ynë pas viteve '90 dolën nga regjimi komunist, tokat bujqësore, të cilat ishin të gjitha në pronësi shtet para viteve '90, iu ndanë paraprakisht fshatarëve të cilët i kishin në posedim, nëpërmjet ligjit të miratuar 7501, datë 19.07.1991 dhe më pas ato që do të mbeteshin do tu jepeshin ish pronarëve. Ndërkohë në të gjitha vendet e tjera, toka bujqësore iu ofrua fillimisht ish pronarëve dhe ato që ngeleshin iu ndanë fshatarëve.

Dispozitat mbi bashkëpronësinë në familjen bujqësore, të përcaktuar në kodin civil në vitin 1994, si një lloj i veçantë i bashkëpronësisë, duket se në praktikë kanë sjellë cënim të barazisë gjinore, duke rezultuar më tepër të favorizuar meshkujt e familjes. Këto dispozita nuk kanë pësuar asnjë ndryshim deri në ditët e sotme, ndërkohë që i ka dhënë mundësi ligjeve të ndryshme, por edhe praktikës gjyqësore për të interpretuar në mënyra të ndryshme identifikimin e bashkëpronarëve në familjen bujqësore.

Edhe në vëzhgimet Përfundimtare dhe Rekomandimet e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave drejtuar Republikës së Shqipërisë në përgjigje të raportit të katërt periodik të Shqipërisë për zbatimin e Konventës për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave; datë 12 Korrik 2016, Komiteti shqyrtoi raportin e katërt periodik të Shqipërisë, në lidhje me masat e marra nga Shteti shqiptar për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga e Konventa OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Konventa) *".....Përsa i përket martesës dhe marrëdhënieve familjare, vetëm një përqindje e vogël e grave në Shqipëri (8%) kanë në pronësi tokë..... Edhe praktika e ALUIZNI-t, sipas të cilës ndërtime informale regjistrohen në emër të të ashtuquajturit "kryetari i familjes", konsiderohet diskriminuese ndaj grave..."*.

Në gjithë këto vite të zbatimit të kodit civil dhe të akteve ligjore e nënligjore mbi disponimin e pasurisë së familjes bujqësore, evidentohen tre praktika në lidhje me identifikimin e bashkëpronarëve në familjen bujqësore, në rastet e tjetërsimit të pasurisë:

5. Praktika që konsideron si bashkëpronarë vetëm anëtarët e familjes bujqësore që kanë qenë në certifikatën familjare të kryefamiljarit në vitin 1991 (përkatësisht 01 Gusht 1991 ose 01 Tetor 1992).
6. Praktika që konsideron si bashkëpronarë vetëm anëtarët e familjes bujqësore që janë aktualisht në certifikatën familjare të kryefamiljarit në çastin (datën) e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.
7. Praktika që konsideron si bashkëpronarë anëtarët e familjes bujqësore që kanë qenë në certifikatën familjare të kryefamiljarit në vitin 1991 dhe anëtarët e familjes bujqësore që janë aktualisht në certifikatën familjare të kryefamiljarit në çastin e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.

Si rrjedhim, pasiguria në gëzimin dhe disponimin e të drejtave të pasurisë së paluajtshme në familjen bujqësore është e dukshme, sidomos kur kjo pasiguri reflektohet edhe tek aplikuesit e ligjit (noterët, gjyqtarët, juristët e kadastrës, avokatë, etj.).

Nga analiza e bërë në raport edhe me konventën e CEDAW dhe konventa të tjera ndërkombëtare të cilat theksojnë, ndër të tjera se: *"...e drejta për pronë duhet ti njihet njësoj të dyja gjinive dhe ashtu si burri edhe gruaja ka të drejtë për të poseduar pasuri, në mënyrë të veçantë të drejta të barabarta për të lidhur kontrata..."*; konstatojmë se në përgjithësi për pasuritë dhe veçanërisht për familjen bujqësore, ky rekomandim nuk është zbatuar. Ligjet që dolën për shitblerjen e tokës bujqësore, në vitin '95 dhe veçanërisht në vitin 1998, favorizuan më tepër kryefamiljarin (kryetarin e familjes, i cili rezulton të jetë burri, vjehri, vëllai i familjes), të cilit i njihen më shumëtribute në lidhje me pasurinë dhe përfaqësimin e familjes bujqësore.

Si e tillë, familja bujqësore kërkon një trajtim specifik në kodin civil e cila duhet të pasohet me rregullimin e saj në aktet ligjore dhe nënligjore, për të qartësuar bashkëpronarët e saj dhe për të mos cënuar në aspektin gjinor asnjë nga anëtarët që për shkak të martesës (veçanërisht gratë), mund të largohen nga certifikata e përbërjes familjare e origjinës dhe/ose mund të hyjnë në certifikatën familjare të familjes bujqësore (për shkak të martesës, ndarjes nga familja, largimit nga jeta, etj.). Kërkohet qartësi sa i përket edhe anëtarëve të rinj të familjes bujqësore, për shkak të martesës, birësimin, pranimit si anëtarë të rinj, etj. Gjithashtu kërkohet të specifikohet roli i tyre në bashkëpronësinë e familjes bujqësore. Një problem tjetër është barazia ndërmjet certifikatës familjare të gjendjes civile me familjen bujqësore. E para mund të ndryshojë menjëherë vetëm me pëlqimin e kryefamiljarit, i cili kërkon shpëputjen nga anëtarët e tjerë të familjes. Por ky ndryshim, reflekton negativisht për anëtarët e tjerë në familjen bujqësore, sepse mund ti përjashtojë ata nga disponimi i pasurisë së paluajtshme.

Nisur nga problematikat e konstatuara në praktikë nga noterët dhe kadastra, si dhe nga ato të shqyrtuara nga gjykata e lartë, evidentojmë se nëpërmjet ndryshimeve në kodin civil, do të qartësohet më mirë bashkëpronësia në familjen bujqësore për:

- rastet e hyrjes së anëtarëve të rinj në familjen bujqësore,
- rastet e largimit të anëtarëve të familjes bujqësore,
- në çfarë mase bëhet përfaqësimi i kryetarit në familjen bujqësore
- trashëgimia e familjes bujqësore.

Bibliografia

1. Konventa “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit).
2. Konventa CEDAW
3. Kodi Penal e RSh-së
4. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-30, [WEB Strategjia-Kombetare-AL.pdf \(shendetesia.gov.al\)](#)
5. Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), Raporti Bazë Vlerësues i Shqipërisë, 2017, <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>
6. Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO): Analizë e Raporteve Bazë të Vlerësimit të GREVIOs, 2022 <https://rm.coe.int/prems-010522-gbr-grevio-mid-term-horizontal-revieë-rev-february-2022/1680a58499>
7. MC k. Bullgarise, GJEDNJ, 2004, https://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/resources/M.C.v.BULGARIA_en.asp
8. CEDAW Committee Communication No. 34/2011, R. P. B. v. the Philippines
9. Amnesty International: Le të flasim për “PO”: Ligjet e bazuara në pëlqim në Evropë”, 2020, <https://ëëë.amnesty.org/en/latest/campaigns/2020/12/consent-based-rape-laës-in-europe/>; Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO): Analizë e Raporteve Bazë të Vlerësimit të GREVIOs, 2022 <https://rm.coe.int/prems-010522-gbr-grevio-mid-term-horizontal-revieë-rev-february-2022/1680a58499>
10. Prezantim nga Marceline Naudi, Presidente e Grupit të Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) of the Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO) në Takimin e Grupit të Ekspertëve të Raportuesit Special të OKB-së mbi Dhunën ndaj Grave: [Raport mbi përdhunimin si një dhunim I rëndë dhe sistematik I të drejtave të njeriut](#), 2020;
11. Komisioni Evropian, Fundi i Dhunës ndaj Grave: Çfarë po Bën Bashkimi Evropian, 2023, https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-based-violence/ending-gender-based-violence_en
12. Komisioni Evropian, Propozimi për një Direktivë Parlamentit dhe Këshillit Evropian për Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 8 Mars 2022, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52022PC0105&from=EN>
13. Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 25 tetor 2012.
14. Direktiva e Këshillit të BE-së 2004/80/EC “Për kompensimin e viktimave të krimit”
15. Komisioni Evropian, Fundi i Dhunës ndaj Grave: Çfarë po Bën Bashkimi Evropian, 2023, https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-based-violence/ending-gender-based-violence_en
16. Komisioni Evropian, Propozimi për një Direktivë Parlamentit dhe Këshillit Evropian për Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 8 Mars 2022, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52022PC0105&from=EN>
17. Këshilli i Evropës, Raport Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), 2011, <https://rm.coe.int/1680a48903>
18. Kushtetuta e RSH

19. Konventa 190 e ONP e ratifikuar nga Kuvendi i RSH
20. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, neni 16 dhe 19.
21. Rezoluta 156 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe Rekomandimin e Përgjithshëm të Përbashkët Nr. 31 të Komitetit CEDAW dhe komentin e përgjithshëm 18 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës
22. Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU)
23. Deklarata nr. 19 për nenin 8 i TFBE-së i aneksuar në Aktin përfundimtar të Konferencës Ndërqeveritare që miratoi Traktatin e Lisbonës
24. Direktiva 2012/29/BE).
25. Ligji Nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"
26. Ligji Nr. 9970 / 24.07.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri"
27. Ligji Nr. 10 237 / 18.2.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë"
28. Kodi i Familjes i RSH-së
29. Kodi i Punës i RSH-së, Ligji Nr. 7961/12.7.1995, ndryshuar me: Ligjin Nr. 8085/ 13.3.1996; Ligji Nr.9125 /29.7.2003; Ligji Nr.10 053/ 29.12.2008; Ligji Nr.136/ 5.12.2015.
30. Ligji Nr. 10 237 / 18.2.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" (LSSH), i ndryshuar me Ligjin 161/2014,
31. Raportet e GRETA për Shqipërinë (<https://www.coe.int/en/web/anti-human-trafficking/albania>)
32. Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), Raporti Bazë Vlerësues i Shqipërisë, 2017, <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>
33. Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve mbi Masat dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO): Analizë e Raporteve Bazë të Vlerësimit të GREVIOs, 2022 <https://rm.coe.int/prems-010522-gbr-grevio-mid-term-horizontal-revieë-rev-february-2022/1680a58499>
34. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-30, [WEB Strategjia-Kombetare-AL.pdf \(shendetesia.gov.al\)](http://www.shendetesia.gov.al)
35. Komisioni Evropian, Fundi i Dhunës ndaj Grave: Çfarë po Bën Bashkimi Evropian, 2023, https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-based-violence/ending-gender-based-violence_en
36. Komisioni Evropian, Propozimi për një Direktivë Parlamentit dhe Këshillit Evropian për Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 8 Mars 2022, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52022PC0105&from=EN>
37. Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 25 tetor 2012.
38. Direktiva e Këshillit të BE-së 2004/80/EC "Për kompensimin e viktimave të krimit"
39. "Martesë në Gjykatë? Të drejtat e fëmijëve, martesë nën moshë dhe roli i gjykatës"- [Raport mbi aspektet ligjore, sociale dhe praktikën gjyqësore të martesave nën moshë në Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier dhe Kavajë për periudhën 2011 – 2017](#). Tiranë, Qershor 2018. Arta Mandro-Balili dhe Bernard Zeneli.
40. FRA-së Addressing Forced Martes in EU: dispozitat ligjore dhe praktikat premtuese. https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra-2014-forced-marriage-eu_en.pdf.pdf
41. Arta Mandro Balili "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore. Roli i gjyqësorit shqiptar në eliminimin e tij". Botim i SHM dhe UNDP. Tiranë, Prill 2014. Fq 46-78.
42. Human Rights Council Working Group on the Universal Periodic Review Thirty-third session 6–17 May 2019.